*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së*
*Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*
*Dt.17.05.2021*

**17.05.2021**
**Ora 10:09**

***RENDI I DITËS***

***Administrimi i provave nëpërmjet procedurës së hapjes së kutive të materialeve zgjedhore".***

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** **Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI, Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**
- **Stafi KQZ: Y.Merkaj, O.Peto**
- **Parti Politike: LSI, PD, PS.**

***Z. E. Çefa:*** Mirëdita të gjithëve, me lejen tuaj dëshiroj të rifillojmë seancën për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr.34, 35 dhe 42. Sikurse jeni njoftuar nga seanca e shkuar, sot do të hapim kutitë e materialeve zgjedhore për 24 qendra votimi të Zonës Zgjedhore Qarku Berat. Për efekt të procesverbalit do të verifikoj shkurtimisht pjesëmarrjen. Janë prezent përveç stafit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuesit e subjekteve ankimues përkatësisht Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, subjekti tjetër ankimues PD-AN dhe subjekti i interesuar Partia Socialiste. Sikurse e dini tashmë kodi përcakton hapja e kutive qoftë dhe për materiale zgjedhore, do të bëhet në prezencë të palëve dhe në prezencë të publikut. Kështu që për këtë falenderoj dhe mediat për transparencën që na krijon mundësinë për të pasur dhe publikun. Përpara se të fillojmë zoti sekretar i përgjithshëm shkurtimisht për procedurën si do të procedojmë?

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Zoti Relator!

***Z. E. Çefa:*** Po zoti avokat.

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Faleminderit zoti relator kemi një kërkesë paraprake. Gabimisht kemi kërkuar për QV nr. 3220, por sipas dokumentacionit duhet të jetë QV nr. 3441

***Z. E. Çefa:*** Administrata mbani shënim kërkesën e përfaqësuesit të ankimuesit, të marrim masa të bëjmë zevëndësimin e kutisë nr. 3220 me kutinë 3441. Ndërkohë pjesa tjetër për prova që do të merren nga kjo kuti ngelet e vlefshme sipas citimeve që kemi bërë herën e shkuar, faleminderit.

***Z. Y. Merkaj:*** Ta fillojnë numërimin nga 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6-ta.
Tavolina nr.1 - Lorena Mavriqi me Fadil Kapllanin;
Tavolina nr.2 - Blendi Kodra me Anduela Xhaferrin;
Tavolina nr.3 - Klodiana Nogu me Stiven Toska;
Tavolina nr.4 - Aleksandër Llano me Endri Toporia;
Tavolina nr.5 - Juli Bytyçi me Rusvelt Shehun;
Tavolina nr.6 - Eljon Rama me Bjanka Bego. Në qoftë se do të mbajmë rendin siç është listuar…

***GNV nr.1. Zoti F. Kapllani:*** QV nr. 3446 KZAZ nr.66 Qarku Berat.

***Z. Y. Merkaj:*** Fadil do të lexosh numrat që është mbyllur kutia dhe do ta verifikojmë me procesverbalin e mbylljes me këtë që kemi këtu.

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Mund ta marr fjalën zoti relator? Për transparencë të medias si do të procedohet, Sekretari i Përgjithshëm të na bëjë një resume të përgjithshme të procesit se si do të procedohet. Do shkojnë do hapin kutitë e votimit që është 3446. Tavolina nr.1 si do të procedojë në këtë moment, çfarë duhet të bëjë? Na e thoni të gjitha hapat ju lutem zoti sekretar i përgjithshëm.

***Z. Y. Merkaj:*** Tavolina nr.1 do të lexojë kodet që është e mbyllur kutia dhe këto kode do të verifikohen me kodet që është dorëzuar nga KZAZ-ja në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe përfaqësuesja është znj. Eda që do të konfirmojë numrat e kodeve që do të lexojë Fadili dhe kështu me rradhë. Kjo është procedura pastaj do të hapet kutia dhe do të kërkohen atë që ka kërkuar KAS-i procesverbalin në QV-të, Librin e Prokollit, listën e zgjedhësve si dhe raportin e PEI. Pastaj do të mbyllet me kodet dhe do të vendoset procesverbali.

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Pasi të ketë aksesueshmëri në dokumentacion.., subjektet ankuese do të marrim kopje të materialit që kërkojmë?

***Z. E. Çefa:*** Sigurisht, patjetër!

***GNV nr.1, zoti F. Kapllani:*** Hapim kutinë e QV nr. 3446, KZAZ nr. 66 Qarku Berat, kutia është mbyllur me këto kode sigurie: 278407;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr.1, zoti F. Kapllani:*** 278400;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr.1, zoti F. Kapllani:*** 278404;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr.1, zoti F. Kapllani:*** 278403.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. L. Braho:*** Në rastin kur dokumentet që kërkohen nuk janë te kutia e materialeve zgjedhore, grupi i numërimit duhet të njoftojë që të hapet kutia tjetër për nxjerrjen e kuponit. Në qoftë se nuk është tek asnjëra nga kutitë, do të marrim rastin që është te valixhja PEI, do të hapet dhe valixhja.

***Z. Y. Merkaj:*** E kemi marrë parasysh këtë situatë, i kemi sjellë kutitë me fletët në qoftë se e vendosni ju këtë gjë. (***nuk dëgjohet***)

***Z. L. Braho:*** Çfarë do të thotë janë hapur më parë?

***Z. Y. Merkaj:*** Është hapur nga KQZ-ja, sepse po bën...(***nuk dëgjohet***)

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Mundet dhe një pyetje Sekretarit të Përgjithshëm në kuadër të asaj që kërkoi zoti Braho të procesverbalit të mbylljes së PEI, ekziston vetëm një kopje e mbylljes së tij apo jo zoti sekretar?

***Z. Y. Merkaj:*** Si rregull një kopje.

***Z.A.Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Nëse kopja nuk është gjetur në kutinë e materialeve të votimit ose të fletëve të votimit dhe ju thoni se keni gjetur disa kopje nuk e di sa keni gjetur në brendësi të valixheve përkatëse të PEI-t lindin dyshime të

arësyeshme se si është bërë përllogaritja nga QV-të dhe më pas nga ZAZ-të, të numrit të votuesve pjesëmarrës në atë QV. Nga momenti që ngrejmë dyshime edhe për regjistrin e nënshkrimeve të zgjedhësve për ato zona zgjedhore të cilat ne kontestojmë.

***Z. Y. Merkaj:*** Përgjigjja është kjo: që raporti mbylljes ekziston por nuk është futur te kutia e materialeve zgjedhore, por është futur gabimisht te valixhja e pajisjes PEI dhe është me nënshkrimet origjinale të anëtarëve të qendrës së votimit.

***Z.A.Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Është vetëm një raport ai?

***Z. Y. Merkaj:*** Ky është një raport për këtë qendër votimi, por ne kemi disa, sepse kanë gabuar disa qendra votimi, në vend që ta fusin tek kutia e materialeve zgjedhore e kanë futur te valixhja e pajisjes PEI.

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Kur është mbyllur valixhja në qendrën e votimit është rihapur valixhja në ZAZ? Kur janë çuar materialet zgjedhore për t'u numëruar?

***Z. Y. Merkaj:*** Jo nuk është hapur!

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Prandaj lind dyshimi jonë lidhur me përllogaritjen e numrit të votuesve që kanë qenë në atë ku nuk paska pasur një raport për PEI dhe valixhja qenka e hapur vetëm me iniciativë të KQZ-së siç e thatë dhe ju në kuadër të kryqëzimit të të dhënave që është një kërkesë e kodit.

***Z. K. Bele:*** Më fal nëse e kuptova drejt Ylli, ka mbaruar procesi, është printuar është sigluar dhe në vend që ta fusin në kutinë e materialeve zgjedhore është futur në valixhe apo jo?

***Z. Y. Merkaj:*** Procedura është kjo, mbaron procesi i votimit përgatitet procesverbali i mbylljes së votimit dhe printohet raporti i mbylljes nga pajisja PEI. Të dyja këto procesverbale nënshkruhen nga anëtarët e komisionit të qendrës së votimit dhe si rregull duhet të futet te kutia e materialeve zgjedhore.

***Z. K. Bele:*** Pra, kemi një lapsus në disa raste.

***Z. Y. Merkaj:*** Në një rast e kanë futur.

***Z. K. Bele:*** E kanë futur në valixhen PEI.

***Z. Y. Merkaj:*** Ku është valixhja PEI duke menduar që meqënëse është raport i pajisjes PEI duhet të futet tek valixhja PEI, kështu ka menduar nga Komisioni i Qendrës së Votimit.

***Z. K. Bele:*** Diçka të fundit, ky është dokument unik i printuar apo jo?

***Z. Y. Merkaj:*** Po.

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Nuk mund ta konsiderojmë një lapsus maksimumi sipas pretendimit tonë, kjo është një qëllimshmëri dhe nuk mund të quhet lapsus se ka penguar procesin e mëtejshëm të evidencave të QV-së përkatëse





Dulaku

lidhur me zgjedhësit që kanë qenë prezent në atë QV nuk kemi të bëjmë me lapsus në këtë rast.

***Z. K. Bele:*** Është e drejta juaj ta mendoni  si të doni, por keni parasysh disa mijëra operatorë të trajnuar për pak ditë të cilët një raport të printuar dhe të firmosur në vend ta fusin te ajo kutia, e kanë futur në një kuti tjetër. Kjo nuk ndryshon as rezultatin dhe nuk ndryshon as raportin. Por nëse ne duam të ngremë dyshime për gjithshka është e drejta juaj, ne nuk ju kufizojmë dot.

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Duhen verifikuar librat e protokollit ku është evidentuar fakti që nuk ekziston raporti i pajisjes PEI. Në disa qendra votimi nuk ekziston regjistri me nënshkrimet, si qenka një lapsus ky? Kush paska votuar në këto qendra votimi?

***Z. K. Bele:*** Më fal është tjetër gjë që është paraqitur një numër i caktuar zgjedhësish dhe tjetër printimi i raportit në fund. Të thuash që nuk ekziston, sepse nuk e gjen tek kutia, nuk bën sens. Ne sot po i marrim këto raporte, sekretari thotë po printohen këto të dhëna. Të mundohemi të jemi seriozë dhe të mos krijojmë tymnajë. Jo çdo njeri në këtë sallë është teknik dhe mund ta kuptojë procesin. Edhe për ne vetë në këtë sallë ky proces bëhet për herë të parë. Ta lemë procesin të ecë normalisht dhe nëse keni dyshime në fund, rast pas rasti bëjini prezent. Do ju sugjeroja dhe miqësisht, që mos të fillonim që në këtë fazë të procesit të bëjmë pyetje... E vërteta është që u kërkua hapja e këtyre kutive dhe na lini të kryhet ky proces konform ligjit.



*Zbardhi materialin audio*
*Merita DULAKU*

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Patjetër unë nuk e vë në dyshim këtë gjë nuk e paragjykoj procesin, thjesht për saktësim duke qenë se kemi interes të ligjshëm, duam ta dijmë që të ngrejmë pretendimet tona që ta çojmë deri në fund këtë kërkesë.

***Z. Y. Merkaj:*** Të sqaroj diçka për këtë pjesë, atëherë në asn... (***nuk dëgjohet***) nuk është përcaktuar se raporti duhet futur te materialet zgjedhore, por është vetëm faqja 19 e Manualit e QV-së që thotë se ky raport duhet të futet tek kutia e materialeve zgjedhore.

***Z. L. Braho:*** Zoti Sekretar i Përgjithshëm që të jemi të saktë procesverbali i mbylljes, futet tek kutia e fletëve të votimit dhe në momentin që numëruesit hapin kutitë e fletëve të votimit ai është vetëm procesverbal që gjejnë aty dhe në bazë të atij nxjerrin numrin e votuesve. Me të drejtë shqetësimi që ngre zoti Kaziaj ka të bëjë me faktin si e kanë llogaritur numëruesit, numrin e votuesve kur nuk kanë pasur procesverbal? Ky është shqetësimi. Pra, kanë vënë një numër apriori në procesverbal.

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë ka dy procesverbale...

***Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:*** E kemi zgjidhur ne këtë kur bëmë parashtrimet tona dhe thamë që hetuam në KZAZ pse..(***nuk dëgjohet***) dhe KZAZ-ja e ka konstatuar këtë fakt në momentin kur është hapur kutia e votimit. Numrin e zgjedhësve të cilët kanë votuar, grupi i numërimt e nxjerr nga procesverbali i mbylljes së qendrës së votimit i cili është një rubrikë procesverbali 08 ku shënohet numri i zgjedhësve që kanë votuar, procesverbali i mbylljes së fletëve së votimit. Pra është fatura e PEI e cila përcakton numrin që kanë votuar, por ky numër kur mbyllet

kutia e votimit shënohet numri i zgjedhësve që kanë votuar në këtë procesverbal grupi i numërimit e ka marrë numërin zgjedhësve që kanë votuar nga ky procesverbal. Thjesht për të bërë çekimin i duhet kjo e PEI-t vetëm për të bërë kontrollin, sepse numri i zgjedhësve shënohet në procesverbalin 08 të mbylljes së kutisë së votimit që merret nga raporti i PEI-it. Për të bërë kontrollin ne prandaj jemi këtu ta hetojmë, ta kontrollojmë edhe sikur mos të jenë të dyja përsëri ka material të bollshëm zgjedhor për t'u hetuar sesi është votuar pavarësisht se janë dhe këto.

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Një saktësim të fundit, për sa i përket asaj që tha zoti Sekretar i Përgjithshëm nuk është e vërtetë është Udhëzuesi për komisionerët e qendrës së votimit një akt i miratuar nga KQZ, i cili normon pjesën e procedimit të materialeve PEI qoftë të hapjes, qoftë të kuponave individualë të votimit qoftë në procesverbalet të mbylljes. Kjo që thoni nuk është e vërtetë zoti Sekretar i Përgjithshëm. Pikë së dyti, për t'iu përgjigjur zotit Salianji. Zoti Salianji në shumë qendra votimi kemi pas mungesë të procesverbalit nr.08 dhe ku e gjeni ju sigurinë që thoni që ky proceverbal i mbylljes së PEI, i cili është në valixhen e PEI është futur më përpara se t'i jepet KQV-së të themi sekretarit për të bërë evidencat përkatëse. Ku e gjeni ju sigurinë që s'qenka futur në valixhe, qenka mbyllur aty e nuk është hapur më. Ndërkohë që ZAZ-ja konstaton mungesë të tij është shumë e thjeshtë kjo gjë.

***Z. E. Çefa:*** Avokat me mirëkuptimin tuaj do të doja të sillja në vëmendje që ne sot kemi tjetër objekt të kësaj mbledhje. Të gjitha këto në formë prapësimesh apo në formë argumentimesh apo në formë kërkesash, rezervojini për t'i paraqitur në fund kur të keni mundësinë për të dhënë konkluzionet përfundimtare. Sigurisht ne si trupë do t'i kemi në konsideratë edhe pretendimet e ngritura nga njëra palë edhe

pretendimet e palës tjetër. Nuk do të doja që ta tërhiqnim vëmendjen nga qëllimi kryesor për të cilin jemi këtu për të pasur informacionin që kemi kërkuar nga kutitë. Kështu që le të vazhdojë procesi, faleminderit.

***Z. Y. Merkaj:*** Më falni anëtarë të KAS-it, do të vazhdojë procesi i të gjithëve grupeve të numërimit apo do të vazhdojmë një nga një?

***Z. E. Çefa:*** Mendoj se për sa kohë kemi kaq tavolina atëherë të vazhdojmë njëkohësisht se nuk ka kuptim.

***Z. Y. Merkaj:*** Vazhdojmë Bledi

***GNV nr. 2, zoti B. Kodra:*** QV nr. 3431, ZAZ nr. 66 Qarku Berat është mbyllur me këto kode: 278493;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 2, zoti B. Kodra:*** 278491;
***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 2, zoti B. Kodra:*** 278495;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 2, zoti B. Kodra:*** 278498.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 3, zonja K. Nogu:*** QV nr. 3445, ZAZ nr. 66 Qarku Berat është mbyllur me këto kode: 278450;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 3, zonja K. Nogu:*** 278474;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 3, zonja K. Nogu:*** 278451;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 3, zonja K. Nogu:*** 278467.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 4, zoti A. Llano:*** QV nr. 3318, ZAZ nr. 66 Qarku Berat është mbyllur me këto kode: 278408;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 4, zoti A.Llano:*** 278417;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 4, zoti A.Llano:*** 278413;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 4, zoti A.Llano:*** 278416.

***GNV nr. 5, zoti J. Bytyçi:*** QV nr. 3431, ZAZ nr. 65 Qarku Berat është mbyllur me këto kode: 217578;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 5, zoti J. Bytyçi:*** 217576;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 5, zoti J. Bytyçi:*** 217577;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 5, zoti J. Bytyçi:*** 217579.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 6, zonja B. Bego:*** QV nr. 3270, ZAZ nr. 65 Qarku Berat është mbyllur me këto kode: 217507;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 6, zonja B. Bego:*** 217500;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 6, zonja B. Bego:*** 217502;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 6, zonja B. Bego:*** 217509;

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë, më fal zoti Çefa, grupi i parë i numërimit ka mbaruar, ka hapur kutinë dhe ka gjetur materialet, të shohim cilat materiale ka gjetur në kutinë e materialeve zgjedhore.

***Z. E. Çefa:*** Dakord! Atëherë, palët si dëshirojnë të veprojnë? Avokat, dëshironi t'i shikoni në këtë moment dhe të mbani shënime apo të bëni një kopje dhe të keni kopjen, më thoni ju?

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Ne duam sipas kërkesës, marr shembull, meqë jemi në tavolinën e parë, e cila po shqyrton materialet zgjedhore që kanë të bëjnë me qendrën e votimit 3446, nga ku janë kërkuar 4 dokumente administrative të kësaj qendre të votimit, si për këtë qendër dhe për të gjitha qendrat vijuese, 23 të tjerat vijuese, kërkojmë që të na jepet materiali i kërkuar kryesisht nga anëtarët **(shkëputet audio)** të na vihet në dispozicion një kohë e mjaftueshme, në mënyrë që ne të bëjmë kryqëzimin me provat që kemi.

***Z. E. Çefa:*** Patjetër, koha nuk diskutohet, por doja të dija vetëm mënyrën e operimit, do i shikoni njëherë në gjendjen që janë origjinalet dhe pastaj kopje apo, thjesht për transparencë?

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** I bëjmë një *check* shumë të shkurtër, për mos të marrë shumë kohë dhe të na jepet kopja në mënyrë që të bëjmë **(shkëputet audio)**

***Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së:*** Këtu është gjykuar dhe ju jeni që e kqyrni materialin zgjedhor, unë besoj se këta janë të deleguarit tuaj për procesin. Konfirmoj që ndodhen të tre dokumentet. Në momentin që ndodhen të tre

dokumentet ju, se ju do gjykoni mbi këto prova, ose i kërkoni origjinalet t'i shikoni ose kur nuk mungon dokumenti, atëherë merret kutia dhe hetohet më thellësisht, por të fotokopjosh 30 lista zgjedhësish, etj, unë e shikoj të padobishme. Pra, në qoftë se konfirmohet nga administrata, që dokumentet që keni kërkuar ju, ndodhen në dosje, ju që do gjykoni, shikoni se çfarë cilësie janë ato, kanë nënshkrime, s'kanë nënshkrime, pastaj, ne thjesht këtu jemi për t'i parë provat, për t'i kqyrur jeni ju.

***Z. E.Çefa:*** Çështja jonë nuk diskutohet, sepse ne e kemi të qartë, që do i kqyrim ashtu siç janë, tani unë për të qenë transparent me ju, ju kërkova nëse doni kopje? Nëse i kqyrni...**(shkëputet audio)**

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Duam kopje dhe bërja e disa fotokopjeve, nuk mund të cenojnë një...**(shkëputet audio)** dhe duhet të japë transparencë të mjaftueshme te qytetarët. Tani, në qoftë se disa kopje, fotokopje, cenojnë procesin, sipas përfaqësuesit të PS-së, nuk e marr me mend...

***Z. L. Braho:*** Zoti Kaziaj, pyetja është, listat që kanë 50 faqe, 100 faqe, e shihni që nuk ka asnjë nënshkrim, ka vlerë të fotokopjohet ajo? Në qoftë se ka një nënshkrim **(shkëputet audio)**

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Patjetër, por duhet të na lihet kopja për t'i kqyrur dhe materialisht këtu, se në qoftë se një listë zgjedhësish, siç thatë ju, zoti Braho, ka 50 faqe, duhet ta shohim faqe më faqe, dhe nënshkrim më nënshkrim, dhe të mbajmë evidencat, keshtu që dhe ne duam kohë të mjaftueshme për ato.

***Z. Y. Merkaj:*** Lista nuk jepet. Mund t'i shikoni këtu, por nuk jepet lista sepse ka të dhëna sensitive personale, që nuk mund të jepet.

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Cila është arsyeja që nuk mund të jepet?

***Z. Y. Merkaj:*** Ka nënshkrimet e zgjedhësve, nuk mundet.
Atëherë, sipas procedurës duhen listuar njëherë provat, duhen administruar njëherë provat, sipas procedurës, pastaj anëtarët e grupit të numërimit do të verifikojnë sipas kërkesës së subjektit ankues dhe udhëzimet e KAS-it, se cilat janë dokumentet që ndodhen dhe duhet të numërojnë sipas nënshkrimeve, tek lista e zgjedhësve, por kam idenë që nuk do jenë të gjitha listat e zgjedhësve me nënshkrime sepse ka qenë udhëzimi që nuk duhet të ketë nënshkrime tek lista e zgjedhësve, duhet të hiqet vetëm viza e emrit që voton.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Po, kur jemi në mungesë të qendrës së votimit dhe të raportit PEI dhe lista e zgjedhësve nuk është nënshkruar, zoti sekretar i Përgjithshëm, si është procedura në këtë rast?

***Z. K. Bele:*** Më fal, a marrim njëherë produktin dhe pastaj gjykojmë? Se po hapëm ndonjë diskutim, ngelëm në vendnumëro. Marrim produktin, çfarë do na nxjerrin 6 kutitë e para dhe..

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë, grupi i parë mbaroi?

***Z. L. Braho:*** Atëherë, zoti Kaziaj 3446 keni ngritur pretendimin se votimi është kryer me listë, pa kaluar sipas paisjes PEI, u gjet lista *hardcopy* me nënshkrimet,

grupi i numërimit numëroi sa nënshkrime janë dhe sipas listës dalin kaq. Në qoftë se gjendet kuponi PEI në një moment tjetër, dakord.

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë më falni, mund të vazhdoj me grupin e dytë të numërimit?

***Z. E. Çefa:*** Atëherë, zoti sekretar i përgjithshëm, ju lutem, për shkak se në kutinë e materialeve të qendrës së votimit 3446, nuk u gjet procesverbali 08, atëherë do të na duhet që të hapim dhe kutinë e votimit për të parë administrimin e procesverbalit. **(shkëputet audio)**

***Z. Y. Merkaj:*** Po vazhdojmë!

***Z. B. Kodra:*** Kutia e votimit e qendrës 3446, është mbyllur me kodet 27 82 11

***Znj. E.Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. B. Kodra:*** 27 85 14, 27 85 17, 27 85 18

***Znj. E.Çeço:*** Konfirmohet! Edhe lart

***Z. B. Kodra:*** Dhe lart, me kodet 27 88 97

***Znj. E.Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. B. Kodra:*** Atëherë në këtë kuti votimi, krahas fletëve të vendosura në zarf, gjendet dhe ky procesverbal.

***Z. E. Çefa:*** Atëherë, zoti Sekretar i Përgjithshëm në këtë fazë janë administruar procesverbalet e konstatimit në kuti për secilin grup. Janë administruar edhe një kopje të kolonave që do t'i shëpërndahen palëve, po ashtu dhe anëtarëve të KAS-it. Kështu që ne mund të procedojmë me administrimin e provave, të marrim vendim për mbylljen e këtyre kutive dhe zëvendësim me gjashtë kutitë e tjera sipas rradhës. Dakord vijojmë.

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë, sipas grupeve të numërimit do vijojmë, do të lexon numrat e kodeve me të cilat do të mbyllen kutitë. Kjo është kutia e materialeve, tani po mbyllni kutinë e votimit.

***GNV 1 L. Marviqi:*** Kodet e sigurisë 283925 , 283959, 283953, 283956.
Kutia e votimit mbyllet me kodet 283958, 283918, 283950, 283912.

***GNV 2. A. Xhaferri:*** Kutia me numër 3431 mbyllet me këto kode: 283952, 283954, 283951, 283957.

***GNV 3. S.Toska:*** Kutia 3445 mbyllet me këto kodet sigurisë 283914, 283910, 2839 19, 283911.

***GNV 4. A. Llano:*** Kutia me numër 3318 mbyllet me kodet 283913, 283916, 283915, 283917.

***GNV 5. J. Bytyçi:*** QV 3275 mbyllet me kodet e sigurisë: 283901, 283903, 283906, 283907.

***GNV 6 B. Bego:*** Kutia me numër 3270 mbyllet me kodet 283947, 283944, 283940, 283942.

***Z. E. Çefa:*** Atëherë, nëse jemi gati fillojmë me kutitë e tjera 3287 nga grupi numër 1, kutia 3307 grupi numër 2, kutia 3472 tavolina numër 3, kutia 3473 tavolina numër 4, kutia 3482 tavolina numër 5 dhe kutia 3325 në tavolinën numër 6.

***GNV 1 L. Marviqi:*** Vazhdojmë QV 3307 është mbyllur me kodet e sigurisë 217302, 217303, 217301, 217300

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV 2.B. Kodra:*** Kutia me materiale zgjedhore QV 3287 është mbyllur me kodet 217202, 217269, 217255, 217268.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV 3. S. Toska:*** Kutia e materialeve zgjedhore 3472, është mbyllur me këto kode: 323383, 323386, 323381,323382

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV 5. J.Bytyçi:*** QV 3482 është e mbyllur me kodet e sugurisë 323093, 323094, 323097, 323399.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV 6 B. Bego:*** QV 3325 është e mbyllur me këto kode sigurie: 278741, 278740, 278748, 278720.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV 4 A. Llano:*** ZAZ nr.63 kutia 3473 ka këto numra vulash 323472, 323473, 323479, 323478

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. Y. Merkaj:*** Zoti Çefa kanë mbaruar 6 grupet e numërimit.

***Z. E. Çefa:*** Po zoti Sekretar i Përgjithshëm.

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë, në përfundim të procesit mbyllim kutitë duke filluar nga QV 3307, me grupin e parë të numërimit me kodet.

***GNV 1. L. Marviqi:*** Me kodet e sigurisë 283925,283969,283921,283967.

***GNV 2. B. Kodra:*** Kutia e votimit me numër 3287 mbyllet me kodet 283836, 283837, 283833, 283839.

***GNV 3. S. Toska:*** Kutia 3472 e ZAZ nr.63 mbyllet me kodet: 283838, 283835, 283832, 283834.

***GNV 4. A. Llano:*** Kutia 3473 KZAZ nr.63. Qarku Berat, u mbyll me këto kode sigurie: 283924, 293923, 283929, 283920.

***GNV 5. J. Bytyci:*** Kutia me numër 3482 mbyllet me kodet: 293905, 283908, 283900, 283902.

***GNV 6. B. Bego:*** Kuttia me numër mbyllet me kodet e sigurisë: 283941, 283948, 283949, 283945.

***Z. E. Çefa:*** Mund të vahzhdojmë me 6 kutitë e rradhës.

***Z. Y. Merkaj:*** Duke filluar nga QV 3456, 3440, 3330, 3433, 3328, 3429/1.

***GNV 1. L. Mavriqi:*** ZAZ nr.67, QV 3456 kodet janë: 262677, 262645, 262644, 262653.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV 2. B. Kodra:*** Kutia e materialeve zgjedhore e QV 3440, ZAZ nr.66, Qarku Berat ka këto kode 278479, 288477, 278475, 278470.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV 3. K. Nogu:*** QV 3330, KZAZ nr.66 është e mbyllur me kodet: 278705, 278767, 278760, 278763

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV 4. E. Toporja:*** Kutia e materialeve zgjedhore me numër 3433 KZAZ nr.66. Qarku Berat është i mbyllur me këto kode sigurie: 278009, 278007, 278006, 278004.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV 5. J. Bytyçi:*** Kutia e materialeve zgjedhore e QV 3328, KZAZ nr.66 hapet me kodet e sigurisë: 278392, 278241, 278393,278390.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV 6. B. Bego:*** QV 3429/1 është e mbyllur me këto kode: 278541, 278549, 278554, 278540.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV 1. F. Kapllani:*** Kutia me numër 3456 mbyllet me kodet e sigurisë: 283922, 293971, 283965, 283979.

***GNV 4. E. Toporja:*** Kutia e materialeve zgjedhore 3433 KZAZ 66, Qarku Berat mbyllet me këto kode sigurie: 283970, 283976, 283973, 283974.

***GNV 3. S. Toska:*** Kutia e materialeve zgjedhore me numër 3330 mbyllet me këto kode sigurie: 283977, 283978, 283972, 283975.

***GNV 2. B. Kodra:*** Kutia e materialeve zgjedhore me numër 3440 mbyllet me kodet e sigurisë: 283928, 283963, 283926, 283960.

***GNV 5. J. Bytyçi:*** Kutia e materialeve zgjedhore e QV 3328, KZAZ nr.66 mbyllet me kodet e sigurisë: 283961, 283966, 283964, 283968.

***GNV 6. B. Bego:*** QV 3429/1 mbyllet me këto kode sigurie 283934, 283936, 283935, 283937.

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë, mbaruan edhe 6 kutitë që u hapën.

***Z. E. Çefa:*** Atëherë, bëjmë 1 orë pushim dhe rinisim përsëri.

**Rifillon Mbledhja**
**Ora: 15:19**

***Z. E. Çefa:*** Përshëndetje! Rifillojmë sërish seancën, janë edhe 6 kutitë e fundit. Kështu që do fillojmë më Kutinë 3429/1 te tavolina nr.1 dhe kështu me rradhë.

***Grupi i numërimit:*** Kutia e Materialeve Zgjedhore 3501 KZAZ 64 Qarku Berat është mbyllur me vulat e sigurisë 287504, 287500, 287509, 287507 dhe u rimbyll me kodet 283853, 283855, 283857, 283850.

***Grupi i numërimit:*** Kutia e Materialeve Zgjedhore 3518 KZAZ 64 Qarku Berat është mbyllur me vulat e sigurisë 287282, 287284, 287281, 287286 dhe u rimbyll me kodet 283840, 283846, 283845, 283843.

***Grupi i numërimit:*** Kutia e Materialeve Zgjedhore 3518/1 KZAZ 64 Qarku Berat është mbyllur me vulat e sigurisë 287290, 287299, 287298, 287296 dhe u rimbyll me kodet 283817, 283816, 283822, 283828.

***Grupi i numërimit:*** Kutia e Materialeve Zgjedhore 3513 KZAZ 64 Qarku Berat është mbyllur me vulat e sigurisë 287269, 287243, 287244, 287245 dhe u rimbyllm me kodet 283844, 283802, 283801, 283820.

***Grupi i numërimit:*** Kutia e Materialeve Zgjedhore 3416 KZAZ 64 Qarku Berat është mbyllur me vulat e sigurisë 287528, 287527, 287522, 287523 dhe u rimbyll me kodet 283904, 283927, 283909, 283962.

***Grupi i numërimit:*** Kutia e Materialeve Zgjedhore 3441 KZAZ 64 Qarku Berat është mbyllur me vulat e sigurisë 278449, 278700, 278465, 278466 dhe u rimbyll me kodet e sigurisë 283943, 283946, 283939, 283938.

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë sapo kanë përfunduar kutitë për t'u numëruar, urdhëruar nga KAS për t'u hapur. Janë nxjerrë materialet që gjendeshin në kutitë e materialeve

zgjedhore, është mbajtur procesverbal ku është evidentuar çdo provë që është gjetur si dhe janë mbyllur përsëri kutitë me kodet e sigurisë, faleminderit.

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit, zoti Sekretar i Përgjithshëm, faleminderit dhe adminitratës për punën. Ndërkohë përfaqësuesit e palëve besoj e kanë marrë nga një kopje të procesverbaleve të konstatimeve.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Po, përveç pjesës së fundit të kutive, që besoj do na jepet në këto momente, e kemi marrë një kopje.

***Z. E. Çefa***: Përfaqësuesi i PD-së, e keni marrë një kopje?

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Po, përveç këtyre të fundit na mungojnë dy kopje.

***Z. E. Çefa:*** Përfaqësuesi i PS-së, e keni kopjen tuaj apo jo?

***Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:*** Po.

***Z. E. Çefa:*** Përveç provave që përfunduan së marri dy anëtarë të KAS-it kanë kërkuar gjithashtu edhe raportin e rezultatit të procesit të kryqëzimit të dhënave daktiloskopike të Qarkut Berat, marrë nga pajisja PEI. Duke qenë se na është vënë materiali në dispozicion, besoj se dhe kjo do të duhet të administrohet në cilësinë e provës dhe të shpërndahet nga një kopje palëve në mënyrë që t'a kenë në konsideratë gjatë hartimit të konkluzioneve përfundimtare. Duke qenë se me marrjen e këtyre provave e konsoiderojme të përfunduar hetimin administrativ do

të kërkoja mendimin e gjithë secilit prej jush, për të vlerësuar provat e reja dhe për të hartuar konkluzionet në mënyrë që të hartojmë pastaj ditën kur duhet të rimblidhemi. Shpresojë për herë të fundit për Beratin.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Po, i nderuar zoti relator siç thamë, ne morrëm pjesë në provat që ishin në shqyrtim administrativ për Qarkun Berat, duke parë dokumentacionion voluminoz kerkojmë nga KAS një afat të arsyeshëm mendoj që për mëngjesin e ditës së mërkurë jemi gati me pretendimet tona përfundimtare.

***Z. E. Çefa:*** Avokat, ju lutem si jeni me provat?

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Po, jemi dakord me kolegët e LSI-së.

***Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:*** Unë do të kisha parasysh afatin që ishte një afat 10 ditorësh, i shqyrtimit administartiv dhe besoj dhe do kërkojë mirëkuptimin e dy ankuesëve u bë një punë e madhe dhe u njohëm me gjithë dokumentacionin. Shpresojmë se 24 orë kohë është e mjaftueshme për shqyrtimin për arsye siç e dini dhe ju afatet janë afate shumë të ngushta shqyrtimi dhe na pret dhe një kërkesë tjetër që dhe ajo është për t'u shqyrtuar. Do dhe ajo kohë relativisht të gjatë besoj 10 ditore prandaj kërkojë mirëkuptim mos të zgjatet 2 ditë. Nesër duhet të lemë patjetër një seancë për Beratin.

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit, avokat. Atëherë ne ramë dakord me shumicë që t'ju rakordojmë kohë deri pasnesër ditën e mërkure orën 10:00 do të jetë seanca që do të përmbyllet për shqyrtimin e pavlefshmërisë. Nesër do të vijojmë me kërkesën ankimore të Gjirokatrës dhe Vlorës.

***Z. L. Braho:*** Duke qenë se unë jam relatori i kërkesave nr. 33, 41 dhe 52 që kanë të bëjnë më Qarkun e Gjirokatrës, po ashtu sot na u vu në dispozicion dhe rezultati i procesit të kryqëzimit të dhënave të zgjedhjeve për Qarkun e Gjirokastës. Besoj është vënë në dispozicion dhe palëve po ashtu ishin dhe ato emrat që duhet të identifikoheshin nqs kanë qenë komisioner apo jo. Besoj se janë vënë në dispozicion këto të dhëna palëve, nuk ka prova të tjera për sa i përket Qarkut Gjirokatër dhe  besoj se deri ditën e nesërme është e mjaftueshme koha për të depozituar konkluzionet përfundimtare për Qarkun e Gjirokastrës. KAS nesër në orën 10:00 do të vijojë me seancën e radhës për Qarkun Gjirokastër dhe nesër është faza per konkluzionet përfundimatre për secilën nga palët dhe më tej do vendoset në lidhje me shpalljen e vendimit.

***Z. E. Lako:*** Atëherë, mqs nesër mbas Gjirokastrës do të shqyrtojmë dhe Qarkun Vlorë, për orën e fillimit të procesit të Vlorës do ta marrim nga seanca e parë e Gjirokastrës, që do të njoftojmë nesër në vazhdimësi, faleminderit.

**19.05.2021**
**Ora 15:15**

***RENDI I DITËS***

***Projektvendimi: Shqyrtimi i kërkesave ankimore nr.34 "Ndryshimi i vendimit 339, datë 04.05.2021 të KSHZ "Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit Qarku Berat", "Rinumërimi dhe rivlerësimin e votave për ZAZ-të 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68", subjekti ankues LSI dhe nr. 35 "Kundërshtimi i vendimit 339, datë 04.05.2021 të KSHZ "Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit, Qarku Berat", "Shpalljen e pavlefshme të procesit të votimit në qendrat e votimit të Qarkut Berat si dhe përsëritjen e zgjedhjeve", subjekti ankues LSI".***

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** **Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI, Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**
- **Stafi KQZ: Y.Merkaj, O.Peto**
- **Parti Politike: PD - AN, PS, LSI**

*Z. E. Çefa:* Mirëdita të gjithëve! Atëherë, rifillojmë seancën për shqyrtimin e kërkesave ankimore me numër 34, datë 15.05.2021 të subjektit zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim, të kërkesës ankimore nr. 35 datë 9.5.2021 përsëri të subjektit zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim dhe të kërkesës ankimore nr. 42 datë 9.05.2021 të subjektit zgjedhor PD- AN. Sipas urdhërimeve të Kodit Zgjedhor, kjo seancë është për shqyrtimin konkretisht të kërkesave me anë të cilët, kërkesave ankimore me anë të të cilave kërkohet pavlefshmëria e zgjedhjeve. Pra, kundërshtimi i vendimit nr.339 datë 04.05. 2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe pavlefshmëria e zgjedhjeve në zonën zgjedhore Qarku Berat, që përfshihen konkretisht në kërkesat ankimore numër 34 dhe numër 42. Sikundër Kodi Zgjedhor urdhëron kërkesën ankimore nr. 35 do t'a bëjmë në një fazë të dytë, të kësaj seance. Në seancën apo në pjesën e kaluar të kësaj seance KAS-i administroi si provë sipas

kërkesës të subjektit zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim 24 kuti, të materialeve zgjedhore të cilat u hapën dhe u administruan provat e kërkuara. Besoj që tashmë nuk ka prova të tjera dhe ne mund të kalojmë në konformitet me nenin 141 të kodit në mbyllje të hetimit administrativ. Por gjithësesi përpara se të shkojmë këtu, për procedurë do të më duhet të verifikojë prezencën e palëve. Janë prezent administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, është prezent përfaqësuesi i subjektit ankimues Lëvizja Socialiste për Integrim, është prezent përfaqësuesi i subjektit tjetër ankimues PD-AN, është prezent edhe perfaqësuesi i subjektit të interesuar Partia Socialiste. Ndonjë kërkesë paraprake? Po avokat!

***Z. E. Salianji përfaqësues i PS-së:*** Gjatë shqyrtimit administrativ në kutinë në QV 3446, u vu rë që gjatë hapjes së kutisë së materialeve zgjedhore mungonte procesverbali i mbylljes. Nga konsultimi me KZAZ-në dhe komisionerët e QV të subjektit të Partisë Socialiste, njoftohemi se KZAZ e ka dorëzuar në Lundër procesverbalin, por pse nuk është këtu nuk e dimë. Pra, është një defekt dorëzojnë dosjen në Lundër dhe ky procesverbal nuk është paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve por meqenëse është një procesverbal model 08 ku të gjithë partitë politike që kanë komisionerët në QV, marrin nga një kopje, kopja origjinale futet në kutinë e votimit kurse kopjet e tjera i marrin partitë politike. Ne disponojmë procesverbalin i cili është marrë nga komisioneri i Partisë Socialiste, me firmat e të shtatë anëtarëve me vulën e QV dhe e paraqesim si provë, si dokumentacion zgjedhor për të vërtetuar orarin e mbylljes së QV dhe të dhënat që përmban ky procesverbal.

***Z. E. Çefa:*** Po zoti Kaziaj!

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Faleminderit zoti relator i çështjes. Kjo provë e depozituar në këtë moment nga ana e përfaqësuesit të Partisë Socialiste, nuk mund të merret në shqyrtim nga ky komision për shkak se seancën e shkuar me vendimmarrje të dy anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, është kërkuar hapja e 24 kutive objekt ankimi nga Lëvizja Socialiste për Integrim. Është bërë hapja e 24 kutive përfshi edhe kutinë që zoti Salianji citoi , lidhur me këtë procesverbal, është mbajtur nga administrata e KQZ-së grupi i numërimit përkatës procesverbali ku konstaton mungesë në hapjen e kutisë së votimit. Nuk e dimë mënyrat se si ka ardhur në posedim të zotit Salianji të këtij procesverbali ndërkohë që vetë ai sapo na pranoi një fakt shumë të rëndë të cilin thotë e kishin depozituar në Lundër, ndërkohë nga Lundra paska fluturuar ky dhe paska ardhur procesverbali direkt në duart e zotit Salianji. Për të mos e hetuar më tej këtë çështje themi që konstatimi efektiv i dokumentacionit të kërkuar nga ana e dy anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve është konstatuar nga disa palë që janë super partes që është administrata e KQZ-së dhe në brendësi të kutisë së votimit nuk është gjetur ky procesverbal. Është mbajtur një procesverbal i hapjes së kutisë së materialeve zgjedhore të QV për të cilën flasim dhe konstatimi që nuk është gjendur në brendësi. Ju lutem nuk duhet të administrohet në të mirë të besueshmërisë së këtij procesi, faleminderit!

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit! Po zoti Bele.

***Z. K. Bele:*** Të njihemi me këtë dokument, desha në parantez të them që ne jemi të detyruar t'a shqyrtojmë pastaj vlefshmëria e tij është tjetër histori. Shoh që lexon model KQV 8, zoti Sekretar i Përgjithshëm, ky procesverbal KQV 8, ky është procesverbal që e ka KQV apo i jepet edhe palëve.

***Zbardhi materialin audio***
***Ardita VRIONI***

***Z. Y. Merkaj:*** Është procesverbali i mbylljes së kutisë së votimit i cili i shpërndahet edhe palëve, edhe anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit.

***Z. K. Bele:*** E shoh që është një letër...

***Z. Y. Merkaj:*** Letër kimike.

***Z. K. Bele:*** Kopiative se nuk po gjeja fjalën. Pra, kjo është një nga?

***Z. Y. Merkaj:*** Një nga ato kopjet e letrës.

***Z. K. Bele:*** Kopje. Mund t'a shihni edhe ju se e shoh që është dhe me shkrim dhe me vulë të njomë, mund t'a shihni edhe ju të konfirmoni a është ky dokument unik të paktën pastaj a është i vlefshëm apo jo është bisedë tjetër? Më fal edhe zoti Salianji e shpjeguat, se ndoshta unë e humba.

***Z. E. Salianji përfaqësues i PS-së:*** Partia Socialiste disponon të gjithë procesverbalet e mbylljes në të gjithë Shqipërinë. Është një detyrim në Kodin Zgjedhor që me mbylljen e procesit të votimit palët, kur mbyllet procesi i votimit marrin një kopje të procesverbalit të mbylljes. Ky është dokumentacion zgjedhor, i cili në rastin më të mirë i shërbën transparencës së procesit. Nuk është një dokument i prodhuar, aty ka firmosur edhe anëtari i LSI-së edhe anëtari i PD-së. Merreni verifikojeni, kanë firmosur anëtarët që ju keni pasur në Komisionin e Qendrës së Votimit po ose jo. Është dokumentacion i çuar nga KQZ, pra është format i KQZ-së, po kopja.

*Zbardhi materialin audio*
*Ardita VRIONI*

***Z. Y. Merkaj:*** Ky është formati i miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është një nga... Një kopje e këtij dokumentacioni, që i është dhënë partive.

***Z. K. Bele:*** Është kopje e një dokumeti zyrtar të lëshuar nga KQZ firmosur...

***Z. Y. Merkaj:*** Po nga Komisioni i Qendrës së Votimit.

***Z. K. Bele:*** Në rregull, faleminderit!

***Z. E. Çefa:*** Po zoti Kaziaj, urdhëro!

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Zoti Bele, kjo kopje që ju sapo morët dhe u njohët me të, sipas udhëzuesit, të KSHZ-së duhet të jetë në brendësi të kutisë së votimit më falni, vetëm t'a mbaroj. Dhe kjo cënon vijimësinë e mëtejshme të procesit nga QV në dorëzimin e materialeve zgjedhore në ZAZ dhe në numërim më tej. Si i paska numëruar, si paska vijuar numërimi, si mbi çbazë, mbi çfarë të dhënash? Kur ky është një e dhënë që mban procesverbali mbi numrin e votave, mbi numrin e votuesve, mbi numrin e votave të pavlefshme, mbi gjinia femër që ka votuar në atë .. Ndërkohë që nuk gjendet në asnjë.. dhe ne hapëm edhe jo vetëm kutinë e materialeve zgjedhore po hapëm edhe kutinë e fletëve të votimit dhe nuk u gjet. Si ka vijuar procesi numërimit në atë rast?

***Z. K. Bele:*** Jam dakord, po ajo që desha unë të kuptojë është nëse në supozim, që t'i ikim debatit. Është një dokument që hartojmë në 6 kopje, 5 kopje i kemi ne në tavolinë, dhe një kopje e ka zoti Ylli për qëllim që t'a mbaj në KQZ. Për një arsye

X nuk e gjejmë dot kopjen e zotit Yllit. Nëse një nga ne sjell kopjen e vet të firmosur nga 5 anëtarët e cila nuk gjendet tek zoti Ylli, por gjendet tek secili nga ne. Unë them në pamje të parë nuk mendoj se ka ndonjë gjë të paligjshme, nëse ka një dyshim për firmat tona apo ngrihet dikush dhe thotë nuk është kjo vula apo ekzistenca e këtij dokumenti kundërshtohet, kjo është bisedë tjetër. Po së pari të biem dakord është dokumenti zyrtar i nënshkruar nga palët, pastaj hajde të gjykojmë pse nuk u gjet në kuti ...

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Atë nuk e vlerësojmë dot as ne, as ju. Nuk është kazusi ky që thatë ju. Atje është marrë vendimmarrje mbi mos pasjen e dokumentit dhe ju atë kazus në këtë rast nuk e keni të themi analog me çështjen që po diskutojmë. Për shkak se në atë rast, ju pa vendimmarrje ose në qoftë se jeni i njëjti organ mund ta diskutoni të njëjtin procesverbal ose kopje të tij. Po këtu flasim për vendimmarrje të disa proceseve të mëvonshme, të cilat kanë përmbyllur procesin e tyre me një tabelë përmbledhëse mbi mos pasjen e një procesverbali të tillë. Kjo është problematika.

***Z. K. Bele:*** Ne bashkarisht ngecëm tek kutia e parë sepse nuk po gjenim atë procesverbal. Më është fiksuar edhe numri ishte 324 në 327 dhe në momentin e parë të gjithë thamë ku është procesverbali hapëm edhe kutinë. Unë besoj që palët kanë pasur atë procesverbal për arsye që unë nuk di, lajthitje gabim çfarë të duash, nuk e kanë futur në kuti. Nëse ky procesverbal do të prodhonte një të dhënë të ndryshme, apo do ishte i pa firmosur nga palët, apo i pa vulosur ne drejtësisht do dyshonim mbi besueshmërinë e një dokumenti. Por kur një nga kopjet autentike të dokumentit na prezantohet për të provuar aq sa mund të provojë përputhshmërinë e dokumentit me përmbatjen e kutisë, ne nuk mund t'a refuzojmë dokumentin apriori, pyetjet që ju

shtroni dhe problemet që ju shtroni pse ata , ku e çuan, ore të hetohen nuk e kam problem atë. Por ne nuk mund t'a refuzojmë dokumentin sepse nuk e gjetëm atje ku ishte dhe gjetëm një kopje. Rëndësi ka që dokumenti është autentik, ka firmat, ka vulat dhe përmbatja e dokumentit përputhet për aq sa përputhet me atë të Qendrës së Votimit. Kjo ishte ajo që unë doja të thosha nuk është e thënë që të biem dakord.

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Qartë, jeni shumë i qartë. Fakti është që nuk është çështja e refuzimit të dokumentit është çështja e refuzimit të rezultatit të dalë nga mospasja e dokumentit. Janë dy çështje shumë të ndryshme zoti Bele mbi atë bazë domethënë ZAZ dhe VNV ka miratuar akte duke mos pasur një dokument. Si ka dalë në konkluzion në bërjen e tabelës finale dhe më pas Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në bërjen e tabelës finale për Qarkun e Beratit kur nuk ka një dokument të një QV dhe nuk jemi as ne si përfaqësues ligjor të subjekteve të caktuara as ju si anëtarë të KAS-it në gjëndje të vërtetojmë vërtetësinë e dokumentit në këtë rast.

***Z. K. Bele:*** Dokumenti është unik dallohet, është në format të caktuar, ka një vulë zyrtare ka dhe firmat e katër anëtarëve, shtatë sa janë, dhe ne pavarësisht nga dyshimet e arsyeshme që mund të ngremë në fund të ditës është e njëjta kuti me vula është hapur është numëruar, është mbyllur, duhet të ishte procesverbali aty, nuk e dimë përse nuk është aty. Por rëndësi ka që ka një kopje të atij procesverbali i cili provon vullnetin e atyre njerëzve që në fund të procesit kanë mbajtur procesverbalin përkatës.

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** A mundet t'i bëj një pyetje Sekretarit të Përgjithshëm i nderuar relator. Zoti Sekretar në bazë të akteve nën ligjore të KQZ-së, në qoftë se nuk gjendet ky procesverbal në materialet zgjedhore, në kutinë e

materialeve zgjedhore si vijon më tej procedura në ZAZ dhe në VNV? Mbi bazën e secilës përllogaritje le të themi?

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë, procedura është e tillë, si rregull procesverbali origjinal, kopja origjinale duhet të jetë në kutinë e fletëve të votimit. Një fotokopje e këtij duhet të jetë kutia e materialeve zgjedhore. Në qoftë se tek asnjë nga këto nuk gjendet atëherë grupi i numërmit do të shikojë listën e zgjedhësve dhe do të numërojë fletët e votimit të papërdorura, fletët e votimit të përdorura dhe këtu do dal rezultati jo direkt por indirekt.

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Ju jeni të bindur që kanë qenë fletët e votimit të përdoruara dhe të papërdorura dhe lista e zgjedhësve të bëra në këtë QV? A mund të hetojmë pak të nderuar anëtarë të KAS-it lidhur me problematikat e kësaj QV? Se më duket shumë e rëndë kjo problematikë.

***Z. Y. Merkaj:*** Unë shpjegova si është procedura dhe rregulli. Nuk u përqëndrova tek kjo Qendër Votimi. Kjo është procedura dhe rregulli në qoftë se do na kërkojnë një udhëzues ose ndonjë sugjerim.

***Z. E. Çefa:*** Ju lutem të respektojmë rradhën që të dëgjohemi secili. I kisha dhënë fjalën zotit Logu në fakt. Nëse më lejoni meqenëse ka diçka konkrete.

*Zbardhi materialin audio*
*Ardita VRIONI*

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Faleminderit i nderuar! Së pari është e rëndësishme po themi, të shpjegohet se cili është pretendimi që është ngritur nga subjektet ankuese. Pra, subjektet ankuese nuk pretendojnë që ky procesverbal nuk ekziston diku në hapësirë etj.. Ky procesverbal fton subjektet ankuese, konkretisht LSI nuk gjendet as në kutinë e fletëve të votimit dhe as në kutinë e materialeve zgjedhore. Tani le t'a kalojmë debatin, mendoj unë në shinat të themi të Kodit Zgjedhor, neni 116 dhe 116/1. Siç me të drejtë tha dhe Sekretari i Përgjithshëm, normalisht procesverbali i mbylljes së votimit duhet të ishte në kutinë e fletëve të votimit, ku konstatohet se nuk u gjet në kutinë e fletëve të votimit. Pa filluar numërimi, grupi i numërimit vendos të hapë kutinë e materialeve zgjedhore, ose kutinë e materialeve të votimit. Kur nuk gjendet as aty thotë neni 116/1 pika 4, më pas kryhen disa verifikime dhe mbahet një procesverbal i konstatimit që duhet të mbahet nga ana e KZAZ-së. Kështu që duke qënë se është me interes të verifikojmë deri në fund se çfarë ka ndodhur në këtë rast. Unë mendoj se është e rëndësishme, që të interesohemi për materialet zgjedhore që ka depozituar KZAZ-ja përkatëse, nëqoftëse ka një procesverbal konstatimi për këtë çështje, të gjitha shënimet që janë bërë në librin e protokollit të KZAZ-së përkatëse, në mënyrë që të nxjerrim të vërtetën deri në fund. Dokumenti që u vu në dispozicion duhet parë sepse askush nga ne këtu nuk mund të thotë nëqoftëse është me saktësi dokumenti origjinal, është dokument tjetër apo kështu me rradhë. Mendoj që të kërkohen veprimet të tjera shtesë, siç është marrja e procesverbalit konstatimi nga KZAZ-ja dhe libri i protokollit për të konstatuar se çfarë ka ndodhur me këtë qendër votimi, faleminderit!

***Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:*** Ju lutem një sqarim që mund të ndihmojë dhe zotin Lako.

***Z. E. Çefa:*** Dakord, vazhdoni zoti Salianji.

***Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:*** Në momentin e numërimit të kësaj qendre votimi, procesverbali origjinal ka qënë në kutinë e votimit dhe në kutinë e materjaleve zgjedhore. Mbasi është numëruar kjo kuti, pastaj nuk është rifutur që ne ta rigjenim këtu. Në vendin e numërimit të votave nuk ka ekzistuar kjo problematikë, se po të kishte ekzistuar, do të kishim shënime nga KZAZ-ja që mungon. KZAZ-ja në momentin e hapjes së kutisë nuk ka munguar, në momentin e mbylljes pasi janë numëruar fletët e votimit, ky procesverbal nuk është futur që ne ta rigjenim kur u hap kutia këtu dhe përderisa kjo problematikë nuk është trajtuar nga KZAZ-ja do të thotë që s'ka...në momentin e shoqërimit, kutitë, materialet zgjedhore. Se është numëruar. Nëqoftëse do të mungonte procesverbali, në momentin e hapjes, KZAZ-ja do t'a kishte evidentuar këtë si fakt. Ky fakt ka ndodhur mbas numërimit të fletëve të votimit, që ata nuk e kanë rifutur. Dhe prova që unë paraqita tregon një pamje të qartë që në qendrën e votimit procesi është zhvilluar i rregullt dhe ka firmat e 7 anëtarëve. Në numërim kutia ka shkuar e rregullt bashkë me procesverbalin brenda dhe është numëruar. Kur kanë qënë fletët mbi tavolinë dhe procesverbali në tavolinë, numëruesit e kanë harruar t'a fusin procesverbalin në kuti për efekt hetimi dhe ky procesverbal ka qënë në dosjen e KZAZ-së.

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit zoti Salianji! Po zoti Rusmali.

***Z. I. Rusmali:*** Se më duket se ne largohemi nga çështja që duhet të zgjidhim, që duhet të vendosim. Pyetja është, nëqoftëse keni informacion, të dy subjektet PD-ja

dhe LSI-ja. Kuptova që secila palë në proces pajiset me kopje të këtij procesverbali të mbylljes së kutisë...

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Më falni zoti Rusmali. Ai procesverbal është në katër kopje apo jo zoti Sekretar i Përgjithshëm?

***Z. I. Rusmali:*** Kush i merr kopjet?

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Anëtarëve të QV-së tonë, pjesa dërrmuese e të gjitha QV-ve në të gjithë Republikën e Sqipërisë në 5199 QV, nuk i është dhënë kopje e atij procesverbali.

***Z. I. Rusmali:*** Anëtarëve të QV-së të propozuar nga PD-ja?

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** I nderuar, ky është një informacion që ne duhet t'a verifikojmë.

***Z. I. Rusmali:*** Po do e verifikoni?

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Në këtë moment nuk kam informacion nga të gjithë anëtarët...

***Z. I. Rusmali:*** Deri në këtë pikë ku jemi ne, e kqyrët këtë material? Keni dyshime për fallsitet, për mungesë vërtetësie, qoftë deri në këtë pikë, mund t'ju vijë më vonë, nuk ka rëndësi, por deri në këtë pikë që po diskutojmë, keni dyshime?

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Nga ana jonë nuk është fare i nderuar, por gjithsesi kërkojmë që të verifikohet bashkë me anëtarët e QV-së që kanë qënë përfaqësues të PD-së në Komisionin e Qendrës. Do të na duhet kohë që të diskutojmë se unë aty nuk mund t'ju them me saktësi firmat e kujt janë.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Mund të sjell në vëmendje të komisionit një fakt?

***Z. L. Braho:*** Tani biem të gjithë dakord që kjo është kopje dhe nëqoftëse i referohemi Kodit të Procedurës Civile sepse dhe Kodi Zgjedhor referon sa i përket provave. Kemi të bëjmë me kopje të nenit 251, kopje e shkresës origjinale të saj. Kopje e shkresave kur saktësia vërtetohet nga personi kompetent, kanë të njëjtën fuqi provuese me origjinalin. Ndërkohë që neni 246 që ka të bëjë me fuqinë provuese të shkresave thotë, "shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementët e nevojshëm për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura, të çpuara. Nuk kanë gervishtje ose shtesa midis rreshtave". Tani, e para kemi të bëjmë me një kopje dhe duhet të kuptojmë se kush është organi kompetent që e konfirmon këtë. E dyta është se këtu ka disa korrigjime. Të paktën tek numri i plotë i fletëve të votimit ka korrigjim dhe përderisa korrigjimi është në kopje nuk do të dimë a është dhe tek origjinali. Pra, japim një sërë elementësh formal, pa i hyrë debatit se ku është gjetur dhe si është gjetur, kjo i përket vendimeve përfundimtare për mendimin tim. Po, në lidhje me faktin nëse do e pranojmë si provë apo jo, mendoni se vlen ky lloj debati për t'u zgjidhur paraprakisht. Nëqoftëse partitë sjellin një kopje tjetër dhe konfirmohet dhe me një kopje tjetër që është i njëjti procesverbal, pastaj e gjykojmë ndryshe, por në këto kushte unë jam i dyzuar.

***Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:*** Më fal një sqarim. Ai procesverbal aty, po ta shikoni ka... jam dakord me pretendimet tuaja në lidhje me formën e aktit, Nëqoftëse do të ishte i vërtetuar nga Komisioni i Qendrës së Votimit. Atëhere ju thoni që kjo kopje është origjinale. Ke një vulë, vulë e njomë e Qendrës së Votimit së cilës i është vënë kopje sipër dhe ajo vulë i jep dokumentit vërtetësinë dhe kjo është forma, përcaktuar nga Kodi Zgjedhor që dokumentat zgjedhore janë ose jo të vërteta. Dhe ky akt, unë mbaj përgjegjësi në paraqitjen e tij. Pra këtu nëqoftëse dyshohet për fallsitet i bie të dyshojmë për gjithë materialin zgjedhor. Ju shikoni formën, pastaj kush ka dyshime, atë që tha dhe zoti anëtar, çojeni për verifikim për fallsitet, por forma është forma të cilën KQZ-ja ka miratuar, ka dhe vulën e njomë të Qendrës së Votimit, e cila e bën atë akt prodhues. Dhe kjo është për hetim.

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit, zoti Lako po.

***Z. E. Lako:*** Tani mua më duket se po zgjatemi shumë me këtë debat që... dakord që debati i shërben procesit, por kush është marrë me zgjedhje e kupton që ajo nuk është një fotokopje, por ajo është një nga kopjet e setit. Pra, mënyra se si është shkruajtur dokumenti ashtu pasqyrohet dhe në dokumentet e tjera, nuk është fotokopje. Kush është marrë me zgjedhje e kupton që ajo është një nga kopjet e karbonit të shkresës e para, e dyta, unë jam dakord edhe me atë që tha zoti Salianji dhe më atë që tha zoti Logu që ka një procedurë kodi dhe kur mungon procesverbali vazhdon numërimi, nuk ndërpritet. Ka një procedurë tjetër dhe kur ekziston mund të jetë harruar jashtë kutisë dhe vjen këtu kopja. Dhe kjo qëndron dhe nuk ka asgjë. Ne mund ta shohim shumë kollaj tek të dhënat që janë pasqyruar në procesverbal janë ato të dhëna që ka përpiluar Komisioni i Qendrës së Votimit

në atë Qendër Votimi dhe këtu kuptohet që ka ndonjë shtesë, ndonjë pakësim apo ndonjë heqje, nëse do të ketë dyshime nga dikush dhe ky është një dokument jo që i shërben qendrës së votimit për të nxjerrë rezultatin , por ky është një dokument që e prodhon vet qendra e votimit. E prodhon qendra e votimit dhe i shërben KZAZ-së dhe grupit të numërimit. Kështu që ky është një dokument që e ka prodhuar vet qendra e votimit. Nuk është se na doli kjo se pa atë nuk e bën dot qendra e votimit. Kështu që nuk ka përse të zgjasi më tepër.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Mundem zoti Çefa? Atëhere zoti Lako ato që thoni ju nuk i ndajmë, për sa i përket pjesës së thelbit se në formë mbase keni të drejtë, por fakti është që këtu para dy ditësh ishin duke hapur kutitë e materialeve zgjedhore, përkatësisht për Qendrën 3446. Disa elementë të tjerë që flasin për parregullsi që lidhen dhe me këto elementë të sapodepozituar nga zoti Salianji. Domethënë Qendra 3446, ZAZ-ja 66 në Berat. Nga gjetjet e grupit të numërimit kur u hapën kutitë para të gjithëve. Libri i protokollit të mbledhjeve të KQZ-së, lista me nënshkrimet e zgjedhësve rezulton 324, ndërkohë më thoni në atë procesverbal zoti Rusmali sa rezultojnë të kenë votuar? Jo është shumë problem sepse nuk e dimë kur është gjeneruar. Nuk gjendet në kutinë e materialeve zgjedhore thuhet, nuk gjendet raporti PEI.

***Z. I. Rusmali:*** Zoti Kaziaj këtë gjë do e vlerësoni ju jo ne. Nëqoftëse ne e pranojmë si provë dhe ju japim kopjen, ju i merrni, i bëni vlerësimet, ju bëni prapësimet. Ne jemi në këtë pikë që pala e interesuar që ka dhe ajo të drejtën e vetë procedurale në këtë proces. Ka sjellë një provë, të cilën në kontekstin e të gjithës e do për të mbështetur pretendimet e veta. Tani, duhet të kesh argument për të kundërshtuar provën si të tillë në përmbajtjen e saj.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Patjetër, janë të dhëna të gjitha këto, të lutem...

***Z. I. Rusmali:*** Dhe argumenti për të kundërshtuar provën si të tillë është një dokument fallso dhe kjo duhet thënë. Është fallso sepse ne kemi origjinalin që të jep shifra të tjera, por duhet thënë.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Po pra, por dhe unë atë po them.

***Z. I. Rusmali:*** Por ju nuk e keni origjinalin.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Më falni, jo unë kam statistikat mbi atë dokument.

***Z. I. Rusmali:*** Mirë atëhere, shumë mirë. Atëhere shumë mirë, për të ndihmuar procesin zoti Kaziaj, juve këtë krahasim duhet t'a bëni mbi këtë bazë, ky dokument dhe dokumentat tuaj. Që ju t'a bëni këtë krahasim, ne duhet t'a marrim si provë.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Ne këtë po bëjmë. Ne nuk mund të disponojmë mbi vendimmarrjen që do të bëni ju dhe vendimmarrja juaj me vendim të ndërmjetëm është e pa ankimueshme nga ana jonë, kështu që në debatin administrativ që po bëjmë në këtë moment, po ju japim elementë të mjaftueshëm, për të krijuar bindjen tek ju.

***Z. I. Rusmali:*** Po, t'a shohim patjetër, të marri kopjen, por duhet të vendosim ne.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Zoti Rusmali, zoti Salianji tha është me nënshkrime. Po të shihni të gjithë procedurën e mbajtur nga QV-ja përkatëse, nuk ka nënshkrime. Pa nënshkrime, me disa nënshkrime, pa nënshkrime.

***Z. I. Rusmali:*** Zoti Kaziaj kjo është t'i futemi përmbajtjes, me kënaqësi, do të flisni ju përpara për përmbajtjen, përpara se të flasim ne. Gjithë diskutimi jonë është, formon provë dokumenti që ne të mund t'a pranojmë apo jo. Dokumenti nuk formon provë nëqoftëse është në kushtet e asaj që tha zoti Braho dhe mua më rezulton që ajo është kopje karboni, jo kopje siç thotë. Kopja e karbonit është dokument origjinal i lëshuar nga organi, apo jo? Nga Komisioni, me vulën e njomë të Komisionit, është kopja e karbonit, është dokument origjinal e para. E dyta mund të ngrihet pretendimi që ky dokument të shpallë këto sepse ju keni dokumentin origjinal që është i ndryshëm. Shumë mirë, nëqoftëse e keni, na e jepni, nëqoftëse nuk e keni tani, por e siguroni rrugës, na e jepni dhe ne e heqim si provë.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Siç ju thashë, ne nuk na është dhënë kopje e atij dokumenti, siç na është dhënë herë të tjera.

***Z. I. Rusmali:*** E ka PD-ja.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Ju lutem, ne jemi LSI. PD-ja, kolegu im nëqoftëse e ka t'a nxjerrë si dokument. Fakti është, më thoni ju anëtarët e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, si ka vijuar procesi pa parjen e këtij dokumenti në brendësi, si ka vijuar?

***Z. I. Rusmali:*** Është gjykim rreth përmbajtjes. Ju thoni për pretendimet përfundimtare. Kur ju të mbaroni pretendimin përfundimtar ne do të vrasim mendjen rreth problemeve qe ju ngrini dhe si janë ato në raport me të tërën. Nuk mund t'a bëjmë tani. Tani kemi vetëm një histori, duhet t'a pranojmë apo nuk duhet t'a pranojmë si provë?

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Në momentin që administrohet, ju fabulën e ngrini mbi administrimin e tij. Sipas jush nuk duhet pranuar?! Sipas qëndrimit tonë dhe në bazë të kërkimeve që bënë 2 anëtarët e KAS-it, kolegët tuaj, për verifikimin e brendësisë së kutisë së materialeve dhe gjetjeve të saj në bazë të kërkesës sonë, duke qënë se ky proces është nisur nga ana jonë dhe palët e tjera, qofshin palë të treta, nuk mund të dalin në konkluzion me veprime të një natyre të themi ekstra proceduriale në këtë moment. Ndërkohë që nuk është kërkuar ai dokument. Është kërkuar vetëm nëqoftëse do të gjendej në brendësinë e materialeve zgjedhore.

***Z. I. Rusmali:*** Ajo është kërkesa juaj dhe kërkesën tuaj ne e proceduam.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Po, kërkesa jonë u vërtetua.

***Z. I. Rusmali:*** Ne nuk e dimë se çfarë kërkese ka zoti Salianji. Ai po e sjell dhe mbi të do të ngrejë pretendimet e veta që nuk i ka shprehur akoma. I gjithë diskutimi jonë është, do të pranojmë provën apo jo. Nuk është diskutim rreth pretendimeve. Përfaqësuesi i PD-së ka opinion lidhur me këtë çështje?

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Ne i nderuar sapo e morëm këtë provë. Në lëxim të parë shohim se ka disa ndërhyrje. Përderisa këto janë kopje që i marrim ne,

përfaqësuesit e partive politike, përfshirë dhe përfaqësuesin e PD-së, kërkojmë që të marrim kohën e nevojshme, që të marrim dhe ne një kopje... Unë mëndoj që ju nuk duhet të merrni vendim për t'a pranuar përpara se edhe ne si palë të kemi një informacion të caktuar mbi këtë provë dhe pastaj edhe ne të japim mendimin tone, sepse mund të vimë edhe ne dhe të themi që pranoheni sepse prova është e vërtetë etj.. Pra fallsitetin ose jo apo origjinalitetin e kësaj prove ne do jua konfirmojmë pasi të kemi mundësi t'a verifikojmë, sepse në këtë fazë që jemi, ne shohim vetëm një dokument që ka disa të dhëna dhe nuk mund të konkludojmë...

***Z. L. Braho:*** Zoti Logu mjafton konfirmim, ne nuk na duhen kopje të tjera. Nëqoftëse ju arrini t'a konfirmoni brenda një afati të arsyeshëm.

***Z. K. Bele:*** Pa e kthyer ne debat, sepse ne mund të diskutojmë gjatë lidhur me vlefshmërinë e provës, por nuk më duket e arsyeshme që një kopje e dokumentit, zyrtare, e sjellë nga një nga palët, e konfirmuar nga administrata zgjedhore si e vlefshme. Ne nuk mund të marrim kohë për të. Nëse na vjen në një fazë tjetër të procesit një dokument, i cili e kundërshton, ne jemi me të drejtën e ligjit dhe të zotit që t'a diskutojmë provueshmërinë e këtij dokumenti. Por, për sa kohë një kopje unike, e cila proceduralisht i është vënë palëve ne dispozicion, sillet nga një nga palët. Unë gjykoj, pa paragjykuar vendimin e kolegëve që nuk na ngelet përveçse t'a administrojmë dhe gjatë shfletimit do të provohet fuqia provuese e këtij dokumenti. Pra, çfarë ky dokument provon është bisedë tjetër, por ne mendoj unë nuk mund t'a refuzojmë dokumentin e sjellë nga palët, sikundër çdo dokument tjetër zgjedhor, të kërkuar apo të ofruar, qoftë edhe të ngjashëm me dokumentin zgjedhor, kemi rënë dakord që t'a pranojmë.

***Z. K. Bele:*** Gjatë shqyrtimit do të vlerësohet fuqia e provës e këtij dokumenti. Pra, sa provon ky dokument është bisedë tjetër, por, mendoj unë, nuk mund t'a refuzojmë dokumentin e sjellë nga palët, sikundër çdo dokument tjetër zgjedhor, të kërkuar apo të ofruar, qoftë edhe të ngjashëm me dokumentin zgjedhor, kemi rënë dakord që t'a pranojmë.

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Një gjë të vogël!

***Z. E. Çefa:*** Po zoti Logu!

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Ndjesë, por ndoshta duhet shpjeguar edhe nga përfaqësuesi i LSI-së. Pretendimi për parregullsi ka të bëjë me faktin që, qoftë edhe që ky procesverbal apo kopje origjinale e tij, nuk është gjetur në kuti apo ka të bëjë me faktin që mohohet ekzistenca e tij. Nëse pretendimi për parregullsi ka të bëjë me faktin që nuk është gjetur as në kutitë e fletëve të votimit e as në kutinë e materialeve zgjedhore; pra si t'a administroni, si të mos e administroni, kjo nuk e ndryshon, po themi, thelbin e pretendimit.

***Z. I. Rusmali:*** Më fal, po lidhur me pretendimet e palës së interesuar, të cilat në nuk i dimë akoma, të cilat mund të jenë të ndryshme nga ato që thotë zoti Kaziaj.

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Para se të pranoni provën zoti Rusmali, duhet të dëgjoni çfarë kërkon të provojë pala e interesuar nëpërmjet kësaj prove. Fakti që ajo nuk u gjet në kutinë e materialeve të votimit dhe në kutinë e fletëve të votimit, këtë gjë ne, këtu e konstatuam të gjithë së bashku, e konstatoi edhe grupi i numërimit, i cili vepron mbi palët.

***Z. I. Rusmali:*** Çfarë do të provojë pala e interesuar me këtë provë?!

***Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:*** Siç e kam thënë që nga fillimi i nisjes së procesit administrativ, pavlefshmëria e votimit është shkelje e ligjit në qendrën e votimit. Ky procesverbal i cili është dokument ligjor i rregullt, vërteton që në ditën e votimit, procesi aty është kryer normalisht. Shtatë anëtarë kanë firmosur, janë shënuar kush ka votuar, fletët e përdorura, të papërdorura, dhe të gjithë të dhënat që ofron ky procesverbal vërtetojnë që në atë qendër votimi, votimi është kryer i rregullt. Kjo është pasqyra e ditës së votimit, nga ora 7 e mëngjesit deri në orën 7 të darkës dhe nëpërmjet këtij procesverbali paraqiten të dhëna të mjaftueshme për të vërtetuar që në atë qendër votimi është zhvilluar votim i rregullt. Pra, e ka thënë dhe e them, pavlefshmëri do të thotë shkelje e ligjit në një ose disa qendra votimi. Nëpërmjet këtij procesverbali vërtetohet që votimi ka qenë i rregullt dhe kemi një të dhënë aty që është numri 347. Me të drejtë zoti Kaziu thotë janë 324. Ky është pretendimi, tre fletë më shumë së zgjedhës. Nuk diskutohet ka pasur apo jo votim, dhe unë nuk e kuptoj gjithë këtë debat. Kjo është një provë dokumenti zgjedhor; nuk është kjo që do vërtetojë kauzën. Kjo është një ndër, ... dhe përderisa është dokument zgjedhor, ju merreni tani dhe pastaj kur të jepni vendimin e vlerësoni nëse ka vlerë kjo për procesin, apo jo! Përderisa është dokument zgjedhor besoj është detyruese!

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit! Po, zoti Kaziaj!

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Të nderuar anëtarë të komisionit. Ne mendojmë që nga momenti i kërkesës tonë e cila ishte eksplicite, nga momenti që anëtarët e KAS-it, dy prej tyre kërkuan në mënyrë eksplicite për qendrat e votimit të posaçme dokumente të posaçme të ndodhura në brendësi të kutisë, zoti Salianji

ka pas kohën e mjaftueshme për të ngritur pretendime, për të sjellë prova dhe për të depozituar çdo kërkesë apo ankesë të mënyrës procedurale. Jemi në pretendimet përfundimtare, faza e marrjes së provës ka përfunduar.

***Z. I. Rusmali:*** Jemi në mbyllje të kësaj faze.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Jo ajo fazë ka mbaruar.

***Z. E. Çefa:*** Që të jemi korrekt jemi në fazën përpara mbylljes. Pra, unë po kërkoja nëse kemi diçka tjetër shtesë përpara se të mbyllim hetimin administrativ, kështu që, ...

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** I nderuar relator! Nga ana procedurale, sipas meje, jemi në një fazë tjetër dhe fakti është që kërkesa jonë ka të bëjë në vetvete, dhe e juaja gjithashtu, ka të bëjë me hapjen e materialeve dhe me gjetjen e brendisë së materialeve, pra se çfarë rezultonte fizikisht në këto qendra votimi. Ashtu siç e pranoj edhe vetë zoti Salianji nga dokumenti që vetë solli, ka një mospërputhje shifrash. Si paskan vijuar ata?! Edhe zoti Sekretar i Përgjithshëm nuk na dha një mënyrë, një *modus operandi*, efektiv dhe të parashikuar në ligj, në momentin që mungon një informacion kaq i rëndësishëm i QV-së. Kështu që më duket debat i tepërt dhe po dalim nga thelbi.

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit! Unë besoj që u shteruan të gjitha opsionet e diskutimit, kështu që na takon në të vendosim nëse do e marrim si provë. Në qoftë se më lejohet një opinion personal siç e shoh unë. Pavarësisht përmbajtjes së dokumentit, mendoj unë, pavarësisht përmbajtjes së dokumentit, mendoj se fakti në se KAS-i, e merr ose jo si provë këtë dokument, nuk e lëviz parregullsinë e pretenduar, e cila

konsiston në mos administrimin e këtij dokumenti në momentin e caktuar, nga personat e caktuar. Pra, fakti që në po e marrim sot, përkundrazi e provon dhe e vërteton faktin që në atë kuti votimi specifike komisioni ka vepruar në kundërshtim me ligjin, me ose pa dashje, duke mos administruar këtë dokumentacion në formën dhe mënyrën siç edhe ligji e kërkon. Faleminderit! Vendim i ndërmjetëm: KAS-i e konsideron administrimin si provë kopjen e procesverbalit të paraqitur nga përfaqësuesi i palës së interesuar, Partia Socialiste.

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Ne kemi ankesa se nuk pranoni prova, por çdo lloj kopje apo provë të administrohet!

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Pra, një kopje administrata dhe një kopje të dokumentit tua shpërndajë palëve.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Me sa shohim duhet të bëjmë kërkesë për pranimin e provës pasi ka kaluar ora 15:00.

***Z. E. Çefa:*** Atëherë, duke qenë se nuk ka më prova të tjera apo kërkesa për të administruar prova të tjera. Keni të tjera?! Jo nuk ka! Unë deklaroj se mund të mbyllim hetimin administrativ dhe të kalojmë në konkluzionet përfundimtare për këtë çështje, pra, lidhur me pavlefshmërinë, referuar gjithmonë kërkesës nr. 34 dhe 42, dhe ftoj përfaqësuesin e subjektit zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim të parashtrojë konkluzionet e tij lidhur me ankimin. Faleminderit!

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Atëherë, faleminderit zoti Çefa! Ne u njohëm dhe me vendimin tuaj që i përkiste kërkesës tonë lidhur me Qarkun Gjirokastër,

dhënë në orën 13:00, pavarësisht se vendimet tuaja nuk diskutohen por ankimohen, qëndrimi i mbajtur nga ana jonë është se nën ndikime politike, është ligjëruar një pavlefshmëri nëpërmjet vendimmarrjes tuaj, gjë që ju kërkuam dhe të ishit që të vendosnit standarde, ...

***Z. E. Çefa:*** Zoti Kaziaj, me gjithë respektin që kam këto deklarata i lëmë, dhe pas kësaj dere, keni lirinë për t'i thënë pa fund; në qoftë se do të më lejoni, kjo vlen jo vetëm për ju por edhe për persona të tjerë që do flasin. Pra edhe një herë në qoftë se do të më lejoni edhe për ekonomi të procesit administrativ të kalojmë menjëherë tek thelbi. Sepse ne, sigurisht jemi në dijeni të pikëpamjeve të secilit prej jush, pikëpamjeve publike, flas gjithmonë. Faleminderit!

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Pra, ne jemi lehtësisht të verifikueshëm dhe të identifikueshëm në bazë të pikëpamjeve tona, për arsye se jemi këtu si përfaqësues ligjore të subjekteve tona politike të përcaktuara, kështu që nuk është zor të arrish në këtë konkluzion. Gjithsesi faleminderit që më ndërpretë të thosha atë që mendoja. Për të vijuar i nderuar zoti relator, me kërkesën ankimore që i përket Qarkut Berat me anë të së cilës kemi kërkuar pavlefshmëri të procesit të votimit në 24 qendra votimi dhe përsëritjen e zgjedhjeve në këtë qark. Duke u mbështetur në nenin 141, pika 2 të Kodit Zgjedhor, pasi në këtë proces është bërë një hetim i përcaktuar, në bazë të kërkesave eksplicite të subjekteve ankimuese dhe në bazë të një kërkese të bërë nga dy anëtarët e KAS-it, lidhur me hapjen e kutive të materialeve zgjedhore për 24 qendrat e votimit të ndodhura në proces ankimor sipas objektit të kërkesës tonë. Ne jemi njohur me tabelën dhe me kërkimet eksplicite të bërë nga dy anëtarët e KAS-it për çdo qendër votimi. Pasi kemi kërkuar kohën e mjaftueshme nga anëtarët e KAS-it për të disponuar lidhur me

gjetjet efektive që administrata e KQZ-së ka konstatuar në çdo qendër votimi, situata është rënduar akoma më tej. Në bazë të këtyre gjetjeve jo vetëm që është vërtetuar, të themi, ajo që ka qenë vetëm një pretendim dhe disa prova të sjella nga Lëvizja Socialiste për Integrim, në bazë të shqyrtimit të materialit zgjedhor për 6 ZAZ-të e Qarkut Berat, të cilat kanë dalë si rezultat i konsultimit të librave të protokollit të këtyre ZAZ-ve dhe të vendimmarrjeve që ka pasur ZAZ-ja përkatëse dhe të materialeve të tjera që kanë të bëjnë me procesverbale të administruara nga grupet e numërimit përkatës, në këto tavolina numërimi, të nxjerra nga tabelat e numërimit pranë këtyre ZAZ-ve. Këto janë të dhënat e materialeve të sipërcituara që janë kërkuar nga KAS-i dhe që është vërtetuar nëpërmjet nxjerrjes fizike të materialit zgjedhor nga ana e administratës. Sipas atyre që na janë vënë në dispozicion, bashkëlidhur me një procesverbal të hapjes së kutisë së materialeve zgjedhore dhe gjetjeve përkatëse, të firmosura nga grupet e numërimit dhe procesverbalet dhee dokumentacioni zgjedhor bashkëlidhur, konstatojmë se ka mungesë të theksuar të kërkimeve të bëra nga ana e dy anëtarëve të KAS-it, për sa i përket pjesës së marrjes së materialit të posaçëm, zë më zë, sipas QV-ve të kërkuara. Nuk është vënë në dispozicion regjistri i nënshkrimeve, për shkak se nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm është imponuar mosdhënia e tij, duke mos na vënë edhe në dijeni se cili ligj në Republikën e Shqipërisë e ndalon këtë gjë. Kjo do të ndihmonte shumë të nderuar anëtarë të KAS, për shkak se në shumicën e qendrave të votimit ka pasur mangësi të theksuara të procesverbalit apo raportit të mbylljes së PEI-t. Duke mos pasur as regjistrin e nënshkrimeve si në kutinë e votimit, që sapo debatuam QV nr.3446 e ZAZ nr. 66, si ka vijuar procedura e mëtejshme e përllogaritjes së fletëve të votimit, të vendimmarrjes së bërë nga QV-ja, dhe më pas të numërimit të tyre nga ana e grupeve të numërimit. Unë do t'ua vë në dispozicion edhe materialin që kemi bërë, pas zgjedhjeve të bëra nga procesverbalet përkatëse,

që na janë dhënë për këto qendra votimi. E kemi strukturuar në formën e një tabele. Fillimisht kemi bërë tabelën e marrë nga KQZ-ja, pas kërkimeve të bëra kryesisht nga dy anëtarë të KAS-it dhe poshtë saj, pasi jemi konsultuar me materialin e vënë në dispozicion, kemi bërë një tabelë të dytë, e cila shpjegon dhe ju vjen në ndihme juve anëtarëve të KAS, për të disponuar me vendimmarrje objektive, për të disponuar mbi disa shkelje që patjetër duhet të sjellin domosdoshmërisht pavlefshmërinë e këtyre qendrave të votimit, duke qenë se gabimet janë aq shabllon, aq të rënda, aq kriminale, sa do të duhej d.m.th., vetëm një shikim përciptazi i tyre për të arritur në këtë konkluzion. Për më tej do të doja që në qoftë se na lihej pak kohë në dispozicion, tua përcjellim këto shkelje një e nga një, nëpërmjet koleges time duke filluar nga QV-ja 3433 e Qarkut Berat.

***Z. L. Braho:*** Zoti Kaziaj një moment! Në qoftë se do të ishte e mundur që këtë tabelën të na e jepni paraprakisht dhe ne...

***Z.A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Patjetër!

***Z. L. Braho:*** Njëkohësisht kur ju lexoni dhe ne t'a shohim, se është më e lehtë se sa kur ne thjesht ta dëgjojmë.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Kam vetëm një kopje zoti Braho, sepse, ...

***Z. L. Braho:*** Jepjani administratës dhe nisim direkt.

***Z. E. Çefa:*** Atëherë rifillojmë! Përfaqësuesi i subjektit Lëvizja Socialiste për Integrim, mund të vazhdoni ju lutem!



*Zbardhi materialin audio*
*Merita DULAKU*

***Znj. U. Gjosha përfaqësusese e LSI-së:*** Faleminderit! Atëherë për sa i përket Qendrës së Votimit 3433, mungon procesverbali i hapjes së pajisjes PEI. Sipas procesverbalit të tërhequr nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve figurojnë 990 fletëvotimi, ndërkohë në procesverbalin e qendrës së votimit numri i fletëve është 1000 të tilla. Mungon vendimi i gjykatës për personin si rast i veçantë. Qendra e Votimit 3456 mungon raporti i hapjes dhe i mbylljes së pajisjes PEI. Në procesverbal shprehet për dy raste të veçanta një komisioner dhe një administratë, pa identifikim në nënshkrimet e tyre. Numri i zgjedhësve është 341 dhe fletë votimi janë 340. Nga procesverbali i tërheqjes në KZAZ, janë 959 fletë, ndërkohë në procesverbalin e mbylljes totali i fletëve është 1000. Tek Qendra e Votimit 3440 janë tërhequr 808 fletëvotimi dhe të gjetura në kuti 806 fletë votimi, sipas procesverbalit të qendrës së votimit. Në procesverbalin e mbylljes dhe në raportin PEI shkruhet numri i zgjedhësve 267 dhe në tabelën përmbledhëse numri i zgjedhësve është 272 dhe totalin e numrit të fletëve është 806. Janë shtuar 7 persona të shënuar në procesverbal pa arsye janë shënuar emrat e tyre dhe ID pa nënshkrimin e tyre dhe pa emër dhe pa nënshkrim të komisionarëve. Procesverbali është vulosur me dy vula të qendrës së votimit të kryetarit dhe të sekretarit, ndërkohë sipas udhëzimit, vula e kryetarit vendoset vetëm në fletën e votimit. Tek Qendra e Votimit 3446, mungon raporti PEI, sepse është proceduar në mënyrë manuale. Nuk ka votim apo procesverbal për kryerjen votimit në mënyrë manuale. Nuk ka procesverbal të tërheqjes së fletëve të votimit nga KZAZ-ja. Nuk ka procesverbal të mbylljes së qendrës së votimit. Sipas tabelës përmbledhëse të GNV-së, numri i zgjedhësve është 327 dhe numri i fletëve në kuti është 327, ndërkohë, nga konstatimi i KQZ-së numri i zgjedhësve është 324. Në Qendrën e Votimit 3270, nuk ka procesverbal të tërheqjes së fletëve të votimit nga KZAZ-ja. Numri i plotë i fletëve të votimit tek procesverbali i qendrës së votimit është i

korrigjuar, mungon raporti mbylljes i pajisjes PEI. Sipas informacionit tonë, numri i fletëve të votimit të tërhequra nuk përputhet me numrin e fletëve të votimit korrigjuara në raportin e qendrës së votimit. Në Qendrën e Votimit 3441, mungon raporti i mbylljes së pajisjes PEI. Në procesverbalin e qendrës së votimit, numri total i fletëve të votimit është 944, ndërkohë, në llogaritjen e fletëve të papërdorura dhe ato të përdorura dalin 936 fletë votimi. Nga vështrimi i librit të protokollit, konstatohen mospërputhje të numërimit të zgjedhësve, pra konstatohet se votimi ka qenë i përzierë, pra, në mënyrë manuale dhe me anë të identifikimit të pajisjes biometrike PEI, ndërkohë që nuk ka një vendim apo arsyetim të KQV-së apo të KZAZ-së mbi këtë procedurë sipas akteve normative. Në qendrën e votimit 3431, raporti i PEI-t nuk përputhet me procesverbalin e mbylljes së qendrës së votimit. Nuk përputhet numri i zgjedhësve me numrin e fletëve të gjendura në kuti. Nuk përputhet numri i votueseve femra në raportin e PEI-t me raportin e qendrës së votimit. Nuk ka nënshkrim të zgjedhësve të cilët kanë votuar në mënyrë manuale. Qendra e votimit shprehet se ka votuar një person me vendim gjykate, ndërkohë nuk është shënuar tek regjistri i posaçëm, por as nuk ka të administruar vendimin e gjykatës. Raporti PEI tregon 13 votues, të cilëve nuk iu është identifikuar gjurma e gishtit. Ndërkohë, në protokoll janë deklaruar 39 votues të cilëve nuk iu është identifikuar gjurma e gishtit, si dhe nuk kanë nënshkrime në listën e zgjedhësve. Tabela përmbledhëse është e kontestuar nga të gjithë numëruesit e Partisë Socialiste, të Partisë Demokratike dhe LSI-së dhe është sugjeruar për vlerësim nga KQZ-ja, bashkëlidhur edhe procesverbali përkatës. Qendra e votimit ka 7 anëtarë dhe procesi i votimit ka filluar me vetëm 3 anëtarë dhe në mungesë të kryetarit. Qendra e Votimit 3445, tek procesverbali i tërheqjes nga KZAZ figurojnë 738 fletë votimi të tërhequra, ndërkohë në procesverbal totali i fletëve të tërhequra është 700. Numri i zgjedhësve në procesverbalin e qendrës së votimit është 310,

ndërkohë në tabelën përmbledhëse, numri i zgjedhësve është 314. Numri i fletëve të votimit në kuti është 314, nga 310 votues të shënuar në procesverbalin e qendrës së votimit. Mungon raporti PEI. Anëtarët e numërimit të subjekteve politike mbajtën procesverbal ku u shprehen se janë gjetur 4 fletë votimi më shumë se numri i zgjedhësve. Tabela përfundimtare del me 314 votues dhe 314 fletë votimi ndërkohë që në procesverbal janë shënuar se numri total është 310. Në Qendrën e Votimit 3318, numri i fletëve të votimit të tërhequra nga KZAZ është 745, dhe numri total i fletëve të votimit në procesverbalin e mbylljes së qendrës së votimit shënon 730 fletë. Fletë votimi të gjetura në kuti janë 354 dhe ndërkohë numri i zgjedhësve në listë është 353. Fletëvotimi të papërdorura sipas procesverbalit të qendrës së votimit janë 377, ndërsa në tabelën përmbledhëse të hartuar nga numëruesit janë shënuar 391 fletë të papërdorura. Kutia është hapur nga grupi i parë i numërimit dhe është mbyllur vetëm me procesverbalin e vulave pa hartuar një tabelë përmbledhëse, dhe pa mbajtur procesverbalin e arsyes së mbylljes. Të nesërmen KZAZ-ja merr vendim për rihapjen e kutisë nga një grup tjetër numërimi. Pas hapjes së kutisë, u konstatua mospërputhje e numrit të zgjedhësve me numrin e fletëve të votimit. GNV-ja, pas hartimit të tabelës përmbledhëse, e dërgon atë për hedhje në sistem tek operatori i KZAZ-së dhe për shkak mospërputhje të dhënave, sistemi nuk e pranon hedhjen e tyre. Për këtë arsye KZAZ-ja insistoi për ndryshimin e të dhënave, pra numrin e zgjedhësve ose numrin e fletëve të votimit me pretendimin e pranimit në sistem. Numëruesit nuk pranuan ndryshimet e sugjeruara nga KZAZ dhe kontestuan duke shënuar në tabelën përmbledhëse. Pas ndërhyrjes nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u bë e mundur hedhja e të dhënave në sistem, pavarësisht se kishte mospërputhje. Në raportin PEI, dy persona kanë votuar me vendim gjykate, ndërkohë nuk ka asnjë shënim në librin e protokollit dhe në regjistrin e posaçëm dhe as vendim gjykate të

administruar. Në qendrën e Votimit 3275 mungon raporti i mbylljes së pajisjes PEI. Fletëvotimi të tërhequra nga KZAZ-ja janë 903, ndërsa në procesverbalin e mbylljes së qendrës së votimit numri total i fletëve është 885. Fletëvotimi të papërdorura sipas procesverbalit të qendrës së votimit janë 570 dhe sipas tabelës përmbledhëse të GNV-së janë 588. Nga raportimi del se janë 306 votues, dhe sipas procesverbalit janë 308 votues elektronike dhe dy administratë. Qendra e Votimit 3307 në raportin e mbylljes së pajisjes PEI, në procesverbalin e mbylljes së qendrës së votimit, në tabelën përmbledhëse të rezultatit, figurojnë 309 zgjedhës, në shënimet e mbajtura nga grupet e numërimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, pas hapjes së kutive të materialeve zgjedhore, figurojnë 310 kuponë PEI dhe një rast administratë. Fletëvotimi të gjetura në kuti janë 310. Kemi mospërputhje midis fletëve të votimit të gjetura faktike në kuti me raportet e lartpërmendura. Qendra e Votimit 3287, fletëvotimi të gjetura në kuti janë 275, ndërsa numri i zgjedhësve që kanë votuar është 276. Në Qendrën e Votimit 3325, nga procesverbali i qendrës së votimit konstatohet se në total janë 808 fletë votimi por nga llogaritja e ndarjes së fletëve në procesverbal janë 812 fletë votimi, pra janë 4 fletë votimi plus. Në Qendrën e Votimit 3328 nuk përputhen të dhënat e qendrës së votimit me të dhënat e tabelës përmbledhëse të GNV-së, dhe as me të dhënat e KQZ-së. Fletëvotimi të papërdorura në procesverbalin e qendrës së votimit janë 454, ndërsa në tabelën përmbledhëse janë 451. Në raportin e pajisjes PEI, figurojnë dy votime me raste të veçanta, por në librin e protokollit dhe në regjistrin e posaçëm, nuk ka asnjë identifikim dhe asnjë arsye se pse këto dy raste konsiderohen si të veçanta, Qendra e Votimit 3429/1 mungon raporti i pajisjes PEI për hapjen dhe mbylljen e saj, mungon procesverbali i mbylljes së qendrës së votimit dhe procesverbali i tërheqjes së fletëve të votimit nga KZAZ. Qendra e votimit 3518/1, në raportin e pajisjes PEI, numri i zgjedhësve është 172, ndërsa në

procesverbalin e mbylljes së GNV-së, numri i zgjedhësve është 171. Mungon gjithashtu edhe procesverbali i mbylljes së qendrës së votimit. Në Qendrën e Votimit 3472 mungon raporti i pajisjes PEI, KAS dhe subjekteve nuk u është vënë në dispozicion lista e zgjedhësve, kuponët e pajisjes PEI, tabelat përmbledhëse të GNV-së, shënimet e KZAZ-së apo GNV-së, prandaj në këto kushte është e pamundur të gjykohet mbi vlefshmërinë e kutisë apo të procesit në tërësi. Në Qendrën e Votimit 3482, janë gjetur fletë votimi tepër në kuti dhe KZAZ-ja merr vendimin që këto fletë të konsiderohen si të papërdorura, me pretekstin e mos akordimit dhe mos marrjes së tabelës së rezultateve nga sistemi, KZAZ-ja shkel ligjin duke ndryshuar të dhënat. Sipas verifikimit të KQZ-së janë 314 kuponë PEI, ndërkohë në raportin e pajisjes PEI figurojnë 316 votues. Në raportin e pajisjes PEI, shprehet se janë bërë 3 votime nga administrata dhe 3 raste të veçanta, ndërkohë që në librin e protokollit dhe në regjistrin e posaçëm është identifikuar vetëm për një votues. Ka mospërputhje të fletëve të votimit të gjetura në kuti të cilat janë 726, me numrin total të fletëve të votimit në procesverbal që janë 725. Në Qendrën e Votimit 3473 u gjet në kuti nga ana e numëruesve një fletë votimi më shumë se numri i zgjedhësve. GNV-ja konstatoi në procesverbal për gjendjen e parregullsisë. KZAZ-ja, me pretendimin e rregullimit të tabelës së rezultatit, pasi nuk pranohet në sistem, mori vendimin që fleta të quhej e parregullt dhe të mos pasqyrohet në tabelë. Me ndihmën e KQZ-së, bëhet e mundur ngarkimi i tabelës së rezultateve me parregullsitë e sipërpërmendura. Në Qendrën e Votimit 3416 mungon procesverbali i tërheqjes së fletëve të votimit nga KZAZ-ja. Në raportin e pajisjes PEI figurojnë 40 votues, të cilëve nuk u njihet gjurma e gishtërinjve, ndërkohë që, në librin e protokollit dhe në listën e zgjedhësve nuk ka nënshkrime apo shënime për këta votues. Në Qendrën e Votimit 3501, në procesverbalin e tërheqjes së fletëve të votimit, nuk është figuruar asnjë e dhënë. Mungon

procesverbali i mbylljes së qendrës së votimit, konstatuar edhe nga grupi i numërimit edhe nga KQZ. Sipas raportit të pajisjes PEI, numri i votuesve është 209, 21 votues pa gjurmë të gishtërinjve dhe nuk ka shënime apo nënshkrime në listën e zgjedhësve. Por ndërkohë, sipas KQZ-së kanë nënshkruar 203 votues. Deklarohet një rast administratë dhe një rast i posaçëm, të cilët kanë votuar në këtë qendër votimi por ndërkohë nuk kanë asnjë të dhënë në librin e protokollit apo në regjistrin e posaçëm. Sipas tabelës përmbledhëse të GNV-së janë gjetur 208 fletë votimi, ndërkohë që në raportin e pajisjes PEI figurojnë 209 votues, plus një administratë dhe plus një rast i veçantë. Pra, 211 votues në total sipas pajisjes PEI. Në Qendrën e Votimit 3513 mungon raporti i pajisjes PEI për hapjen dhe mbylljen e saj, mungon procesverbali i mbylljes së qendrës së votimit, procesverbali i tërheqjes së fletëve të votimit nga KZAZ-ja nuk ka asnjë të dhënë. Sipas konstatimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, janë 367 kuponë të pajisjes PEI, ndërkohë që në tabelën përmbledhëse figurojnë 384 votues, gjithashtu, 384 fletë votimi në kuti, pra 8 vota më shumë. Në Qendrën e Votimit 3518 mungon raporti i pajisjes PEI për hapjen dhe mbylljen e saj. Nga konstatimi i KQZ-së figuron se nuk ka raport të pajisjes PEI, nuk ka nënshkrime të zgjedhësve. Konstatohet se numri i kuponëve PEI të gjetur në kuti, sipas numëruesve të KQZ-së është me korrigjime prandaj nuk mund të shprehemi për vlefshmërinë e kësaj kutie. Në Qendrën e Votimit 3330 mungon raporti i pajisjes PEI për hapjen dhe mbylljen e procesit dhe gjithashtu mungojnë nënshkrimet në listën e zgjedhësve, faleminderit!

***Z. E. Çefa:*** Ju faleminderit! Po, zoti Kaziaj!

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Po i nderuar zoti Çefa, ashtu siç relatoi edhe kolegia Gjosha, janë mangësi të theksuara nga hapja e kutive që kanë rezultuar nga

vënia në dispozicion e materialit nga KQZ-ja në këtë rast me procesverbalet përkatëse për çdo kuti. Natyra e shkeljeve, fillimisht të pretenduara dhe më pas të konstatuara menjëherë pas hapjes së kutive me materiale zgjedhore përkatëse, tregon qartë maskaradën e zgjedhjeve të ndodhura në Qarkun e Beratit. Procesi zgjedhor është cënuar, për pasojë rezultatet përfundimtare të dala nga ky proces japin elementë të provës së ndërhyrjes së administratës zgjedhore me qëllim tjetërsimin e realitetit faktik të vullnetit qytetar nëpërmjet zgjedhjes me votë. Provat e saktësuara më sipër që, ju dëgjuat nëpërmjet relatimit që sapo bëmë, në mënyrë shteruese janë tregues i qartë që shifrat, dokumentet, aktet dhe faktet reale, që kanë të bëjnë me periudhën parazgjedhore, që nga emërimi i anëtarëve të KZAZ-ve, me periudhën zgjedhore, si dhe me periudhën pas përfundimit të procesit të votimit dhe të numërimit me këtë rast deri tek dërgimi i materialeve zgjedhore në KQZ, janë manipuluar haptazi. Në lidhje me materialet e vëna në dispozicion dhe lidhur me këqyrjen e të dhënave daktiloskopike, të shenjave të gishtave, të regjistruara në këtë qark dhe të vëna në dispozicion nga ana e administratës, për atë që ka dalë nga pajisja PEI, rezulton një situatë e pastër manipulimi, duke referuar këto të dhëna me ndërhyrje të theksuara në procesin e votimit. Këta persona, apo individë qofshin, të parazgjedhur, që lehtësisht kuptohen në bazë të rezultatit zgjedhor në këtë qark se cila forcë politike i ka parazgjedhur. Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, ky manipulim tashmë i provuar duhet të sjellë pavlefshmëri të 24 qendrave të votimit të listuar në pjesën hyrëse të ankimit, që kanë të bëjnë me zonën zgjedhore të Qarkut të Beratit, në të 6 ZAZ-të e këtij qarku. Në interesin më të lartë të objektivitetit të vendimmarrjes tuaj, ju kërkojmë, që pa ndikim, duke mbajtur standarde të, ...

***Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:*** Natyrës superpartes mos të bëhemi pjesë e politikës ju që jeni persona të zgjedhur nga Parlamenti. Duhet të ndërmerrni një vendimmarrje objektive në mënyrë që rezultatet zgjedhore në Shqipëri mos të diktohen nga persona apo forca politike të mos tjetërsohet, vullneti i zgjedhësve duhet të jetë gjithmonë i shejntë në Shqipëri në mënyrë që të ushtrohet e drejta e tyre kushtetuese. Në këtë kërkojmë që për sa u tha më sipër mbështetur në një hetim të themi të bërë nga konkluzionet e të cilit kanë dalë akoma materiale më të rënda për sa i përket të paktën këtyre 24 qendrave them të paktën sepse që nga ajo që kemi në dispozicion informacioni i vënë në dispozicion nga anëtarët tanë të këtyre qendrave, por dhe në gjithë Qarkun e Beratit, ka rezultuar parregullësi në të gjitha qendrat e Qarkut të Beratit. Është votuar nën trysninë e shantazheve, nën trysninë e kërcënimeve, pra mendojmë për sa relatuam deri në këtë moment në të gjitha seancat dëgjimore qoftë kjo dhe në kuadrin e përfundimit të hetimeve administrative nga ana juaj të cilat janë disponuar me material të posaçëm të vënë në dispozicion nga ana jonë pranë jush. Përfundimisht mbështetur në nenin 30, pika 1, germa "c", të vendimit të Rregullores suaj të nderuar anëtarë të KAS-it, kërkojmë ndryshimin e vendimit të Komisionerit nr.339, datë 04.05.2021. Shpalljen e pavlefshme të të gjitha q endrave të votimit të parashikuara në objektin e ankimit tonë, faleminderit.

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit avokat, tani fjala është për subjektin tjetër ankimues përfaqësuesin e PD-AN. Fjala për ju zoti Logu.

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Faleminderit i nderuar kryesues i seancës, parashtrimet jona janë 6 faqe kam 3 kopje të cilat mund t'ia vë në dispozicion anëtarëve të komisionit apo administratës zgjedhore. Në qoftë se mund të afrohem

tek ju. Ne në fakt kemi pasur mundësi që në fazën e parë, në fazën e parashtrimeve të paraqesim në mënyrë të zgjeruar të gjitha faktet dhe provat që ne kemi në dispozicion, lidhur me ato që ne i kemi konsideruar shkelje të ligjit të cilat në kuptim të nenit 160, të Kodit Zgjedhor kanë cënuar rendë procesin zgjedhor në atë masë sa sjellin pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Qarkun e Beratit. Konkretisht PD-AN, ka paraqitur para jush një material ankues prej 56 faqesh të mbështetura në 40 prova duke shpjeguar në mënyrë të detajuar të gjitha shkeljet që kanë ndodhur në zonën zgjedhore të Qarkut të Beratit. Ne kemi Parashtruar para këtij komisioni të nderuar se shtetasja Hatixhe Konomi kandidate për deputete e Partisë Socialiste, në bashkëpunim me shtetasin Mirel Konomi, drejtues i Njësisë Administrative nr.1 në Berat e njëkohësisht edhe kunati i zonjës Konomi si dhe shtetasi Nasip Naço kandidat për deputet i Partisë Socialiste, në bashkëpunim me shtetasin Lorenc Toroveli, kishin ngritur një strukturë kriminale të vlerës së votave nëpërmjet parave ndihmave ushqimore, kuponave të kartave të identitetit, dhënies së përfitimeve të tjera por edhe nëpërmjet kërcënimeve e presioneve. Ndaj këtyre shtetasve Partia Demokratike në zbatim të nenit 283, të Kodit Procedurës Penale, ka depozituar në SPAK një kallëzim penal në datën 07 Prill 2021, " Për veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje dhe në marrjen ose përdorimin e paligjshëm të dokumentave të identifikimit". Ne parashtruam se me qëllim manipulimin e vullnetit të zgjedhësve, Këshilli Bashkiak Berat në kundërshtim me nenin 91, të Kodit Zgjedhor miratoi një ndihmë financiare prej 80 milionë lekësh të vjetra për 7 familje në nevojë. Në të njëjtën datë këshilli bashkiak miratoi një vendim lidhur me shtyrjen e afatit të pagimit të taksave dhe tarifave vendore, gjithashtu ne parashtruam se në datën 19 Prill 2021, u ndalua një furgon brenda të cilit ndodheshin dy punonjës të Bashkisë Berat që po shpërndante ndihma ushqimore nga rezervat materiale të shtetit në këmbim të votës. Të gjitha këto të

nderuar anëtarë të komisionit në vlerësimin tonë dhe në kuptimin që ne i bëjmë ligjit janë shkelje flagrante të nenit 78, të Kodit Zgjedhor dhe të nenit 91, e po ashtu të vendimit nr.9, të vitit 2020 të Komsioinit Rregullator të KQZ-së, i cili ndalon shprehimisht nxjerrjen e akteve në periudhën 4 muaj përpara zgjedhjeve që kanë për qëllim të ofrojnë përfitime për kategori të caktuara shoqërore siç është rasti i vendimit të Këshillit Bashkiak të Beratit për akordimin e vlerës prej 80 milionë lekë për 7 familje në nevojë në këtë bashki. Nga ana tjetër dhënia e parave ose të mirave materiale është përveç se një vepër penale, një ndalim i qartë i nenit 78 ku ndalohet çdo subjekt zgjedhor, çdo kualicion dhe çdo kandidat i pavarur të ofrojë ndihma ushqimore apo të mira tjera në këmbim ose me qëllim marrjen e votës së qytetarëve. Ne krahas 40 provave tona ju treguam provat e tjera që ju duhet të merrnit për të vërtetuar pretendimet tona pranë prokurorisë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Rezervave Materialeve të Shtetit dhe Inspektoratit Qendror apo inspektorateve të tjera. Por ky komision në vlerësimin tonë në shkelje të nenit 136 dhe nenit 137 të Kodit Zgjedhor, refuzoi të merrte provat e kërkuara nga PD-AN. Kjo solli që ju refuzuat të bëni transparencë mbi blerjen e votës në Qarkun e Beratit çka në vlerësimin tonë ndikoi qartësisht në rezultatin përfundimtar. Ne parashtruam para këtij komisioni se shteti vendosi në dispozicion të partisë tendera, koncesione pipipi dhe çdo lloj investimi publik. Kjo shkelje flagrante e nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe neni 3, të vendimit nr.9 të vitit 2020 u përsërit në 781 raste në gjithë vendin. Ne treguam me ato fakte dhe prova që disponomim se shtetasit Ervin Demo me detyrë Kryetar i Bashkisë, Fadil Nasufi, Ermonela Felaj deputet i Kuvendit të Shqipërisë zyrtarë dhe drejtues të lartë të Partisë Socialiste si Juliana Memaj apo Sybi Shehu, u shfaqën publikisht duke promovuar investime publike për qëllime të pastra elektorale. Krahas 40 provave

tona ne ju treguam edhe prova të tjera që ju duhet të mermit për të vërtetuar këto pretendime siç ishin ato pranë Agjencisë së Prokurorimeve Publike për numrin e tenderave, koncesioneve pipipive të shpallura rishtazi apo për të cilët janë shpallur fituesit në periudhën Dhjetor 2020-Maj 2021. Por, edhe këto prova ky komision refuzoi t'i merrte në shkeljet e nenit 137, të Kodit Zgjedhor kjo solli refuzimin për të bërë transparencë sesi paratë e taksapaguesve shqiptarë u vendosën në funkison të Partisë Socialiste në Qarkun e Beratit. Ne parashtruam para këtij komisioni se punonjësit e administratës shtetërore në Bashkitë Berat, Kuçovë, Ura Vajgurore, Poliçan dhe Skrapar u kërcënuan u intimiduan dhe u vendosën nënpresion të vazhdueshëm nga eprorët e tyre, për të marrë pjesë detyrimisht në takime elektorale, për të dorëzuar lista me 30 deri në 50 votues, për të dhënë karta identiteti apo të dhëna tjera personale për t'u përfshirë në fushatë derë me derë dhe për të dhënë përfitime të ndryshme për mbështetës të Partisë Socialiste. Ne parashtruam se administrata shtetërore u rrit me 13 mijë punonjës në 4 muaj dhe nga buxheti i shtetit u paguan mbi 63 milionë euro paga më shumë sesa e njëjta periudhë e vitit të mëparshëm. Ne parashtruam se qeveria pagoi 2.6 milionë euro më shumë ndihma ekonomike për periudhën Janar-Prill 2021 se e njëjta periudhë e vitit të mëparshëm. Krahas 40 provave tona ne ju treguam provat e tjera që ju duhet të merrnit për të vërtetuar pretendimet pranë Departamentit të Administratës Publike bashkive 244 shoqërive aksionare në pronësi të shtetit, Agjencitë e Varësisë së Ministrave dhe bashkive për numrin e të punësuarve me kontratë të përhershme apo përkohshme dhe si ka ndryshuar ky numër për gjatë periudhës Janar 2020-Maj 2021. Ne ju treguam provat që ju duhet të merrni pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe 61 bashkive lidhur me numrin e familjeve që kanë përfituar ndihmë ekonomike dhe ndryshimin e masës gjatë pëeriudhës Janar 2020-Maj 2021. Fatkeqësisht edhe këto prova në kundërshtim

me nenet 136 dhe 137, të Kodit Zgjedhor ju i refuzuat duke bërë kështu, u refuzua e drejta për transparencë sesi administrata shtetërore vendet e punës, ndihma ekonomike dhe pagesat e tjera sociale u vu në dispozicion të Partisë Socialiste në Qarkun e Beratit. Ne parashtruam përpara këtij komisioni duke besuar në drejtësinë e tij se lejet e legalizimit dhe lejet e ndërtimit u përdorën masivisht nga Partia Socialiste për t'i përkthyer në vota dhe mbështetje për të dhe kandidatët e saj. Ne parashtruam dhe sollëm si prova foto dhe video të zyrtarëve të Partisë Socialiste që shfaqeshin publikisht duke shpërndarë leje legalizimi në periudhën e ndaluar nga Kodi Zgjedhor e keni cituar më herët e ndoshta nuk ja vlen që ta ripërsërisim por është fakt se audio përgjimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kadastrës, tregoi përdorimin masiv që po i bëhej lejeve të legalizimit për qëllime elektorale. Krahas 40 provave tona ne ju treguam edhe provat e tjera që ju duhet të merrni pranë Këshillit Kombëtar të Territorit, këshillave bashkiak sa i përket lejeve të ndërtimit apo provave të tjera që duhet të merrni pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për një provë që kishim lidhur me 10 mijë e 3 leje legalizimi të shpërndara në periudhën Janar-Mars 2021. Ne ju treguam provën se ku mund të gjendej shifra reale sesa leje legalizimi ishin shpërndarë në Qarkun e Beratit megjithatë ju refuzuat ta merrni këtë provë duke bërë kështu. U refuzua e drejta për transparencë lidhur me lejet e ndërtimit dhe lejet e legalizimit, të cilat u shpërndanë masivisht në këmbim të votës për Partinë Socialiste. Të nderuar anëtarë të komisionit, një nga qëllimet kryesore që ka legjislacioni zgjedhor në çdo vend të botës është që të sigurojë të drejtën për zgjedhje të barabarta apo të drejtën që subjekte politike që përfshihen në garë të jenë sa më të barabarta dhe mos të ketë pabarazi të tilla që të cënojnë apo ndikojnë në rezultatin zgjedhor. Si mundet një subjekt politik cilidoqoftë ai sado i fortë qoftë ai, sado mbështetje të ketë të vihet në një garë apo të jetë në një garë ku i gjithë shteti është vënë në dispozicion

të një partie. Këto ishin kushtet në të cilat garoi PD-AN, të cilat sigurisht ne besojmë dhe kështu është, vijnë tërësisht në kundërshtim me parashikimitet e Kodit Zgjedhor veçanërisht me ndryshimet e fundit të cilat synojnë të garantonin barazinë nëpërmjet palëve. Ne parashtruam përpara këtij komisioni fakte dhe të dhëna sesi shteti vodhi dhe vendosi në dispozicion të serverave të Partisë Socialiste, të dhënat personale qytetarëve sesi shteti ndaloi me një vendim tërësisht të paligjshëm, të drejtën e 500 mijë zgjedhësve që jetojnë në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut për të votuar në ditën e zgjedhjeve sesi vendimet e papërgjegjshme apo të pa ligjshme në fakt të institucioneve edhe të këtij komisioni por edhe të institucioneve të tjera sollën një numër rekord fletësh votimi dhe konkretisht në Qarkun e Beratit 5292 të tilla ose 6.54%. Ne parashtruam sesi strukturat tona por jo vetëm denoncuan raste të shumta të votimit të shumfishtë, votimit familjar votimit për të tretët apo falsifikimit të identitetit. Ne sot fatmirësisht falë kërkesës së dy anëtarëve të KQZ-së, kemi raportin e sjellë pikërisht nga Administrata Zgjedhore, e cila flet vetë ajo dëshmon se shenjat e gishtërinjve të 21 personave janë përdorur për identifikimin e 57 zgjedhësve. Potencialisht ashtu siç u tregua edhe sot nga marrja në pyetje apo dëshmia e Zevëndëskomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve eksizton mundësia që 21 persona të ketë votuar 57 herë ose rreth 3 herë secili. Do të mjaftonte kjo shkelje kaq e rëndë e legjislacionit zgjedhor por dhe legjislacionit penal për të marrë në konsideratë serjozisht kërkesën për pavlefshmëri dhe përsëritje të zgjedhjeve në Qarkun e Beratit. Të nderuar anëtarë të komisionit, ajo me të cilën u përballëm ne në zgjedhjet e 25 prillit, ishin shkelje të rënda të ligjit si rastet flagrante të blerjes së votës nga drejtues të Partisë Socialiste me individ me rekorde të tmerrshme kriminale të shkrirjes së shtetit dhe partisë të një të vetëm të vjedhjes dhe përdorimit të paligjshëm të të dhënave personale, të mohimit të të drejtës së 500

mijë shtetasve për të votuar, të pavlefshmërisë së vullnetit të 83 mijë zgjedhësve në kutitë e votimit apo rastet flagrante të votimit të dyfishtë. Për të provuar secilin prej këtyre krimeve të tmerrshme që kanë ndodhur në periudhën para, gjatë dhe pas zgjedhore ne ju vumë në dispozicion të gjithë shpjegimet tona në 56 faqe dhe 40 prova që disponondim dhe kërkuam nga ana juaj jo një herë por plot 19 herë që të zbardhet në plotni masakrën zgjedhore të 25 prillit. Ju e refuzuat 19 herë të drejtën për transparencë 184 mijë zgjedhësve në Qarkun e Beratit. E thashë dhe në rastin e kërkesës së Gjirokastrës dhe sigurisht është rasti për ta përsëritur. Ne si përfaqësues ligjor por jo vetëm si parti politike si opozitë e bashkuar e cila u votbesua nga 73 mijë zgjedhës, u përpoqëm ta bëjmë me gjithçka kishim mundësi detyrën tonë për transparencë mbi atë se çfarë ka ndodhur në zgjedhjet e 25 prillit. Ne u përpoqëm të tregonim me fakte dhe prova se 25 prilli, nuk ishte një ditë zgjedhjesh të lira, të ndershme dhe të barabarta por dita kur blerja e votës, kapja e shtetit çdo qelizë, vjedhja e të dhënave personale, mohimi i të drejtës së emigrantëve për të votuar, paligjshmëria me fletët e votimit dhe votimi me tre a katër herë i një personi të vetëm fituan mbi vullnetin e lirë të shqiptarëve. Ne presim që ndryshe nga rasti i Gjirokastrës në vendimmarrjen tuaj për Qarkun e Beratit të mos silleni si noterë të masakrës zgjedhore të 25 prillit, por të silleni si gjyqtarë me integritet personal dhe profesional që nuk lejoni kurrsesi që vullneti i 184 mijë zgjedhësve në Qarkun e Beratit të diktohet nga krimi dhe paligjshmëria. Sa na takon ne ne në çdo rast cilido qoftë vendimi juaj ie drejtë apo i padrejtë do ta vazhdojmë betejën tonë deri në fund për të zbardhur masakrën zgjedhore të 25 prillit si një detyrim të qartë që kemi jo vetëm ndaj 730 mijë zgjedhësve që kanë votuar opozitën e bashkuar, por ndaj 3.5 milionë zgjedhësve shqiptarë që janë të interesuar se çfarë ndodhi në të vërtetë në zgjedhjet e 25 prillit. Prandaj në konkluzion të nderuar, bazuar në nenin 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor, ne

kërkojmë nga ana juaj se pasi të vlerësoni të gjitha pretendimet e shpjeguara nga ana jonë në 56 faqe, 40 prova që iu vumë në dispozicion. Prova dhe shpjegime që iu vumë në dispozicion nga subjekti ankues Lëvizja Socialiste për Integrim, të pranoni këtë ankim të vendosni pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe urdhërimin përsëritës të tyre në një afat sa më të afërt, faleminderit.

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit zoti Logu, tani fjalën e ka për konkluzionet e fundit dhe përfaqësuesi i subjektit të interesuar Partia Socialiste e Shqipërisë. Fjala për ju zoti zoti Salianji.

***Z. E.Salianji, përfaqësues i PS-së:*** Për sa i përket të dy kërkesave ankimore, unë do të shpreh mendimin që e pati një të mirë ky proces, i miri në këtë proces është se u hapën disa kuti materialet zgjedhore dhe u bë transparenca e procesit. Ne që në fillim kemi qenë dhamë dakortësinë tonë për hapjen e këtyre kutive dhe për verifikimin e materialit zgjedhor. Siç u konstatua përveç defekteve teknike ku një zgjedhës më shumë ose më pak kjo ndodhur për shkak paaftësisë së Komisionerëve në mënyrën sesi ata e kanë administruar procesin e votimit ditën e zgjehjeve nuk u vërejt asnjë shkelje ligjore në kuptim të nenit 160, të Kodit Zgjedhor do të ndalonte procesi. U hapën kutitë e votimit, materialeve u panë që listat e zgjedhësve që është elementi më i rëndësishëm i procesit ishte konform parashikimeve të Kodit Zgjedhor në mënyrën sesi zgjedhësit kishin ushtruar të drejtën e votimit. Pothuajse e gjithë baza materiale u verifikua dhe siç thashë më sipër disa defekte teknike nuk mund ta bëjnë procesin pis, nuk mund ta bëjnë aq më tepër dhe të pavlefshëm. Tashmë me ndryshimet e Kodit Zgjedhor kemi krijuar bazë materiale e cila dublon bazën materiale, procesverbalin mbi procesverbal, ke listë zgjedhësish, kemi operatorin PEI. Gjëja më e rëndësishme është kamera në

qendrën e votimit në të cilën dy ankuesit në qoftë se do të kishin pretendime për shkelje të ligjit mund t'i kishin kërkuar, por kjo gjë nuk ka ndodhur për arsye se votimi në këto qendra votimi të ankimuara ka qenë normalisht, E vetmja provë e rëndësishme që do të na bënte ne me dije cilat janë shkeljet që kanë ndodhur mund të na jepte procesi i regjistruar atë ditë në ato qendra votimi, por del qartë nga materiali zgjedhor që nuk ka pasur shkelje të ligjit nëq kuptim të nenit 160 që ta cënojnë procesin është shumë i qartë ligji për sa i përket pavlefshmërisë. Ka ndodhur shkelje të ligjit thotë neni 160, pika "a", të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor. Cënimi i mungesës në një qendër votimi të printimit PEI që ose në një rastin tjetër konstatimin që mungon një procesverbal nuk e bën kutinë e votimit të paregullt dhe procesi i votimit null. Administrim zgjedhor pra u duk qartë që e gjithë baza materiale ishte e pacënuar. Kjo do të vinte në dyshim procesin në qoftë se do të kishim cënim të fletëve të votimit, cënim të, kutive, listës së zgjedhësve të cilët janë elemente thelbësore. Por fotografimi nga 3 element që është kamera identifikimi elektronik PEI si dhe procesverbalet. Pra është një sistem të thashë me ndryshimet e Kodit Zgjedhor i fotografuar nga 3 element, mos njëri tjetri ka qenë në kuti të cilat shërbejnë që ne të kuptojmë ka ndodhur procesi i votimit konform ligjit apo jo. Këto janë dokumente që prodhohen nga komisionerët. Procesin e votimit vlefshnmërinë ia jep dita e votimit, fletë e votimit, doli qartë se asnjë fletë votimi nuk është cënuar. Për sa më sipër e përfundoj u bë mirë që u hapën ato kuti, u bënë mirë që u panë ato shkelje. Pavarësisht se disa i lexojnë shkelje të rënda në qoftë se kali i betejës është mungesa e printimit PEI në një rast ose mungesën e procesverbalit, unë besoj se këto zgjedhje e kanë arritur standartin, faleminderit dhe kërkoj rrëzimin e dy kërkesave.

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit, atëherë do të na duhet të tërhiqemi për të marrë një vednim lidhur me këtë pjesë të kërkesës ankimore. KAS-i do të tërhiqet për vendim dhe do t'iu kërkoj me shumë përulje të ritakohemi këtu në orësn 17:30.

***<u>Rifillon Mbledhja</u>***

***<u>ora 17:36</u>***

***Z. E. Çefa:*** Atëherë KAS-i në përfundim të shqyrtimit administrative të ankimeve kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr,339, datë 04.05.2021, për miratimin e tabelës përmbledhëse, për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Berat për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputet në zgjedhejt për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021 dhe shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në zonën zgjedhore Qarku Berat, mbështetur në shkronjën "v" të pikës 1, të nenit 30, vendimit nr.3 të vitit 2020 Komisionit Rregullator. Në pikën 3 të nenit 21 të Kodit Zgjedhor dhe germën "d",të nenit 143 të Kodit Zgjedhor me shumicë votash vendosi: Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr.34 datë 09.05.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialsite për Integrim. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 42, të datës 09.05.2021,të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni PD-AN. Lënien në fuqi të vendimit nr.339, datë 04.05.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ky vendim është një vendim i ndërmjetëm dhe do të jetë pjesë e vendimit përfundimtar që do të marrë KAS pasi që t'i shqyrtojë edhe Kërkesën Ankimore nr.35 datë 09.05,2021 , me objekt ndryshimin e vednimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.339, datë 04.05.2021, dhe runumërim të votave në ZAZ-të nr.63, 64, 65, 66, 67, 68 Qarkut Berat, e cila me vendim të ndërmjetëm të KAS është bashkuar me Kërkesën Ankimore nr.34 dhe nr.42.

Kundër këti vendimi pra mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë së bashku me vendimin përfundimtar që citova më sipër. Seanca deklarohet e mbyllur dhe ju kujtoj palëve që do të rifillojmë nesër në orën 10:00 me vijimin e seancës për shqyrtimin e kërkesave ankimore që kanë të bëjnë me Qarkun e Vlorës dhe në mbarim të tij do të fillojmë me Kërkesën Ankimore nr.35 për Beratin, faleminderit.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së*
*Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*
*Dt.20.05.2021*

**20.05.2021**

**Ora 10:04**

***RENDI I DITËS***

***Shqyrtimi i kërkesave ankimore nr.34 "Ndryshimi i vendimit 339, datë 04.05.2021 të KSHZ "Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit Qarku Berat", "Rinumërimi dhe rivlerësimin e votave për ZAZ-të 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68", subjekti ankues LSI dhe nr. 35 "Kundërshtimi i vendimit 339, datë 04.05.2021 të KSHZ "Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit, Qarku Berat", "Shpalljen e pavlefshme të procesit të votimit në qendrat e votimit të Qarkut Berat si dhe përsëritjen e zgjedhjeve", subjekti ankues LSI".***

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** **Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI, Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**
- **Stafi KQZ: Y.Merkaj, O.Peto**
- **Parti Politike: PD, LSI, PS**

*Z. E. Çefa:* Mirëmëngjes të gjithëve riçelim seancën e KAS-it për shqyrtimin e Kërkesave Ankimore me Nr.34, 35 dhe 42. Në këtë seancë sikurse u njoftua dje nëpërmjet vendimit të ndërmjetshëm do të kemi si objekt Kërkesën Ankimore Nr.34 të subjektit ankimues LSI, e cila ka për objekt ndryshimin e Vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.339 datë 04.05.2021, rinumërim dhe rivlerësim i votave në ZAZ nr.63, 64, 66, 67, 68 dhe në qendrat e votimit bashkëlidhur këtij ankimi në Qarkun e Beratit duke përfshirë në të dhe miratimin e tabelës së re përmbledhëse, duke përfshirë në të dhe rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave në QV-të e listuara. Verifikojmë pikë së pari prezencën. Janë njoftuar dhe janë paraqitur përfaqësuesit e palës ankuese, LSI

është gjithashtu palë në këtë kërkesë Ankimore për efekt të bashkimit të 3 ankimeve. Subjekti PD - AN ka paraqitur kërkesë dhe është legjitimuar në cilësinë e personit të interesuar subjekti PS-së përfaqësuesi i saj është në sallë është prezent dhe Administrata e KQZ-së. Kërkesa paraprake nga palët nuk më rezulton të kemi, kështu që besoj nuk ka asnjë pengesë për t'i dhënë fjalën mënjeherë përfaqësuesit të ankimuesit për të parashtruar kërkesën e tij ankimore, faleminderit.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Faleminderit zoti relator, si relatuat dhe ju do shqyrtojmë kërkesën ankimore që ka për objekt ndryshimin e Vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.339, datë 04.05.2021, për miratimin e tabelës përmbledhëse të Qarkut Berat rinumërim dhe vlërësim të votave në ZAZ-të sipas tabelës që kemi bashkëlidhur pjesës së ankimit. LSI në përfundim të procesit zgjedhor menjëherë pasimi në ZAZ-të e Qarkut Berat proceduam me dërgimin e materialeve këtu në KQZ, ka bërë shkresat përkatëse administrative me qëllim marrjen e informacionit të nevojshëm për të kqyrur nga afër pamjet filmike të çdo VNV-je në 6 ZAZ të Qarkut Berat dhe pasi këtë proces e ka kryer. Ky ka qenë një proces intensiv i cili realisht merr shumë kohë dhe do shumë burime njerëzore për arritjen e qëllimit të verifikimit të votës drejtësisht ashtu si është shprehur vullneti i zgjedhësve në përfundim të kësaj kqyrje. Nga pamjet e videove të çdo vote ka rezultuar situata që pasqyrohet në tabelën e mëposhtme që ju e keni pjesë të kërkesës tonë ankimore. Do të doja të shpjegoja pak tabelën për të pasur një shpjegim më të qartë dhe ju për të qenë më të qartë lidhur me çfarë është shënuar në këtë tabelë pasqyre dhe pas kqyrjes së pamjeve filmike, kolona e parë pasqyron ZAZ-të përkatëse, kolona e dytë tavolinën e numërimit, e treta QV-në, e katërta rezultatin e votave për subjektin Partia Socialiste dalë nga kqyrja e pamjeve filmike, e pesta votat e PS-së sipas KQZ-së, kolona e gjashtë pasqyron

deformimin midis votave të kqyrura nga materiali filmik dhe votave, kolona e shtatë parashikon votat e LSI-së, rezultat ky i kqyrjes së pamjes filmike, kolona e tetë votat e LSI-së sipas KQZ-së, kolona e nëntë diferencën ndërmjet votave të LSI-së dhe votave sipas KQZ-së, kolona dhjetë vota e vlefshme nga kqyrja e pamjeve filmike, kolona njëmbëdhjetë pasqyron votat e vlefshme sipas KQZ dhe Kolona dymbëdhjetë diferencën midis votave të pavlefshme të këqyrjes së pamjeve filmike dhe votave sipas KQZ-së. Pra ju keni një tabelë të ndarë siç e parashtrova të ndarë në 12 kolona. Nga kqyrja e këtyre pamjeve kanë dalë rezultate që ju i keni në pjesën horizontale fundore të kësaj tabele shifet fare qartë që subjekti politik PS, janë numëruar të paktën për këto qendra votimi të cilat ne kemi kqyrur rreth 233 vota më shumë seç ishte vullneti i zgjedhësve. LSI rezulton të ketë nga 78-80 vota më pak seç ishte vullneti i zgjedhësve bazuar në këto të dhëna në pjesën e tabelës horizontale siç thashë do gjeni pjesën e shpjegimit përkatës sepse ne investojmë në këtë komision me qëllimin final të hapjes së kutive dhe pasqyrimit real të shprehjes së vullnetit me votë në ZAZ-të e Qarkut Berat. Nisur nga rezultati i shpallur nga KQZ për ndarjen e mandateve në Qarkun Berat rezulton se LSI ka 77 vota më pak se herësi i pestë i subjektit PS. Pra subjekti LSI nqs i shtohen 78 ose 80 vota të hequra padrejtësisht në total, rezulton se totali i votave do të bëhej 8474. Në rast se do të zbatojmë formulën e ndarjes së mandatëve parashikuar në nenin 162 të Kodit Zgjedhor për subjektin zgjedhor PS, rezulton se herësi i pestë për këtë subjekt është 8471 vota, pra siç shihet qartë numri i votave të subjektit LSI është më i madh se herësi i pëstë i subjektit PS. Rrjedhimisht subjekti PS duhet të përfitonte 4 mandate, subjekti PD 2 mandate dhe subjekti LSI 1 mandat. Për këto që u parashtruan më sipër vlerësojmë se me transparencë, ky komision duhet të ndërmarrë hapa të mjaftueshme për kqyrjen e gjithë materialit të ndodhur në këto QV për të cilat LSI ka kërkuar kqyrjen e tyre,

hapjen e tyre dhe numërimin e tyre ne seancë publike pranë këtij komisioni dhe për këtë kërkojmë që të dispononi me vendim të ndërrmjetëm për pranimin e kësaj kërkese, faleminderit.

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Do të doja nqs se mundem zoti relator në cilësinë e provës materiale, kam 4 materiale video të cilat pasqyrojnë fletët e votimit të kqyruar, të pavlefshme, të cilat janë konsideruar si të vlefshme për subjektin politik PS.

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit, mund t'i dorëzoni të administrata. Përfaqësuesit e subjekteve të tjerë?

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Duke qenë plotësisht dakord me parashtrimin e kolegut të LSI-së, ne e mbështesim dhe e kërkojmë edhe ne që të rinumërohen dhe rivlerësohen të gjitha kutitë në QV-të Berat me qëllim që të dalë siç ka qenë vullneti zgjedhësve në këtë qark edhe për shkak se diferenca ndërmjet palëve siç me të drejtë u relatua nga përfaqësuesi i LSI-së, është një diferencë e ngushtë e cila besoj se mund te ketë ardhur dhe nga verifikime të kryera nga ana jonë. Si rezultat i disa vlerësimeve të gabuara që i janë bërë votave gjatë procesit të numërimit të tyre. Kështu që dhe subjekti PD-AN, kërkon që të hapen të gjitha kutitë e Qarkut Berat, të rinumërohen dhe rivlerësohet çdo votë dhe rezultati përfundimtar të pasqyrojë veçse vullnetin e zgjedhësve në Qarkun e Beratit, faleminderit.

***Z. L. Braho:*** Përpara se të kalojmë tek përfaqësuesi i PS-së, zoti Kaziaj ju kërkoni rinumërimin dhe rihapjen e votave të një sërë qendrash votimi me numër të caktuar apo gjithë Qarkut Berat?

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Ne do ishte mirë të gjithë qarkut, siç e thashë në relatimin tim zoti Braho sistemi i kqyrjes së pamjeve filmike të çdo QV-je nga ana e subjekteve zgjedhore ankuese është një proces që te merr realisht fizikisht shumë kohë dhe nga rezultati, aq qendrave sa ju keni të disponueshme me kërkesën ankimore, ne kemi gjetur këto parregullsi. Ne do ishim të mendimit që të vijojmë më hapjen e gjithë Qarkut të Beratit, faleminderit dhe rivlerësimin e votave.

***Z. E. Çefa:*** Po faleminderit, përfaqësuesi i PS-së?

***Z. E. Salianji, përfaqësuesi i PS-së:*** Nga leximi dhe dëgjimi i kërkesës ankimore të subjektit ankues, ne vërejmë që kjo kërkesë nuk është në përputhje me atë që parshikon Kodi Zgjedhor. Ne pritëm për këto rreth 10 ditë që ky subjekt ankues të paraqiste provat të cilat kërkon vetë ligji që kutitë duhen hapur. Në përputhje me nenin 138, paragrafi 3, i Kodit Zgjedhor, tashmë kjo procedurë është shumë e qartë se si rinumërohen dhe vlerësohen fletët e votimit të kontestuara. KQZ-ja neni 138, pika 3, me kërkesën e palëve ose kryesisht përçmosjen e dhënies së votimit është i nevojshëm rinumërimi dhe ose rivlerësimi i votave të caktuara, kryen në prani të palëve rinumërim dhe pasqyron përfundim procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së dhe me vendimin përkatës të saj. Vota të caktuara janë ato vota të identifikura ose kontestuara sipas procedurave të neneve 116 dhe 118 të këtij kodi për të cilat është kontestuar vlerësimi ose numri i tyre gjatë procesit të numërimit si dhe votat e tabelës së rezultatit kundërshtuar sipas pikës 2, nenit 119, të këtij Kodi. Të

nderuar anëtarë hidhemi te neni 116 dhe 118, ku është procesi i numërimit të votave në vend numërimi ku secili numërues ka të drejtë të kontestojë votat dhe të identifikojë dhe këto janë në kuptim të nenit 138. Vota të caktuara tashmë dihet që hapja, rimunërimi i fletëve të votimit në fakt ka qenë një betejë e kahershme e PS-së dhe standarti i vendosur është parashikuar dhe në ligj dhe unë prisja që pala anskuese të sillte një procesverbal të paktën një që do kishte kontestime nga numëruesit e Qarkut Berat. Ne jemi njohur me të gjithë tabelat e rezultateve nuk ka asnjë kontestim në asnjë tabelë të rezultateve të grupeve të numërimit për këto vota. Dhe kjo e bën që ky proces i numërimit në atë kohë që është bërë nuk ka pas kontestime. Pra kontestimi vjen mbas daljes së rezulatit dhe tashmë dihet që rezultati është i ngushtë dhe shumë i ngushtë 77 vota e kan ndarë mandatin për ne si PS nuk është i rëndësishëm mandati, por është i rëndësishëm në radhë të parë e kemi thënë në fillim të procesit zgjedhor është procesi dhe për të hequr çdo dyshim mbi procesin e vlerësimit të votave në Qarkun Berat. Ne biem dakord të hapen kutitë e kërkuara në kërkesën ankimore të ankimuesit, pavarësisht se jemi të mendimit që mandati nuk do ndryshojë, por e ritheksoj që ky mandat me këtë proces që do zhvillojmë do të heqim çdo pikë dyshimi që është një mandat i fituar konform rregullave ligjore, faleminderit.

***Z. E. Çefa:*** Ju faleminderit, po zoti Kaziaj?

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Një saktësim për sa i përket pjesës së relacionit që na bëri përfaqësuesi ligjor i subjektit PS, nqs sheh në pjesën përmbyllëse të kërkesë ankimore i nderuar keni të gjitha provat që kemi sjellë në kuadrin e provueshmërisë së kontestimeve të bëra në vendin e numërimit të votave. Kështu që mos krijojmë destabilizim të kotë që sapo vumë në dispozicion të KAS dhe

prova filmike të kontestuara nga ana jonë të gjetura nëpërmjet kqyrjes së pamjeve, materialit të marrë pranë KQZ të cilat kanë kaluar për subjektin që ju përfaqësoni dhe ju këtë e dini fare mirë. E dini fare mirë që nga hapja e këtyre kutive mund të dalin rezultate jo të mira për ju dhe këtë gjë ju e keni të qartë ndaj po bëni të themi lojra fjalësh duke kontestuar diçka që me prova dhe me fakte është në disponim të KAS.

***Z. E. Çefa:*** Zoti Kaziaj, përpara se t'ja jap fjalën kolegëve për ndonjë pyetje evenduale, ju lutem a mundeni edhe për transparencë të na i citoni provat që ju tashmë i keni bashkëlidhur kësaj kërkese ankimore në mënyrë që ta përmbyllim finalisht këtë fazë procesi.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Po zoti Çefa patjetër, atëherë siç thashë në pjesën ku ne disponojmë me privat që kërkojmë të merren nga ana juaj e shikoni fare mirë. Pika 1 është pjesa e vendimit të komisionerit që kontestojnë, pika 2 e librit të protokollit të ZAZ-ve pra ne kemi marrë gjithë librat e protokollit të 6 ZAZ-ve të Qarkut Berat dhe nga ata nga përmbajtja e tyre keni kontestime të mjaftueshme për të arritur në një vendimmarrje objektive, ju i keni të disponueshme këto prova dhe ne ja u kemi dhënë një kopje është tabela përmbledhëse e kandidatëve e cila me shume zarfa të kandidatëve unë dhe në kërkesën tjetër ankimore që shqyrtuam dje ju vumë në dispozicion tabela përmbledhëse me zero si janë numëruar votat ku janë me zero për kandidatët ndërkohë që Kodi Zgjedhor e parashikon që kanditati parapëlqyese mund të votohet dhhe vota i shkon drejt përsëdrejti dhe subjektit ne këtë rast. Si është numëruar kjo votë? Po, ashtu keni dhe procesverbalet e kontestimit në ZAZ 66, që mban datën 27.04.2021, lidhur me QV 3445 janë gjetur mospërputhje të këtyre

votave. Ne këto kontestojmë dhe pamjet fimike të vëna në dispozicion ditën e sotme nëpërmjet 4 materialeve video të nderuar zotërinj të këtij komisioni kolegjial të themi ato janë provat që ne kemi vënë në dispozicion të KAS për hapjen e këtyre kutive dhe pas hapjes se tyre dhe rinumërimit dhe rivlerësimit të këtyre votave mendojmë që duke qenë një rezultat shumë të ngushtë të përbërë prej 77 votash për kandidatin tonë për deputet mendojmë që ky mandat do fitohet nëpërmjet rivlerësimit të këtyre votave.

***Z. E. Salianji, përfaqësuesi i PS-së:*** Mundem?

***Z. E. Çefa:*** Po, patjetër.

***Z. E. Salianji, përfaqësuesi i PS-së:*** Pra ajo çfarë unë e thashë në fillim dhe mbas pyetjes tuaj u sqarua që në asnjë tabelë të grupit të numërimit nuk ka asnjë votë të kontestuar. Ajo është prova të cilën kërkon neni 138 por unë prandaj dhe në përfundim të fjalës time për shkaqe që sdua ti përsëris thahsë të hapen ato kuti votimi dhe nqs ndryshon rezultati duhet të rishikojmë kutitë e tjera që ne shprehim rezervën tonë për tu shprehur për më tepër procesit, por nuk mund të kërkojmë gjithë qarkun kur kërkësa e ankimuesit është me qendra të caktuara pavarësisht se në asnjë tabelë numërimi nuk ka kontestuar asnjë votë për ta kthyer këtë votë të caktuar por tashme ne ramë dakord për hapjen e kutive të paraqitur nga kërkuesi në kërkesën ankimore.

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit. Po zoti Logu.

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Mendoj se e ezauruam debatin por besoj e shpjegoj zoti Kaziaj thjesht ndoshta për ta ritheksuar dhe njëherë dmth janë kërkuar aq kuti votimi sa kanë pasur mundësi për ti verifikuar në një kohë të shkurtër sigurisht po themi rezultati siç ka qenë dhe është në Qarkun e Beratit. Pra vullneti i këtyre votuesve në datën 25 prill do të dalë si rezultat i hapjes së të gjitha kutive të të gjithave qendrave të votimit Qarku Berat. Mendoj që fatmirësisht jemi dakord të gjitha palët edhe kolegët e PS-së kështu që nuk ka kuptim që ta vazhdojmë këtë debat e le të procedojmë se besoj na pret e një punë e gjatë, faleminderit.

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit, nga kolegët pyetje? Po zoti Braho.

***Z. L. Braho:*** Në fakt doja të sqaroja diçka edhe në fakt me atë çka tha zoti Salianji. Është e vërtetë që kodi përcakton disa kushte për vota të caktuara por dhe nga vendimmarrja e Komisonit Qendror të Zgjedhjeve 2017 më saktësisht është vendimi nr.546 datë 13.07.2017, që bënë arsyetimin që bëri zoti Salianji por pastaj thotë pavarësisht dokumentacionit të sipërpërmendur materiali zgjedhor i nxjerrë nga pamjet filmike në disa raste krijon dyshimin së vlerësimi i votës nuk është bërë në mënyrë të drejtë nga grupet e numërimit. Gjithashtu KQZ vlerësoi se transparenca lidhur me numërimin dhe vlerësimin e votave për zonën zgjedhore Qarku Tiranë ka një rëndësi të madhe për besueshmërinë e procesit zgjedhor dhe për integritetin e tij për sa kohë ankuesit nga kqyrja e materialeve filmike kanë dyshim se në disa qendra votimi objekt ankimi vota nuk është vlerësuar saktë nevoja për trasparencë e procesit të votimit për këto qendra votimi dhe vijon më tej me arsyetimin, pra KQZ ka mbajtur qëndrim që pavarësisht faktit se jemi në kushtet e atyre neneve që përcaktojnë për vota të aktuara momenti që krijohen

dyshime në lidhje me pamjet filmike që administrohen nga KQZ-ja. Atëherë patjetër që për transparencë të procesit zgjedhor është shumë e rëndësishme sidomos që për qarqe të tilla si ai i Beratit që mandati ndahet me shumë pak vota. Megjithatë unë kërkoj nga zoti Kaziaj që të na sqarojë një diçka tjetër se foli dhe për vota kandidtësh. Tani procesin e rinumërimit apo vlerësimit të votave e kërkoni vetëm për subjektet zgjedhore apo dhe për kandidatët se janë dy gjëra të ndryshme apo për kandidatët e kërkoni vetëm për ato QV ku tabela është me zero? Që ta sqarojmë.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Në kuadër të asaj që sapo cituat zoti Braho që ky proces i duhet një tranparencë e përgjithshme dhe një besueshmëri të themi totale te të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë dhe mbase dhe tonën të palëve ankuese ose tuajën si komision ato vota nuk mund të rrinë më zero. Ato ja lemë vlerësimit tuaj nqs do kërkoni të hapen vetëm ato me zero apo ne duam që të hapim votat të gjitha mundësisht qofshin dhe votat e kandidatëve, qofshin dhe votat për subjekt të haen kutitë e numërimit dhe të numërohen.

***Z. L. Braho:*** Mund të na e përcaktoni ju ose KQZ-ja kush janë QV-të me vota kandidatësh tabelë përmbledhëse zero, para se të vijojmë një vendimmarrje?

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Në fakt do na duhej pak kohë, por nqs i referohemi tabelës që ne kemi vënë në dispozicion nga kqyrja e pamjeve filmike. Do të donim që fillimisht të mbështeteshim tek kjo tabelë qoftë tek kandidatët qoftë te pjesa e subjekteve zgjedhore dhe më pas të vazhdohet me të gjithë Qarkun Berat me të gjitha QV-të në të gjitha ZAZ-të.

***Z. L. Braho:*** Edhe këtë ta kuptojmë më qartë nqs nga hapja e këtyre kutive që ju pretendoni se keni tabelë, nqs rezulton se nuk ka ndryshim rezultati do vijoni më tej me kërkesën? Pra do vazhdoni ta keni qëllim kërkesën dhe për hapjen e kutive të tjera?

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së***: Ne këtë kërkesë e bëjmë mediate që nga ky moment dhe e parashtrum dhe më përpara dmth të jemi objektiv ne nga objektiviteti jonë për aq kohë sa kemi pasur në dispozicion kemi gjetur këtë përmbledhje që e kemi pasqyruar në një tabelë është në të mirë të procesit transparenca edhe nqs rasti më ekstrem që do dalim humbës që ska për të ndodhur ka një interes madhor që është transparenca e procesit zgjedhor në Qarkun e Beratit.

***Z. K. Bele:*** Kisha dhe unë diçka.

***Z. E. Çefa***: Po zoti Bele.

***Z. K. Bele:*** Ne kemi një kërkesë për 114 kuti nga 277, pra është mbi 40% e kutive. Kemi rënë dakord për një nivel trasparence për materialin zgjedhor dhe ligji e jep mundësinë alternative. Çështja është ne kemi dhe një detyrim të procedojmë në një afat të arsyeshëm. Pra nëse ka një pamje mund të jetë dhe për kusurin e qarqeve. Supozimi logjik nisur me këtë kërkesë do të jetë që do numërohen dhe këto 114 kuti. Ajo që tha zoti Braho të njëjtën pyetje do e shtroja dhe unë mund të ishtë dhe një kërkesë kompromisi në thonjëza. Pra nëse nuk ndryshon rezultati do jetë e paarsyeshme qoftë dhe në respekt të publikut dhe detyrimit ligjor brenda një afati që është indikativ 10 ditë, por ka pas një qëllim ligjvënësi pasi do duhet që ta

mbyllim këtë proces. Por dhe bimët dhe burimet njerëzore të gjitha këto kanë një vlerë të caktuar per më tepër kur kodi me ndryshimet e reja e jep mundësinë që të kërkohet më vonë numërimi nga kandidatët. Ne në këtë sallë të paktën flas për veten mos të marr persipër për kolegët nëse numërohet gjysma e kutive dhe janë ato gati gjysma te cilat ju nga kaq i keni vlerësuar që kanë probleme besoj ju matematikisht është e pamundur t'ju ndryshojë rezultati thjesht do kërkohet që ne të rrimë këtu disa ditë më tepër të harxhojmë kohë burime njerëzore vëmendje të gjitha bashkë. Kështu që unë do të propozoja që do ishte e arsyeshme dhe nuk e di pse ju mund të gjeni një shkak aparent logjikshëm që ta refuzoni, numërojmë ato 110 kuti e masandej në momentin mbasi të mbarojmë atë proces jemi këtu diskutojmë përsëri. Nuk e di për ta kuptuar KQZ-ja i ka prurë ato 110 të dizenjuara.

***Z. Y. Merkaj:*** Jo për sa kohë skeni marrë vendim.

***Z. K. Bele:*** Dakord.

***Z. E. Çefa:*** Po zoti Lako.

***Z. E. Lako:*** Një pyetje për zotin Kaziaj, më përmend afati në kohën kur është bërë ankimi për Qarkun Berat ka qenë ato ditë që ka përcaktuar kodi atë gjë të gjithë e dimë dhe nga ajo kohë deri më sot ka kaluar dhe një periudhë tjetër dhe ju e dini që do të sillnit nëse do të kishit prova të tjera për të përmbushur këtë kërkesën e re për të hapur gjithë Qarkun Berat përse nuk e keni bërë dhe duke pasur parasysh në vijim të asaj që u tha dhe nga përfaqësuesi i palës së interesuar që nuk ka pasur kontestime nga grupet e numërimit nga qendrat e votimit KZAZ. Nuk mund të

bëjë KAS gjithë punën e Administratës Zgjedhore nqs nuk ka pasur kontestime, ju pse kërkoni se mund të kërkojë çdo qark të hapet nga kutia e parë të kutia fundit, atëherë i bie që ne zëvendësojmë gjithë Administratën Zgjedhore. Dhe nqs ju keni zbuluar disa prova hajde ti hapim ato, pse nuk keni vazhduar me plotësimim, sepse keni pasur mundësinë të sillnit dhe prova të reja për pjesën tjetër të mbetur të kutive.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Po zoti Lako sjell në vëmendje të KAS, që KAS duhet të jetë e thënë më mirësjellje pak i vëmendshëm për shkak se ne ditën e djeshme mbaruam kqyrjen e materialeve zgjedhore të 24 kutive të një kërkesë tjetër ankimore që kishte të bënte me Qarkun e Beratit nuk ka se si një anëtar i KAS në bazë të një deklarate që bën një përfaqësuesi ligjor PS do te thotë se ska kontestime, ku ndërkohë nga hapja e kutive u gjetën kontestime në çdo procesverbal në shumë procesverbale. Si munet ta themi që nuk ka pas kontestime? Kjo nuk është e vërtetë. Pastaj lidhur me atë që ishte pyetja juaj e parë që pse skemi sjell material tjetër për hapjen e kutive? Kodi Zgjedhor nuk parashikon një tavan sesa material duhet të sjellim dhe një dysheme. Jep vetëm indicie ne kemi sjell aq indicie të paktën për 114 të themi QV, të cilat ka pasur parregullsi në adresimin e votës dhe kjo është e mjaftueshme.

***Z. E. Çefa:*** Ju faleminderit, pyetje të tjera, komente të tjera? Nuk ka.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Dy procesverbale që kemi arritur të gjejmë gjithsesi e lemë në vlerësimin tuaj këtë pjesë të kësaj kërkese.

***Z. E. Çefa:*** Dakord, atëherë, ndërkohë që informohemi dhe për numrin e saktë të kësaj QV, ne do tërhiqemi për vendim të cilin besoj do ja u komunikojmë për 15 minuta, faleminderit.

***Rifillon mbledhja***
***Ora 11:05***

***Z. E. Çefa:*** Vendim KAS vendosi: Numërimi i votave për kandidatët për kutitë 33 24 dhe 33 56, të Zonës Zgjedhore Qarku Berat dhe me shumicën e votave KAS vendosi: Rinumërimin e kutive të votimit sipas listës bashkëlidhur kërkesës ankimore të subjektit Lëvizja Socialiste për Integrim, vetëm për sa i përket votave për subjektet zgjedhore. Administrata, ju lutem na sqaroni sa kohë do t'ju duhet për të transportuar kutitë e votimit dhe për të bërë mbajten e infrastrukturën për rinumërim? Janë 114 kuti mesa pashë.

***Z. Y. Merkaj:*** Besoj deri nga ora 13:00, jemi gati për të filluar rinumërimin.

***Z. E. Çefa:*** Atëherë ne do e rimarrim seancën në orën 14:00. Ndërkohë vazhdojmë me seancën për Vlorën.

***Z. Y. Merkaj:*** Kutitë e votimit janë në Lundër, në qoftë se partitë politike kanë ndonjë merak mund t'i shoqërojnë.

***Z. E. Çefa:*** Kjo është çështje e organizimit të punës nga ju. Merrni të gjitha masat që transporti të bëhet sipas procedurës.

***Z. M.Logu, përfaqësues i PD-së:*** A mund të autorizohet nga një përfaqësues i partive politike për të bërë shoqërimin e kutive?

***Z. E. Çefa:*** Patjetër.

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Do të caktojmë një person.

***Z. E. Çefa:*** Sigurisht dhe për vëzhguesit që do të jenë prezent.

Atëherë kjo seancë pezullohet dhe vijojmë me Vlorën, ndërkohë e rimarrim në orën 14:00, faleminderit.

**20.05.2021**

**Ora 14:05**

***RENDI I DITËS***

***<u>Procedura e hapjes së kutive të votimit për disa ZAZ të Qarkut Berat.</u>***

**<u>PJESËMARRJA :</u>**

- **KAS:** **Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI, Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**
- **Stafi KQZ:** **Y.Merkaj, O. Peto, E. Çeço**
- **Parti Politike:** **PD, LSI, PS**

***Z. E. Çefa:*** Ju lutem, po i'u kujtoj që duhet të mbani pak qetësi brenda mundësive. Atëherë, po riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 34 me subjekt ankimues, subjektin zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim. Siç jeni tashmë në dijeni nga vendimi i ndërmjetëm i KAS u pranua kërkesa e subjektit për rinumërimin e kutive të votimit për 114 Qendra Votimi. Sikurse shihet administrata ka krijuar kushtet për fillimin e numërimit. Nuk e di nëse përfaqësuesit e subjekteve kanë marrë masat për vëzhguesit, zoti sekretar i përgjithshëm?

***Z. Y. Merkaj:*** Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kanë ardhur listat e vëzhguesëve për Partinë Lëvizja Socialiate për Integrim dhe Partinë Socialiste.

***Z. E. Çefa:*** Pra, nuk kemi pengesa për të filluar?

***Z. Y. Merkaj:*** Për Partinë Demokratike po presim të vijnë listat. Duhet parë subjekti Partia Demokratike.

***Z. E. Çefa:*** Pra, duhet të presim?

***Z. Y. Merkaj:*** Po.

***Z. E. Çefa:*** Dakord, atëherë mund të fillojmë me shpërndarjen e kutive nëpër tavolina, ju lutem.

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë, para se të filloj shpërndarja nëpër tavolina do të lexojmë emrat e anëtarëve të grupit të numërimi:
Tavolina nr. 1 – Labeate Zeneli, Adrian Losha.
Tavolina nr. 2 – Julian Plepi, Melisa Liça.
Tavolina nr. 3 – Fadil Kapllani, Julian Bytyçi.
Tavolina nr. 4 – Lorena Mavriqi, Ambra Agolli.
Tavolina nr. 5 – Elio Ramo, Bianka Bego.
Tavolina nr. 6 – Klodiana Nogu, Rusvelt Shehu.
Tavolina nr. 7 – Bledi Kodra, Anduela Xhaferaj.
Tavolina nr. 8 – Migena Cibinaku, Blerta Lulaj.
Këto janë anëtarët e grupit të numërimit.

***Z. E. Çefa:*** Dakord, ndërkohë dhe përfaqësuesit e subjekteve janë në sallë, fillojmë atëherë.

***Z. Y. Merkaj:*** Presim të vinë nga Partia Demokratike, nuk e di zoti Logu?

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Po ne kemi 8 përfaqësuesit tanë që do të jenë prezent në emër të Partisë Demokratike. Duhet t'i lexojmë emrat? Ka nevoj?

***Z. E. Çefa:*** Jo, nuk ka nevojë nëse i keni praraqitur tek administrata, në rregull.

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Mirë atëherë, ne sapo i morëm dhe për pak do t'i paraqesim. Vëzhguesit fizikisht janë të parnishëm? Që të bëjmë ndarjen pastaj.

***Z. E. Çefa:*** Mund të fillojmë procesin?

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Do të donim pak kohë i nderuar zoti relator në mënyrë që të vinë edhe vëzhguesit e Lëvizjes Socialiste për Integrim.

***Z. E. Çefa:*** Dakord, sa kohë i'u duhet Avokat?

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Një çerek ore besoj.

***Z. E. Çefa:*** Dakord.

***Z. Y. Merkaj:*** Zoti Kryetar vazhdojmë? Do t'i shpërndajmë kutitë sipas kërkesave ankimore që ka bërë LSI-ja, sipas kërkesës ankimore. Do të fillohet nga kutia QV nr. 3332, QV nr. 3447, QV nr. 3483 e me rradhë. Atëherë, fillojmë me qendrën e parë në grupin e parë të numërimit.

***Z. E. Çefa:*** Dakord. Ndërkohë më fal, zoti sekretar i përgjithshëm përfaqësuesit e LSI-së kanë ardhur apo akoma?

***Z. Y. Merkaj:*** Po, po të PD-së po, të LSI-së kanë ardhur të parët.

***Z. E. Çefa:*** Jo, LSI-ja kërkoi kohë.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Zoti sekretar mos u shprehni në emrin e LSI-së, pyeti për përfaqësuesit e LSI-së, ju nuk jeni anëtar i LSI-së.

***Z. E. Çefa:*** Jemi gati apo akoma Avokat?

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Jemi gati zoti relator.

***Z. E. Çefa:*** Jemi gati?

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Jemi gati vetëm ju luteshim të bënim disa qartësime lidhur me procedurën që do të ndjekim dhe me një karrige që duhet t'u vendoset në dispozicion dhe vëzhguesve për shkak se procesi do të na marrë kohë të mjaftueshme dhe lodhja bën pjesën e saj.

***Z. E. Çefa:*** Po sigurisht. Atëherë, para se të fillojmë do t'i kërkoj të gjithëve mirësinë të mundoheni të mbani pak qetësi në mënyrë që procesi të vijojë normalisht, sepse siç e shikoni nuk jemi në kushte të zakonshme. Do të na duhet secilit të kontribuojmë për aq sa mundet që ky proces të shkoj mbarë. Do të vendosim disa rregulla të thjeshta të rinumërimit. Nëse grupet e rinumërimit do të hasin fletë votimi të cilat i kontestojnë apo për të cilat do të kenë nevojë për opinionin e anëtarëve të KAS-it. Do të procedojmë në këtë mënyrë, do t'i administrojmë fletët e votimit veç deri në përfundim të numërimit të kutisë, në përfundim të numërimit të kutisë do të njoftojnë nëpërmjet ngritjes së dorës KAS-in, i cili do të administrojë fletët nëse ka paqartësi do t'i vlerësojë dhe do të proçedojmë. *(nuk dëgjohet pyetja)* Po, do të njoftojnë Administratën dhe më pas do të proçedojmë ne si KZAZ pra, për të bërë dhe rivlerësimin e fletëve të paqarta të votimit, shpresoj mos të kemi shumë. Po ashtu, do të dëshironim që për çdo tavolinë votimi, për çdo kuti që rinumërohet të kemi të administruar një kopje të tabelës të miratuar dhe po ashtu edhe një kopje të tabelës ekzistuese në mënyrë që ne të jemi në gjendje të bëjmë krahasimin ndërmjet rezultatit që ishte dhe rezultatit eventual që do të dalë nga rinumërimi.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Mundem zoti relator?

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Nëse administrata na ndihmon me pjesën e vënies në dispozicion të materialit ose procesverbalit që do të mbahet në tavolinat e numërimit në mënyrë që ta kemi dhe ne disponibël për të parë se si është formati nëse kanë nevojë për rregullime të mëtejshme apo jo, sepse evidentimi i çdo vote nëpërmjet rivlerësimit ka një vlerë shumë të madhe për ketë ky proces po bëhet.

***Z. E. Çefa:*** Sigurisht, patjetër administrata do të marrë masa për t'iua plotësuar edhe këtë kërkesë.

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë, formati është i përcaktuar me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është formati tabela përmbledhëse e rezultatit modeli ZAZ 29 e kemi thjeshtuar. Kemi hequr anëtarët e grupit të numërimit 4 veta që kanë qenë, e kemi bërë me 2 anëtarë që janë pjesë e Administratës së KQZ-së.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Atëherë, për të gjitha zoti sekretar, ju lutem për të gjitha QV-të dhe të themi kutitë e votimit që do të hapen në këtë moment dhe në vazhdim ju lutem të na vini në dispozicion gjithë këtë material, faleminderit.

***Z. Y. Merkaj:*** Kjo është tabelë bosh, do tabelën bosh?

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Dua tabelën bosh.

***Z. Y. Merkaj:*** Patjetër, ta jap unë tani.



*Zbardhi materialin audio*
*Jonida SALILLARI*

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Dua edhe qendër të votimit.

***Z. Y. Merkaj:*** Dakord.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Normalisht, bashkarisht me KAS bashkohemi që duam dhe evidencat e mëparshme dhe tabelat që keni të tanishme.

***Z. E. Çefa:*** Atëherë, zoti sekretar i përgjithshëm mund të vijojmë procesin.

***Z. Y. Merkaj:*** Po, sa të shpërndajmë kopjet.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Zoti relator edhe diçka me lejen tuaj ju lutem, edhe bashkë me kërkesën që sapo bëmë të lutem të na vihen në dispozicion dhe kodet e kutive që do të hapen në mënyrë që të verifikojmë përputhshmërinë e tyre me kodet ekzistuese kur janë mbyllur.

***Z. E. Çefa:*** Nuk e di sa është e mundur që ky proces të mbulohet nga vëzhguesit thjesht për ekonomi..

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Jo, vëzhguesi mbulon vetëm pjesën e fletëve, sepse duhet të jetë i përqëndruar tek numërimi dhe vlerësimi i votës, ne të administratës shohim pjesën tjetër.

***Z. L. Braho:*** Zoti Kaziaj kur hapen kutitë nuk ka fletë pra, para se të hapet kutia të mbajnë shënim kodet dhe ju bëni verifikimin.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Po e rrëzoni kërkesën zoti Braho?



*Zbardhi materialin audio*
*Jonida SALILLARI*

***Z. L. Braho:*** Nuk ka rrëzim kërkese, pranim kërkese..

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Ishte një kërkesë, të lutem.

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë, më fal..

***Z. L. Braho:*** Nuk është idea tani po të fillojmë që me zë të lartë të themi kodet e çdo kutie..

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë, vazhdojmë procedurën? Po e fillon grupi i parë i numërimit do të lexojë kodet me të cilat është mbyllur kutia e fletëve të votimit të QV nr. 3332, KZAZ nr. 63.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Cila QV ishte zoti Sekretar edhe njëherë?

***Z. Y. Merkaj:*** QV nr. 3332 sipas kërkesës ankimore të Lëvizjes Socialiste për Integrim.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Domethënë, do të vazhdojë me rendin e kërkesës ankimore, të themi?

***Z. Y. Merkaj:*** Po.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Dakord.

***Z. Y. Merkaj:*** E shpjegova, por nuk ke qenë i vëmendshëm.

***GNV nr. 1, zoti A. Losha:*** 323877; 233879; 323872; *(nuk dëgjohet)*

***Z. Y. Merkaj:*** Julian lexo kodet.

***GNV nr. 2, zoti J. Plepi:*** 305855; 323914; 323532; 323405; *(nuk dëgjohet)*

***Znj. E. Çeço:*** Komfirmohet.

***GNV nr. 3, zoti J. Bytyçi:*** Atëherë, QV 3483 e KZAZ-së 63 kutia e votimit hapet me kodet 323231; 323232; 323236; 323238.

***Znj. E. Çeço:*** Komfirmohet.
*(ndërpritet audio)*

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Ju lutem, pezulloni pak procesin sepse nuk kemi përputhshmëri të kodit.

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë, do të na duhen 5 minuta pushim për të fotokopjuar përsëri kodet. Zoti Çefa do të vazhdojmë me kutitë e tjera?

***Z. E. Çefa:*** Po, dakord nëse jemi gati po.

***Z. Y. Merkaj:*** Ne i kemi dhënë procesverbalet.

***Z. E. Çefa:*** Përfaqësuesit e subjekteve po fillojmë me kutitë e tjera. Dakord, vazhdojmë.

***Z. Y. Merkaj:*** Lexoji edhe një herë kodet.

***Znj. E. Çeço:*** I tha ai 4 kodet vetëm një i kishte ngelur.

***Z. Y. Merkaj:*** Nuk ka lidhje, t'i lexoj edhe njëherë të 4.

***GNV nr. 3, zoti J. Bytyçi:*** QV nr. 3483 hapet me kodet: 323231, 323232, 323236, 323238.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet.

***GNV nr. 4, zonja A. Agolli:*** QV nr. 3344/1 hapet me kodet: 333215, 323814, 323810, 323811, 323017.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet.

***GNV nr. 5, zonja B. Bego:*** Kutia e votimit e QV nr. 3485 hapet me kodet: 323850; 323857; 323858; 323034; *(nuk dëgjohet).*

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet.

***GNV nr. 6, zonja K. Nogu:*** QV nr. 3333 kutia është e mbyllur me kodet: 323845; 323873; *(nuk dëgjohet).*

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet.

***GNV nr. 7, zoti B. Kodra:*** *(nuk dëgjohet)*

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet.

***GNV nr. 8, zoti B. Lulaj:*** *(nuk dëgjohet)*

***Znj. E. Çeço:*** Komfirmohet.

***Z. Y. Merkaj:*** Zoti Bele ndoshta duhet ta evidentojmë.

***Z. K. Bele:*** Zoti Merkaj për procedurë kur të bëhen gati për ta mbyllur një kuti të fillojnë të vinë pranë. Në qoftë se ata kanë mbaruar çfarë kanë patur për të bërë dhe ka ardhur momenti.. vetëm kjo fletë ishte? Dakord, KAS?

***Z. E. Çefa:*** KAS vendosi që ajo fletë është e vlefshme.

***Z. Y. Merkaj:*** Qendra e Votimit nr. 3344/1.

***Z. K. Bele:*** E saktëson që ishte një fletë dhe doli një fletë e kontestuar.

***Z. Y. Merkaj:*** Po.

***Z. E. Çefa:*** Atëherë, vendim i ndërmjetëm i KAS-it përsa i përket 2 fletëve të votimit të kontestuara në tavolinën e numërimit nr. 1 që i përkasin QV nr. 3332 të Qarkut Berat është kontestuar një fletë e cila nga KZAZ është konsideruar e vlefshme dhe po ashtu konsiderohet e vlefshme edhe nga KAS-i për subjektin Partia Socialiste. Është kontestuar gjithashtu një fletë votimi tjetër, e cila ka rezultuar e pavlefshme, por KAS e konsideron të vlefshme në favor të subjektit Lëvizja Socialiste Për Integrim, me shumicë votash.

***Z. Y. Merkaj:*** Më fal, zoti Relator mund të vazhdojmë të mbyllim kutitë për ato që nuk kanë kontestime dhe kanë plotësuar tabelën përmbledhëse të rezultatit?

***Z. E. Çefa:*** Dakord, po mund të vazhdoni.

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë, po mbyllet kutia e votimit nr. 3483.

***Z. K. Bele:*** Më fal, duhet mbajtur pak qetësi në sallë kur flasim ne me mikrofon ose kur flet përfaqësuesi i KQZ-së. Dëgjoni, kur ne flasim me qendër zëri ka një arsye, kështu që do t'iu lutem në atë moment sa të jetë e mundur ndaloni dhe dëgjoni, sepse mund të jetë edhe për ju e vlefshme. Dakord?

***GNV nr. 3, zoti J. Bytyçi:*** QV nr. 3483 mbyllet me kodet: 234801, 234816, 234815 dhe 284803 dhe kodi i 5-të i pandyshuar.

***GNV nr. 4, zonja A. Agolli:*** QV nr. 3344/1 mbyllet me kodet e sigurisë: 283827, 283841, 283823, 283842 dhe kosi i 5-të i pandryshuar.

***Z. E. Çefa:*** Vendim i ndërmjetëm prap i KAS për sa i përketë 3 fletëve të votimit të kontestuara në tavolinën nr. 5 për QV nr. 3485/1. Atëherë janë 3 fletë votimi të kontestuara nga të cilat 1 fletë votimi është konsideruar e vlefshme për subjektin Partia Socialiste dhe KAS-i e konsideron të pavlefshme. Një fletë votimi që është konsideruar e vlefshme nga KZAZ për Partin Soocialiste po ashtu edhe KAS-i e konsideron të vlefshme dhe 1 fletë tjetër votimi, e cila ishte konsideruar e pavlefshme, por nga KAS konsiderohet e vlefshme për subjektin Partia Socialiste me shumicë votash.

***Z. K. Bele:*** Rezultati mbetet i njëjtë apo jo? Shtohet 1 hiqet 1?

***Z. E. Çefa:*** Po.

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë, të vazhdojmë me shpërndarjen e kutive të votimit? QV nr. 3345 i jepet GNV nr. 3. QV nr. 3481 i jepet GNV nr. 4,..

***Z. L. Braho:*** Zoti Merkaj të lutem për çdo tabelë që mbaron na sillni një kopje.

***Z. E. Çefa:*** Atëherë, në tavolinën e numërimit nr. 8 në kutinë që i përket QV nr. 3468/1 GNV në KQZ ka kontestuar 4 fletë votimi, të cilat pasi u verifikuan nga KAS.. atëherë, ju lutem do të biem dakord që kur ne flasim ju do të na dëgjoni, ju lutem, faleminderit. Atëherë, janë 4 fletë votimi të kontestuara, të cilat pasi u verifikuan nga KAS u vendos që të lihet në fuqi vendimi që ishte për këto fletë votimi nga KZAZ-ja. Pra, nuk ndryshon asgjë për sa i përket këtyre 4 fletëve të votimit.

***Z. K. Bele:*** Kisha një koment, meqenëse po dëgjoni. Përveç stafit të KQZ-së që është me eksperiencë dhe i trajnuar, por në këtë rast e kam për vëzhguesit sigurisht ju keni punën tuaj dhe jeni të lirë në punën tuaj, por besoj ju kanë sjell

si njerëz me eksperencë mundohuni të jeni racional dhe jo kontestime të kota. Ato gjëra që i keni kaluar janë në trajnim dhe që janë të qarta sipas manualit për të cilin mendoj se ju e dini ndoshta dhe më mirë se ne mos i kontestoni kot. Po ashtu, histori jo një gjurmë gishti apo.. nuk dua t'i marrë me raste, por mundohuni të jeni objektiv për interesin e procesit dhe të të gjithëve bashkë, faleminderit.

***GNV nr. 3, zoti J. Bytyçi:*** Atëherë, QV nr. 3345 e ZAZ nr. 63 kutia e votimit hapet me kodet: 323831, 323839, 323833, 323835 dhe kodi i 5-të 323573.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet.

***GNV nr. 4, zonja A. Agolli:*** Atëherë QV nr. 3481 hapet me kodet: 3238272, 323277, 323279, 323273 dhe kodi i 5-të 323444.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet.

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë, grupi i parë i numërimit do të numëroj kutinë e votimit nr. 3486.

***GNV:*** *(nuk dëgjohet)*

***Znj. E. Çeço:*** Komfirmohet.

***Z. E. Çefa:*** Vendim i KZAZ-së në tavolinën e numërimit nr. 7, QV nr. 3344, 2 fletë votimi. Të 2-ja për subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë kanë qenë fletë votimi të vlefshme janë kontestuar nga përfaqësuesit këtu në tavolinën e numërimit. Pas vlerësimit KAS vendosi që të kosiderohen sërish të vlefshme të 2-ja këto fletë votimi, faleminderit.

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë, kutia e votimit nr. 3487 do të numërohet nga grupi i numërimit nr. 5.

***GNV nr. 5, zoti B. Bego:*** QV nr. 3487 e mbyllur me këto kode sigurie: 323181; 323189, 323187; *(nuk dëgjohet)* dhe kodi i 5-të 323744.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet.

***GNV:*** *(nuk dëgjohet)* 323237; 323233; 323230; 323234; 323045.

***Znj. E. Çeço:*** Komfirmohet.

***Z. K. Bele:*** Zoti Merkaj tavolina e votimit nr. 2 për QV nr. 3478 ka një kontestim për një votë të vlefshme për LSI-në. Ka qenë e konsideruar e vlefshme KAS vendos që kjo votë të ngelet e vlefshme. Rrëzohet kontestimi, nuk ndryshon rezultati.

***GNV nr. 2, zonja M. Liça:*** Kutia e Qarkut Berat, QV nr. 4378 mbyllet me këto kode: 283897, 283896, 283894 dhe 283891.

***GNV nr. 2, zonja M. Liça:*** QV nr. 3347/1 hapet me kodet: 323807, 323803, 323808, 323800 dhe 323560.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet.

***Z. K. Bele:*** Mbani pak qetësi ju lutem!

***GNV:*** *(nuk dëgjohet)* 32.. *(nuk dëgjohet)* 305967;

***Znj. E. Çeço:*** Komfirmohet.

***GNV:*** *(nuk dëgjohet)* 323804; 323806; 323805; 323809.

***Znj. E. Çeço:*** Komfirmohet.

***Z. E. Çefa:*** Pak qetësi ju lutem. Atëherë, vendim i KAS për 1 fletë votimi të kontestuar në tavolinën nr. 4 që i përket QV nr. 3481 është 1 fletë votimi në favor të subjektit Partia Socialiste që është kontestuar këtu. Pas vlerësimit nga KAS kjo fletë do të konsiderohet e vlefshme, faleminderit.

***GNV:*** *(nuk dëgjohet)*

***Znj. E. Çeço:*** Komfirmohet.

***Z. E. Çefa:*** Atëherë, vendim për 1 fletë votimi të kontestuar në tavolinën nr. 2 që i përket QV nr. 3347/1. Kjo votë është konsideruar e vlefshme fillimisht për subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë është kontestuar nga grupi i numërimit këtu dhe KAS-i në vlerësim përfundimtar vendosi që të konsiderohet sërish e vlefshme për subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë.

***GNV nr. 4, zonja A. Agolli:*** QV nr. 3481 mbyllet me këto kode sigurie: 283830; 283999; 283991; 383992 dhe kodi i 5-të i pandryshuar.

***GNV nr. 2, zonja M. Liça:*** QV nr. 3374/1 mbyllet me këto kode: 283856; 283859; 283930; 283818.

***GNV:*** QV nr. 3488 hapet me këto kode sigurie: 323261; 323262; 323268; 323269; 201941.

***Znj. E. Çeço:*** Konfimohet.

***Z. E. Çefa:*** Pak qetësi ju lutem. Atëherë, në tavolinën nr. 3 që i përket QV nr. 3345 kemi 3 fletë votimi të kontestuara nga numëruesit, të cilat janë të 3-ja nga KZAZ të vleresuara si vota të vlefshme për subjektin Partia Socialite. Pas rivlerësimit të bërë nga KAS konstatohet se nga këto 3 fletë njëra duhet të shpallet e pavlefshme, faleminderit.

***GNV:*** QV nr. 3343/1 hapet me këto kode: 323258; 323259; 323254; 323252 dhe 305917.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet.

***GNV:*** 305077; 305068; *(nuk dëgjohet).*

***Znj. E. Çeço:*** Komfirmohet.

***Z. E. Çefa:*** Pas vlerësimit të 2 fletëve të votimit në tavolinën nr. 1 që i përkasin QV nr. 3339, Qarku Berat fletët e votimit janë konsideruar nga KZAZ-ja të vlefshme për subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë. Janë kontestuar në tavolinën e numërimit në KQZ. KAS i konsideron gjithashtu të vlefshme të 2-ja për subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë me shumicë votash, faleminderit.

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Mund t'i shofim pak palët? Sepse ka një.. I nderuar mund t'i shohin pak palët fletët e votimit? Palët kanë të drejtë t'i shofin pak?

***Z. E. Çefa:*** Palët kanë vëzhguesit në tavolinë, kështu që..

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Dakord, edhe ne si përfaqësues ligjor.

***GNV:*** *(nuk dëgjohet)*

***Znj. E. Çeço:*** Komfirmohet.

***Z. E. Çefa:*** Ju lutem përfaqësuesit ligjor, avokatët e subjekteve zgjedhore ju lutem largohuni nga tavolina. Zoti Kaziaj, zoti Logu ju lutem mbani një distancë nga tavolina e numërimit në mënyrë që të punojnë qetësisht, të punojnë qetësisht ata. Ju lutem edhe një herë avokat, ju lutem zini vend.

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Na lejoni të flasim.

***Z. E. Çefa:*** I'u siguroj që nuk i'ua kemi mohuar askujt dhe nuk kemi ndërmend t'i mohojmë njeriu të drejtën e fjalës në këtë sallë, por brenda normave etike të

pranueshme. Jemi në një proces, jemi në një proces do të keni mundësinë të kontestoni..

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Zoti kryesues ka një votë. Ka një votë..

***Z. E. Çefa:*** Ju lutem, mos më ndërprisni kur flas unë. Jemi në një proces dëshirojmë që ta mbarojmë këtë proces me sukses dhe i'u siguroj që do të keni të drejtën e kontestimit të çdolloj konstatimi që ju e konsideroni që është në kundërshtim me ligjin apo që nuk i'u pëlqen. I'u kërkoj edhe njëherë jo juve, por të gjithve të ruajmë etikën, faleminderit.

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Mund të marrë fjalën? Faleminderit.. po jo do e marim fjalën tani sepse nuk do të na e diktoni ju fjalën..

***Z. E. Çefa:*** Shkurtimisht të lutem.

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Tani edhe njëherë zoti kryesues i senacës sepse Ju i'u drejtohem. Ka një fletë votimi e cila është e identifikueshme, sepse përmendet rruga Juli etj., etj., çrëndësi ka.. tani mund të më lejoni të flas apo..

***Z. E. Çefa:*** Tani jeni i qartë? Ju lutem e kuptuam, të gjithë.. jo e kuptuam të gjithë. I'ua sqaroj edhe një herë proceduralisht u morrë vendim me shumicë votash.

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Ne duam që të kemi një pamje të asaj, sepse do ta kemi për në Kolegjin Zgjedhor. Na jepni një pamje të asaj vote, kaq, fletë votimi. Cili është neni që e ndalon që subjektet zgjedhore mos të kenë një pamje të asaj flete votimi?

***Z. I. Rusamali:*** Me kënaqësi, vetëm duhet të formuloni kërkesën në përputhje me manualin dhe rregulloren respektive. Formuloni kërkesën dhe do i'ua japim.

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Pra, kërkesa sepse jemi në seancë këtu. Kërkesa jonë është, duam të marrim një pamje filmike të fletës së votimi.

***Z. I. Rusamali:*** Të lutem, kërkesa juaj do bazë ligjore. Gjeni bazën ligjore për kërkesën..

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Jo na nxirrni ju bazën ligjore që e ndalon..

***Z. I. Rusamali:*** Procedura e numërimit nga grupi i numërimit..

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Ne kemi hapur të gjitha fletët..

***Z. I. Rusamali:*** Mbyllja pak.

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** T'iua mbyll ju pse duhet të ma mbylli mua? Sepse nuk dua të flas me ju zotëri dua të flas me Kryesuesin e senacës.

***Z. E. Çefa:*** Jo, jo e kishte fjalën zoti Rusmali anëtarë i KAS-it, ju lutem.

***Z. I. Rusamali:*** Po flet një anëtarë i Komisionit, je më i vogëli dhe më i riu këtu çuditërisht me një sjellje.. çfarë të them prej cubi. Je ti që do të vendosësh rregullat këtu? Po të themi me shumë kujdes. Çdo kërkesë që formulohet në përputhje me rregullat e numërimit të votave do të plotësohet. Keni vetëm një nevojë, ju jo unë.. të hapni manualin të gjeni ku thuhet në procedurën e numërimit të votave që përfaqësuesit e subjektit jo vëzhguesit kanë të drejtë të ndërpresin procesin, të marrin fletët e votimit t'i fotokopjojnë dhe të mbajnë

kopjen e tyre me gjithë qef do i'ua bëjmë. Në qoftë se në procedurën e numërimit kjo nuk thuhet atëherë ju duhet të vetëkufizoheni. Kaq e thjesht është historia dhe nuk ka nevojë të diskutojmë në një procedurë që kërkonë vëmendjen tek fletët e votimit.. jo të lutem. Kërkon vëmendjen tek fletët e votimit jo tek debati që bëjmë ne të tjerët. Shumë e thjesht hapni manualin, formloni kërkesën dhe do ta plotësojmë.

***Z. K. Bele:*** Më fal, nuk është për të bërë debat jemi në procedurë numërimi. Qendrën e Votimit e kemi të identifikuar dhe për atë qendër ka pamje. Sigurisht ju i keni shfrytëzuar ato pamje, mund t'i shfrytëzoni. Tani po filluam debatin ne për çdo votë i bie të prishim procesin. Vota që ju mund të mos bini dakord me vendimin tonë ka plotë. Problemi është se kështu funksionon procedura, KZAZ-ja në ndonjë rast ka qenë shumicë, në ndonjë rast unanim, të lutem na lini që të vazhdojmë me normalitet procesin.

***Z. L. Braho:*** Për procedurë propozoj që në rastet kur ka kontestime të kësaj natyre t'i lejohet vëzhguesit që të bëjë shënim tek procesverbali. Të bëjë shënim tek procesverbali..

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Po pra, i Nderuar, të nderuar anëtarë jam shumë dakord me anëtarin Braho të KAS-it. Ju lutem një sekond, të gjithë tavolinave të numërimit më fali të gjithë. Të gjitha tavolinat e numërimit ku ka vëzhgues, të cilët kontestojnë një fletë votimi pavarësisht rezultatit të vendimmarrjes së Komisionit në këtë rast, kontestoni..

***Z. L. Braho:*** Zoti Kaziaj një moment, sepse kjo nuk të takon ty ta bësh ktë thirrje.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Jo, më takon sepse kam interes të ligjshëm.

***Z. L. Braho:*** Nuk i'u takon juve e bënë relatori këtë. Unë e propozova nëse KAS-i bie dakord vendoset dhe kjo procedurë ndiqet për të gjitha. Pra, ku ka mosdakordësi me vendimin e KAS-it një nga vëzhguesit mund të bëjë një shënim në procesverbal dhe e keni si gjurmë për Kolegjin Zgjedhor nëse do të bëni ankesë.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Pikërisht.

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Zoti kryesues, kam një kërkesë nuk ka të bëjë me procesin. T'i tërhiqet vëmendja anëtarit të KAS-it zotit Rusamali për sjellje të papërshtatshme, thyerje dhe mungesë etike, faleminderit.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Kisha një kërkesë dhe unë zoti Relator i seancës.

***Z. E. Çefa:*** Tani edhe njëherë mos abuzoni me të drejtat dhe me durimin tonë. Ju tërheq vëmendjen zyrtarisht juve zoti Logu. Keni kujdes me mënyrën se si i drejtoheni këtij Komisioni dhe mos abuzoni me të drejtat e subjektit që përfaqësoni. Ndërsa lidhur me propozimin e zotit Braho, unë absolutisht nuk kam asnjë kundërshtim që kur ka kontestime të pasqyrohen ashtu sikundër përcaktohet edhe në manual me procedurën që përcaktohet në manual.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Zoti Relator mund ta marrë fjalën të lutem?

***Z. E. Çefa:*** Patjetër, mund ta merrni fjalën, por mendohuni mirë që ta mbyllim me këtë, sepse po i lëmë.. po i tërheqim vëmendjen numëruesëve dhe kjo nuk i shërben procesit.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Ne në të mirë të procesit po e bëjmë të gjithë veprimtarinë tonë duke siguruar KAS-in, sepse nuk kemi kohë as për të humbur as për t'i humbur anëtarëve të KAS-it. Fakti është se zoti Rusmali tha që mund të bëjmë kërkesën sipas manualit ne kërkesën mund ta formatojmë dhe në mënyrë verbale ose ta formulojmë në mënyrë të tillë që Administrata të marri shënime dhe të.. apo jo?

***Z. I. Rusamali:*** Nuk ka nevojë për diskutim këtu. Zbatoni procedurën dhe nuk..

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Jo, atë procedurën që..

***Z. I. Rusamali:*** Jo, zbatoni procedurën. Ne as që miratojmë as i'u mohojmë gjë. Zbatojeni procedurën mos bëni zhurmë..

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Jo, pra jo sepse ne kemi ardhur këtu përpara jush dhe ju keni një manual që nuk e paskemi ne si subjekte politike.

***Z. I. Rusamali:*** Zbatoni procedurën.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Jo, jo ju lutem. Lëre procedurat i dimë shumë mirë ne dhe nuk kemi nevojë për leksione. Jo, jo do të kontestohet ajo atje. Të gjitha do të kontestohen në qoftë se KAS vlerëson me 3 nga 5 anëtarë..

***GNV nr. 3, zoti J. Bytyçi:*** QV nr. 3345 e ZAZ-se nr. 63 mbyllet me kodet: 283811, 283819, 283810, 2838315 dhe kodi i 5-të i pandryshuar 323573.

***Z. E. Lako:*** Absolutisht nuk mund të shkoni tek vendi i numërimit, të lutem. Të lutem rendi është shumë në rregull uluni, të lutem. *(nuk dëgjohet)*

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Aty po kontestohet një fletë që..

***Z. E. Lako:*** Kur kontestohet të vijë këtu. Çpunë keni ju? As këtu nuk duhet të hyni. Se si e vlerësojmë ne është puna jonë, kaq.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Ju sapo vlerësuat të vlefshme një fletë që ishte e pavlefshme.

***Z. E. Lako:*** Ju lutem, nuk i'u ka dhënë njeri fjalën.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Ishte.. nuk jeni ju relatori zoti Lako.

***Z. E. Çefa:*** Po, zoti Kaziaj.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Ne na lind e drejta që të kontestojmë ato fletë, atë vendimmarrje..

***Z. E. Lako:*** Zoti Sekretar i Përgjithshëm vërë një ndarëse këtu.

***Z. E. Lako:*** Ju lutem zoti Lako, po flisja mos më ndërprisni. Na lind e drejta nëpërmjet vëzhguesëve tanë të kontestojmë vendimmarrjen tuaj mbi procesverbalin e mbajtur. Në mënyrë që të drejtën ankimore pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor ta ushtrojmë sipas parashikimeve ligjore. Kështu që, të na lejohet ajo dhe zoti Lako mos të nxehet kot për faktin që unë kaloj aty dhe vë rend tek një tavolinë numërimi ndërkohë që duhet ta bëni ju këtë punë.

***Z. E. Lako:*** Zoti Kaziaj rendin këtu e bëjmë ne, por nuk ka asnjë kontestim deri tani. Nuk e di çfarë rendi vure ti që nuk e vumë ne.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Ja pra, numëruesi ka dorën lartë nesë nuk e shihni..

***Z. I. Rusamali:*** Ngrini dorën dhe vinë anëtarët e KAS-it aty. Nuk ngre dorën dhe vjen vëzhguesi. A e di procedurën?

***Z. E. Çefa:*** Pas vlerësimit të 2 fletëve të votimit në tavolinën nr. 8 që i përket QV nr. 3340 janë kontestuar 2 fletë votimi, të cilat paraprakisht kanë qenë të konsieruara të vlefshme 1 për subjektin Partia Socialiste, tjetra për subjektin Partia Demokratike. Edhe KAS pas vlëresimit i konsideron të 2-ja këto vota të vlefshme përkatësisht për Partin Socialiste dhe Partin Demokratike. Ndërkohë, tavolinat kini pak vëmendjen, ju lutem.

***Z. L. Braho:*** Atëherë, nëse do të ketë kontestime në lidhje më vendimmarrjen e KAS-it për vlerësimin e ndonjë flete votimi kushdo nga vëzhguesit që ka kontestim mund të bëjë shënimin këtu tek pjesa boshe, mund ta përdorë. Të identifikohet i kujt subjekti është dhe që ka kontestim për 1 apo shumë fletë votimi. Në mënyrë që të ketë një kopje për gjurmë nëse do të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor.

***GNV:*** QV nr. 3497 e ZAZ-së nr. 64 hapet me kodet: 305053, 305039, 305001, 305051 dhe kodi i 5-të 305584.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet.

***Z. E. Çefa:*** Atëherë, pas vlerësimit të 2 fletëve të votimit nga tavolina nr. 7 për QV nr. 3344, 2 fletë votimi kontestuara, të cilat paraprakisht kanë qenë të konsideruara të vlefshme për subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë edhe pas vlerësimit të KAS-it konsiderohen të vlefshme për subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë, faleminderit.

***GNV:*** Kutia e QV nr. 3343/1 mbyllet me kodet: 283858, 283851, 283854 dhe 283852.

***GNV nr. 2, zonja M. Liça:*** Kutia e QV nr. 3530 hapet me kodet: 287009, 305191, 287003, 287002, 287006.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet.

***GNV:*** *(nuk dëgjohet)*

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet.

***Z. E. Çefa:*** Pas vlerësimit të 1 flete votimi të kontestuar në tavolinën nr. 6 që i përketë QV nr. 3493, e cila më parë është konstatuar e pavlefshme. KAS me shumicën e votave e konsideron sërish të pavlefshme këtë fletë votimi. Një fletë votimi e kontestuar në tavolinën nr. 2 QV nr. 3530 paraprakisht fleta është konstatuar e vlefshme për subjektin LSI. KAS pas rivlerësimit e konsideron sërish të vlefshme këtë votë për subjektin Lëvizja Socialiste për Integrim.

***GNV:*** *(nuk dëgjohet)*

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet.

***GNV nr. 2, zonja M. Liça:*** Kutia e QV nr. 3530 mbyllet me këto kode: 234919, 234912, 234918 dhe 234911.

***GNV:*** QV nr. 3426 kutia hapet me këto kode: 305098, 305097, *(nuk dëgjohet)*.

1091, 305506, 305095.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** Atëhere, pas vlerësimit të dy fletëve të votimit në tavolinën nr. 4, që i përkasin Qendrës së Votimit nr. 3488, janë konstatuar nga vëzhguesit 2 fletë votimi, të cilat ishin në zarfin e fletëve të votimit, të pavlefshme. Pasi u vlerësuan nga KAS, këto fletë konstatohen të vlefshme. Njëra shkon votë përkatësisht për subjektin PD – AN dhe vota tjetër është për subjektin LSI. Në të njëjtën qendër votimi, vëzhguesit nga tavolina e numërimit kanë kontestuar 5 fletë votimi, të cilat paraprakisht kanë qënë konstatuar të vlefshme. Edhe pas rivlerësimit të bërë nga KAS, këto fletë votimi konstatohen të vlefshme. Kemi një fletë votimi për subjektin PD, një fletë votimi për subjektin PS, QV. 3488 e njëjta. Një fletë tjetër votimi për PD-në dhe dy fletë të tjera votimi për subjektin PS. Faleminderit!

***GNV nr. 7, zoti B. Kodra:*** ( ***Pa mikrofon, nuk dëgjohet!*** ).

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV:*** ( ***Pa mikrofon, nuk dëgjohet!*** )

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** Pas vlerësimit të një flete votimi të gjetur në zarfin e fletëve të votimit të pavlafshme nga tavolina e numërimit nr. 3 që i përket QV-së nr. 3497. KAS vlerëson se kjo fletë votimi duhet të konsiderohet e vlefshme për subjektin PS. Atëhere, vlerësimi i fletës së votimit...Një fletë votimi të kontestuar në tavolinën e numërimit nr. 6 që i përket QV-së 3524, Qarku Berat. Fleta e votimit paraprakisht është vlerësuar në favor të subjektit PS. Është kontestuar dhe KAS pasi e rivlerësoi konstatoi që është e rregullt për subjektin PS. Atëhere, pas vlerësimit të një flete votimi, e kontestuar nga tavolina e numërimit nr. 2, që i përket QV-së 3426. KAS konstaton se kjo fletë votimi paraprakisht ishte

konstatuar e pavlefshme. Pas rivlerësimit të bërë nga KAS, me shumicën e votave, konstatohet fletë e vlefshme në favor të subjektit PS.

***GNV nr. 4, zonja L. Mavriqi:*** Kutia e QV-së 3488 mbyllet me këto kode sigurie 283996, 283990, 283993, 283995.

***GNV: ( Pa mikrofon, nuk dëgjohet! )***

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 3, zoti J. Bytyçi:*** 3497 e ZAZ-së 64 mbyllet me kodet 283933, 283813, 283848, 283812 dhe kodi i pestë i pandryshuar 305584.

***GNV nr. 4, zonja L. Mavriqi:*** Kutia e QV-së 3426 mbyllet me këto kode sigurie 234914, 234910, 234913, 234917.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 3, zoti J. Bytyçi:*** QV 3524/1 e ZAZ-së 64 hapet me kodet, 287112, 287111, 287113, 287114 dhe kodi i pestë 305666.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV: ( Pa mikrofon, nuk dëgjohet! )***

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV: ( Pa mikrofon, nuk dëgjohet! )***

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 4, zonja L. Mavriqi:*** Kutia e QV-së 3415 hapet me këto kode sigurie, 305066, 305065, 305060, 305067, 305510.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV: ( Pa mikrofon, nuk dëgjohet! )*** 287012, 287015, 287010, 287017.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV:*** ( ***Pa mikrofon, nuk dëgjohet!*** ).

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** Atëhere, në rivlerësimin e një flete votimi të kontestuar në tavolinën nr. 1 që i përket QV-së nr. 3514/1, Qarku Berat, rezulton se fleta e votimit është konsideruar paraprakisht e vlefshme për subjektin PS. KAS gjatë rivlerësimit konstaton se kjo votë është e vlefshme dhe me shumicë votash vendosi që të konsiderohet votë e vlefshme në favor të subjektit PS.

***GNV:*** Kutia e votimit e QV-së (***Pa mikrofon, nuk dëgjohet***).

***GNV:*** ( ***Pa mikrofon, nuk dëgjohet!*** )

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** Atëhere, në lidhje me kontestimim e 5 fletëve të votimit në tavolinën e numërimit nr. 2 që i përkasin QV-së 3506. Janë 5 fletë votimi, të cilat kanë qënë klasifikuar si fletë votimi të pavlefshme. Pas vlerësimit nga ana e KAS-it, konstatohen të vlefshme të 5 fletët e votimit në favor të subjektit PS.

***GNV nr. 4, zonja L. Mavriqi:*** 3526 hapet me këto kode 287051, 287059, 287056 konfirmohet ,305700, 287058.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** Atëhere, pas vlerësimit të dy fletëve të kontestuara në tavolinën nr. 8, të cilat ishin konstatuar të vlefshme edhe nga KZAZ-ja dhe i përkasin QV-së nr. 3511/1, Qarku Berat. KAS vendos me shumicën e votave, konstatimin të vlefshme, përkatësisht të njërës fletë votimi për subjektin PS dhe të fletës tjetër të votimin për subjektin PD – AN.

***GNV nr. 3, zoti J. Bytyçi:*** 3524/1, e ZAZ-së 64 mbyllet me kodet, 234995, 234991, 234998, 234999 dhe kodi i pestë i pandryshuar 305666.
QV 3494, ZAZ 64, Qarku Berat hapet me kodet, 305018, 305012, 305016, 305017, dhe kodi i pestë 305100.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV:*** ( ***Pa mikrofon, nuk dëgjohet!*** )

***GNV:*** ( ***Pa mikrofon, nuk dëgjohet*** ) 287174, 487179............ ( ***Pa mikrofon, nuk dëgjohet*** ) kodi i pestë 305638 .

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 4, zonja L. Mavriqi:*** 35192 hapet me këto kode sigurie, 287135, 287130, 287131, 287134, 305567.

***GNV:*** ( ***Pa mikrofon, nuk dëgjohet!*** )

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV:*** ( ***Pa mikrofon, nuk dëgjohet*** )

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** Atëhere pas vlerësimit të 7 fletëve të votimit, të kontestuara, në kutinë me nr. 2 që i përkasin QV-së së votimit nr. 3526, konstatohet se në zarfin e fletëve të votimit të pavlefshme u gjendën 7 fletë votimi të cilat janë konsideruar të pavlefshme. I përkasin subjektit PS. KAS pas rivlerësimit, i konsideron këto 7 fletë të vlefshme, në favor të subjektit PS. Ju lutem këtu nuk ka tifozllik, nuk jeni në stadium, jeni në ambjentet e KQZ-së. Shpresoj mos të përsëritet më ky rast. Atëherë, lidhur me vlerësimin e tre fletëve të votimit, në tavolinën nr. 5, që i përkasin QV-së 3416, Qarku Berat. Rezultojnë 2 fletë votimi të kontestuara nga

grupi i numërimit, të cilat paraprakisht nga KZAZ-ja janë vlerësuar në favor të subjektit PS. Pas rivlerësimit KAS rivlerëson që këto dy fletë votimi duhet të konsiderohen të vlefshme në favor të subjektit PS.

Po ashtu në të njëjtën QV kemi edhe një fletë tjetër votimi e cila është konsideruar e pavlefshme. Pas rivlerësimit nga KAS, kjo fletë votimi konsiderohet e vlefshme, sërisht në favor të subjektit PS. Atëhere, ju lutem pak qetësi! Pas vlerësimit të dy fletëve të votimit, të kontestuara në tavolinën e numërimit nr. 6 që i përkasin QV-së 3513, Qarku Berat, rezulton se janë dy fletë votimi të konstatuara në KZAZ të pavlefshme. Pas rivlerësimit nga KAS, të dy fletët konsiderohen të vlefshme dhe një fletë përkatësisht në favor të subjektit PS dhe fleta tjetër e vlefshme në favor të subjektit LSI.

Nga vlerësimi i 2 fletëve të votimit të kontestuara në tavolinën e numërimit nr. 8 që i përkasin QV-së 3522, rezulton se janë dy fletë votimi fillimisht të konstatuara të vlefshme, përkatësisht njëra në favor të PS-së dhe tjetra në favor të PD-së. Pas rivlerësimit nga KAS, u konkludua që këto fletë janë të vlefshme, përkatësisht një fletë për subjektin PS dhe fleta tjetër për subjektin PD - AN. Pas rivlerësimit të 3 fletëve të votimit të kontestuara në tavolinën e numërimit nr. 3, që i përkasin QV-së 3494, rezulton se 3 fletë votimi të konstatuara si të pavlefshme në KZAZ. Pas rivlerësimit, KAS vendos që t'i kualifikojë të treja dhe t'i konsiderojë të vlefshme. Përkatësisht një votë për subjektin PS, një votë për Partinë Nisma Thurje dhe dhe një votë për subjektin zgjedhor PD – AN. Edhe pak vëmendje ju lutem! Përfaqësuesit e subjekteve? Atëhere, ne vlerësojmë që për sot duhet t'a ndërpresim numërimin e kutive dhe ky proces do të fillojë nesër në orën 09:00. I kërkoj ndërkohë Administratës së KQZ-së që të marrë të gjitha masat e nevojshme ligjore, organizative për sigurimin e kutive të votimit. Nesër rifillojmë edhe njëherë seancën në orën 09:00, në këtë sallë. Ju lutem subjektet të marrin masat përkatëse për të njoftuar vëzhguesit që të jenë, në mënyrë që të fillojmë menjëherë, pa humbur kohë. Atëhere, faleminderit! Falenderoj numëruesit, vëzhguesit dhe administratën sigurisht, për durimin dhe për punën. Natën e mirë!

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve Dt.21.05.2021*

**21.05.2021**
**Ora 09:17**

***RENDI I DITËS***

***Vazhdon procedura e hapjes së kutive të votimit për disa ZAZ të Qarkut Berat.***

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** **Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI, Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**
- **Stafi KQZ: Y.Merkaj, O.Peto**
- **Parti Politike: PD - AN, PS, LSI**

*Z. E. Çefa:* Atëherë, mirëmëngjes të gjithëve! Rifillojmë seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore me numër 35 të subjektit ankimues Lëvizja Socialiste për Integrim, sikurse dini dje KAS mori një vendim të ndërmjetëm për hapjen e kutive dhe rinumërimin e votave në 114 qendra votimi dhe në dy qendra të tjera votimi për hapjen e kutive dhe rinumërimin e votave për kandidatët. Procesi ka vijuar normalisht dje, sot në orën 9:00 do të rifillonte, ju kërkojmë ndjesë për vonesën por shkaktarë janë përfaqësuesit e subjekteve të cilët nuk kanë marrë masa që t'i sjellin në kohë vëzhguesit e tyre. Megjithatë unë shoh që ne mund të fillojmë. Do të fillojmë edhe njëherë ku e lamë dje sipas të njëjtës procedurë gjithmonë duke respektuar rregullin që vëzhguesit të jenë prezent në çdo tavolinë, do fillojmë në tavolinat që janë të kompletuara me vëzhgues të subjekteve politike dhe kryesisht subjektit ankimues Lëvizja Socialiste për Integrim. Zoti Sekretar i Përgjithshëm vijoni me procedurën e shpërndarjes së kutive, falemiderit!

*Zbardhi materialin audio*
*Ardita VRIONI*

***Z. Y. Merkaj:*** Të nderuar anëtarë të KAS përpara se të fillojmë me shpërndarjen e kutive doja t'iu kominikoja dy ndryshime që janë bërë tek GNV-të nga GNV-të e djeshme në tavolinën numër 3 është ndryshuar zoti Fadil Kapllanin me zotin Endri Toporja. Në tavolinën numër 8 është ndryshuar Migena Xibinaku me Klajdi Takën. Atëherë vazhdojmë numërimin atje ku e lamë dje me kutinë e votimit numër 3527 i cili e merr grupi i parë i numërimit e kështu me rradhë. Kutia 3529/1 grupi i dytë dhe vazhdojmë.

***Z. L. Braho:*** Zoti Ylli edhe një gjë, me ato kutitë që është vendosur të hapen për kandidatët, administrata në momentin që ia jep grupit të numërimit përkatës t'ia shpjegoj se mos ngatërrohemi dhe do të na duhet t'a hapim dy herë pastaj. Pra, aty ku ka për kandidat të njoftohen nga administrata.

***Z. Y. Merkaj:*** Një kuti votimi është tek ankimi që ishte për kandidatët kurse QV tjetër që ishte vetëm për kandidatët nuk është tek tabela e kërkesës ankimore por kemi porositur dhe do të na e sjellin kutinë dhe t'a numërojmë.

***Z. L. Braho:*** Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore bëni thirrje që të vijnë sa më shpejt vëzhguesit se po vonohet procesi.

***GNV:*** 287046, 287044, 287041 ***(nuk dëgjohet, pa mikrofon!)***

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV:*** QV 3529/1. Kodet e sigurisë janë 287048, 287088, 287049, 287036, 303184

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Zbardhi materialin audio***
***Ardita VRIONI***

***GNV:*** QV 3518/1 e ZAZ nr.64 hapet me kodet: 257185, 257156, 257154, 257137, dhe kodi i pestë 305276.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV:*** QV 3271 hapet me kodet e sigurisë 217059, 217053, 217051, 217052 kodi i pestë 287474.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV:*** QV 2288 është e mbyllur me këto kode sigurie 217440, 217443, 217442, 217441, kodi i pestë 287893.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV:*** QV 3302 hapet me kodet: 217941, 217943, 217947, 217940, kodi i pestë 487744.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV:*** 217900, 217903, 217901, 217902, kodi i pestë 287714.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV:*** 217441, 217444,217447,217446, ***(nuk dëgjohet, pa mikrofon!)***

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV :*** Kutia 3529/1 është e mbyllur me këto kode: 234663, 234464, 234662, 234660.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!
***GNV:*** Kutia e QV 3297 hapet me kodet: 217977, 217972, 217975, 217979.297984

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** Qetësi pak ju lutem! Nga KAS është rivlerësuar një fletë votimi e relatuar nga tavolina numër 1, që i përket QV 3527, Qarku Berat. Paraprakisht fleta e votimit është konsideruar e pavlefshme nga rivlerësimi i KAS konstatohet e vlefshme në favor të subjektit Lëvizja Socialiste për Integrim. Nga tavolina numër 4 janë relatuar dy fletë votimi të QV 3271, Qarku Berat, të cilat paraprakisht nga KZAZ përkatëse janë konsideruar të vlefshme njëra për subjektin Partia Demokratike më falni Partia Socialiste, , edhe nga KAS konsiderohen sërisht të vlefshme përkatësisht njëra votë për subjektin Partia Demokratike- Aleanca për Ndryshim, vota tjetër për Partia Socialiste e Shqipërisë.

***GNV:*** Kodet e mbylljes:287758 9 ***(nuk dëgjohet, pa mikrofon!)***

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV:*** QV 3518/1 e ZAZ nr.64 mbyllet me kodet: 234659, 234651, 234657, 234655, kodi i pestë 305276.

***GNV:*** QV 3314 e ZAZ nr.64 hapet me kodet: 217968, 217936, 217924, 217925, kodi i pestë 287709.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** Në tavolinën nr. 2 janë kontestuar dy fletë votimi të konsideruara paraprakisht të vlefshme nga KZAZ të dyja për subjektin Partia Socialiste e

Shqipërisë. Bëhet fjalë për QV 3297, edhe nga rivlerësimi i bërë nga KAS të dy fletët konsiderohen të vlefshme për subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë.

*GNV:* QV 3271 mbyllet me këto kode sigurie: 234884, 234685, 234688, 234680. Kodi i pestë i pa ndryshuar.

*GNV:* QV 3316 hapet me këto sigurie: 217922, 217923, 217921, 217920, kodi i pestë 287794.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** Nga KAS rivlerësohen 4 fletë votimi që i përkasin QV 3297/1 raportuar nga raportuar nga tavolina e numërimit nr.8. Janë fletë votimi që janë konstatuar paraprakisht të vlefshme u rivlerësuan nga KAS dhe rezultuan gjithashtu të vlefshme njëra i përket subjektit zgjedhor Lëvizja për Ndryshim dhe tjetra i përket subjektit zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim. Ne të njëjtën kuti janë kontestuar sërish edhe dy fletë votimi të tjera që ishin vlerësuar paraprakisht të pavlefshme nga rivlerësimi në KAS rezultojnë të dyja të vlefshme dhe të dyja janë për subjektin Partia Socialiste.

*GNV:* Hapet me këto kode: 227492, 227422 227412,***(nuk dëgjohet, pa mikrofon!)***

***Z. E. Çefa:*** KAS rivlerësoi gjithashtu dy fletë votimi të raportuara, të kontstuara në tavolinën nr. 7 që i përkasin QV 3311 Qarku Berat. Këto dy fletë votimi kanë qenë paraprakisht të vlerësuara të vlefshme për subjektin zgjedhor Partia Socialiste dhe po ashtu edhe nga KAS konsiderohen të vlefshme për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Njëra nga këto vota me shumicë votash të KAS.

*GNV:* Kutia e QV 3297 mbyllet me kodet, 234669, 234668, 234667,234665.

*Z. E. Çefa:* Atëherë, KAS rivlerëson katër fletë votimi të kontestuara në tavolinën e numërimit nr.1 që i përkasin QV 3313. Fletët e votimit janë konsideruar paraprakisht të vlefshme nga KZAZ dhe po ashtu edhe KAS i konsideron të vlefshme të treja për subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë. Në të njëjtën QV dhe në të njëjtën tavolinë numërimi është kontestuar gjithashtu edhe një fletë votimi tjetër. E cila ishte konsideruar paraprakisht e vlefshme, KAS-i me shumicën e votave vendosi që kjo votë të konsiderohet e pavlefshme, sepse është votuar, është plotësuar me laps.

*GNV:* 234693, 234691, 234696 ***(nuk dëgjohet, pa mikrofon)*** kodi i pestë i pandryshuar.

*GNV:* Kutia e QV 3304/1 hapet me kodet: 217999, 217992, 287934, 217484, 217486.

*Znj. E. Çeço:* Konfirmohet!

*GNV:* 217934, 21796 217949, kodi i pestë 257804. ***(nuk dëgjohet, pa mikrofon!)***

*Znj. E. Çeço:* Konfirmohet!

*GNV:* 217806, 217805, ***(nuk dëgjohet, pa mikrofon!)***

*Znj. E. Çeço:* Konfirmohet!

*GNV:* 227465,227482, 227456 ***( nuk dëgjohet, pa mikrofon!)***

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** Atëherë, KAS rivlerësoi një fletë votimi të kontestuar në tavolinën nr.3 që i përket QV 3314, Qarku Berat. Vota paraprakisht është vlerësuar e vlefshme për subjektin Partia Socialiste dhe KAS e konsideron këtë votë të vlefshme për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

***GNV:*** Kutia e QV 3304/1 mbyllet me kodet 234661, 234600, 234609, 234608.

***Z. E. Çefa:*** KAS mori në rivlerësim shtatë fletë votimi të kontestuara në tavolinën nr. 4. Të cilat i përkasin QV 3316 atëherë, janë dy fletë votimi të kontestuara të cilat paraprakisht kanë qenë të konstatuara të pavlefshme edhe për KAS gjithashtu janë të pavlefshme, dy fletë votimi. Po ashtu në 5 fletë votimi të cilat kanë qenë konstatuar të vlefshme për të njëjtën QV, KAS konstaton se një fletë votimi duhet të shpallet e pavlefshme po ashtu edhe një fletë tjetër votimi e cila është votuar për dy subjekte është konsideruar sërish e pavlefshme nga KAS. Po ashtu edhe një fletë tjetër votimi që është votuar për një subjekt politik dhe për kandidatin e subjektit tjetër politik nga e vlefshme, nga KAS konsiderohet e pavlefshme. Fleta e katërt gjithashtu ka të njëjtin problem është votuar për dy subjekte politik dhe gjithashtu edhe kjo fletë nga e vlefshme konstatohet e pavlefshme nga KAS. Fleta e fundit që është konstatuar e vlefshme edhe nga KAS-i konstatohet e vlefshme për subjektin Partia Socialiste. KAS mori në rivlerësim një fletë votimi e kontestuar në tavolinën nr. 3 që i përket që i përket QV 3314 kjo fletë votimi është konsideruar paraprakisht e pavlefshme nga KZAZ dhe po ashtu edhe nga KAS kjo fletë votimi konsiderohet e pavlefshme. Pasi është votuar për një subjekt politik edhe për kandidatin e subjektit tjetër politik. KAS mori në vlerësim një fletë votimi të kontestuar në tavolinë e numërimit nr. 6 që i përket QV 3294/1, Qarku Berat, fleta

e votimit ishte konsideruar paraprakisht e pavlefshme pas rivlerësimit KAS e konsideron të vlefshme në favor të subjektit Lëvizja Socialiste për Integrim.

***GNV:*** QV 3314 e ZAZ-së nr.64 u mbyll me kodet me 234652, 234650, 234653, 234656 dhe kodi i pestë i pandryshuar 257709.

***GNV:*** ***(nuk dëgjohet, pa mikrofon!)***
***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV:*** QV 3311/1 e ZAZ nr.65 hapet me kodet: 217914, 217915, 217913, 217916 kodi i pestë 287774

***Z. E. Çefa:*** KAS rivlerëson 3 fletë votimi të kontestuara në tavolinën numër 5 që i përkasin QV 3313/2. Tre fletë votimi të cilat ishin konsideruar të vlefshme, KAS pasrivlerësimit i konstaton dhe i gjen ato të treja të pavlefshme. Atëherë pas rivlerësimit të tre fletëve të votimit të kontestuara në tavolinën nr.8 që i përkasin QV 3295, Qarku Berat, KAS vlerëson se një fletë votimi e cila ishte konstatuar e vlefshme, ngelet e vlefshme për subjektin Partia Socialiste, dy fletë të tjera të votimit të cilat ishin konstatuar të pavlefshme pas rivlerësimit nga KAS konsiderohen të dyja të vlefshme për subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë.

***GNV:*** QV 3316 mbyllet me këto kode sigurie:334949, 334948, 234681, 283997, kodi i pestë 287794.

***GNV:*** 217046, 217047, kodi i pestë 9404 ***(nuk dëgjohet, pa mikrofon!)***

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

*GNV: ( **Nuk dëgjohet pa mikrofon!)***

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

*GNV:* Kutia e votimit 3284/1 hapet me kodet 217410, 217411, 217412,217413, kodi i pestë 287809.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

*GNV:* 217470, 217475, 217472 ***( nuk dëgjohet pa mikrofon)***

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

*GNV:* QV 3285 hapet me këto kode sigurie 217428, 217427, 217425, 217426, 287844.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

*GNV: ( **Nuk dëgjohet pa mikrofon!)***

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

*GNV:* 217413, 217417, 217416, 217418. Kodi i pestë 217614.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

*GNV:* Kutia e QV 3284/1 mbyllet me kodet 234606, 234607, 234604, 234603.

*GNV:* Kutia e QV 3312 hapet me kodet 217966, 287764, 287762, 287757, 217957

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr....***21 78 39, 21 78 46, 21 78 48 dhe kodi i pestë 25 79 55**(nuk dëgjohet)**

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** KAS rivlerësoi 3 fletë votimi të kontestuara në tavolinën nr.7, që i përket qendrës së votimit 3305/2 Qarku Berat. Fleta e parë e votimit ka qenë konsideruar e vlefshme në favor të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë dhe po ashtu vlerësohet edhe nga KAS. Dy fletët e tjera të votimit kanë qenë të konsideruara të pavlefshme nga KZAZ-ja, KAS, pas rivlerësimit, konstaton se të dyja këto fletë votimi janë të vlefshme dhe njëra është e vlefshme në favor të subjektit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, dhe tjetra në favor të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë.

***GNV.3.Z. J. Bytyçi:*** Qendra e votimit 3311/1 e ZAZ-së 65 mbyllet me kodet: 23 46 39, 23 46 31, 23 46 33, 23 46 36 dhe kodi 5 i pandryshuar: 28 77 74.

***GNV.nr.*** Znj...Kutia ..me kodet: 51 78 94, 51 78 95, 51 78 97, 58 78 96, 58 78 04**(nuk dëgjohet)**

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmoj!

***GNV.2.Znj. M. Liça:*** Kutia e qendrës së votimit 3312 mbyllet me kodet: 23 46 02, 23 46 01, 23 46 05, 23 45 09 dhe 28 77 64

***GNV.2.Znj. M. Liça:*** Kutia e qendrës së votimit 33051 hapet me kodet: 21 79 52, 28 79 44, 21 79 53, 21 79 55, 21 79 54

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** Rivlerësohen 3 fletë votimi të kontestuara në tavolinën nr.5, që i përkasin qendrës së votimit 3296, Qarku Berat. Janë 2 fletë votimi të konsideruara paraprakisht të vlefshme për subjektin Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim dhe për subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë. KAS pas rivlerësimit vendosi që: Të konstatohet e pavlefshme fleta e votimit që i përket subjektit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim dhe të konsiderohet e vlefshme fleta e votimit që i përket subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, Në të njëjtën kuti është kontestuar gjithashtu një fletë votimi e konstatuar paraprakisht e pavlefshme. KAS rivlerëson që kjo fletë votimi duhet të konsiderohet e vlefshme në favor të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë.

***GNV nr.4.Znj. L. Mavriqi:*** Qendra e votimit 3285 mbyllet me këto kode sigurie: 23 46 89, 23 46 87, 23 46 86, 23 46 83 dhe kodi i pestë i pandryshuar: 28 78 44

***GNV.nr.*** Z...Kutia e votimit...., 21...46, 21 74 35, 21 74 37 dhe kodi i pestë i pandryshuar.... **(nuk dëgjohet)**
***Znj. E. Çeço:*** Konfirmoj!

***GNV nr.4.Znj. L. Mavriqi:*** Kutia e qendrës së votimit: 3287/1 hapet me këto kode: 21 74 30, 21 74 31, 21 74 32, 21 74 33, 28 78 84
***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV.3.Z. J. Bytyçi:*** Qendra e votimit 3291/1 ZAZ-ja 65 hapet me kodet: 21 74 62, 21 74 60, 21 74 63, 21 74 61, kodi i pestë: 21 76 38
***Znj. E. Çeço:*** Konfirmoj!

***Z. E. Çefa:*** Rivlerësim nga KAS për 2 fletë votimi të kontestuara në tavolinën nr.8 që i përkasin qëndrës së votimit 3290 Qarku Berat. Të dyja fletët janë kontestuar në tavolinën e numërimit, por paraprakisht kanë qenë konsideruar të vlefshme, në favor të subjektit Partia Socialiste. Pas rivlerësimit, KAS me shumicën e votave vendos që të dyja fletët të konsiderohen të vlefshme në favor të subjektit Partia Socialiste.

***GNV.nr.*** Znj..., 21 74 44, 21 74 42, 21 74 41, 21 74 49, 21 76 47**(nuk dëgjohet)**
***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** Atëherë, rivlerësim të një flete votimi e kontestuar në tavolinën nr.6, që i përket qendrës së votimit 3280/1, Qarku Berat. Kjo fletë votimi është gjetur në grupin e fletëve të votimit të konstatuara të pavlefshme, nga rivlerësimi i bërë në KAS, fleta e votimit konsiderohet e vlefshme në favor të subjektit Partia Socialiste.

***GNV.nr.*** Z...21 79....21 79 47, 21 79 47, 21 79 95, 42 79...... **(nuk dëgjohet)**
***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV.nr.*** QV , kode sigurie: 27 89 58, 218159, 478957 dhe kodi i pestë: **(nuk dëgjohet)**
***Znj. E. Çeço:*** Konfirmoj!

***Z. E. Çefa:*** Rivlerësimi i dy fletëve të votimit në tavolinën nr.4, që i përkasin qendrës së votimit 3287/1, Qarku Berat. Njëra fletë votimi pas rivlerësimit nga KAS, konsiderohet e vlefshme në favor të subjektit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim dhe ka qenë e pavlefshme, po ashtu dhe fleta tjetër e votimit që ka

qenë e pavlefshme edhe nga KAS, konsiderohet e pavlefshme. Rivlerësimi i një flete votimi në tavolinën e numërimit nr.3, që i përket qendrës së votimit 3391/1. Kjo fletë votimi është konstatuar e pavlefshme nga KZAZ-ja dhe KAS në rivlerësim vendos që kjo fletë votimi duhet të konsiderohet e vlefshme në favor të subjektit zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim.

***GNV.nr.*** Z.....27 82 04(**nuk dëgjohet**)
***Znj. E. Çeço:*** Konfirmoj!

***Z. E. Çefa:*** KAS rivlerëson 3 fletë votimi të kontestuara në tavolinën nr.7 që i përkasin qendrës së votimit nr.3287. Të 3 këto fletë votimi kanë qenë të konsideruara paraprakisht të pavlefshme. Pas rivlerësimit KAS vendosi: 1 fletë votimi të konsiderohet e vlefshme në favor të LSI-së dhe 2 fletët e tjera të votimit të konsiderohen të vlefshme në favor të Partisë Socialiste. KAS rivlerëson 1 fletë votimi të kontestuar në tavolinën nr.2 që i përket qendrës së votimit 3305/1. Fleta e votimit është konstatuar fillimisht nga KZAZ-ja e pavlefshme. KAS pas rivlerësimit vendos që kjo fletë votimi duhet të konsiderohet e vlefshme në favor të Partisë Demokratike – Aleanca për Ndryshim.

***GNV.nr.4. Znj. L. Mavriqi:*** Kutia e qendrës së votimit: 3287/1 mbyllet me këto kode sigurie: 23 45 26, 23 45 23, 23 45 29, 23 45 21 dhe kodi i pestë i pandryshuar: 28 78 84.

***GNV.nr.2. Znj. M. Liço:*** Kutia e qendrës së votimit: 3305/1 mbyllet me këto kode: 23 45 02, 23 45 06, 23 45 07, 23 45 05, 28 79 44

***GNV.nr.3 .Z. J. Bytyçi:*** Qendra e votimit 3291/1, ZAZ-së 65 mbyllet me kodet: 23 46 37, 23 4634, 234638, 234632 dhe kodi i pestë i pandryshuar:21 76 38

***GNV.nr.4. Znj. L. Mavriqi:*** Kutia e qendrës së votimit 3327 hapet me kodet e sigurisë: 27 89 42, 27 89 40, 27 89 41, 27 89 44, kodi i pestë: 27 82 53

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV.3. Z. J. Bytyçi:*** Qendra e votimit 3330 e ZAZ-së 66 hapet me kodet: 27 89 38, 27 89 34, 27 89 31, 27 89 37 dhe kodi i pestë: 27 33 79

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV.nr.2. Znj. M. Liça:*** Kutia e qendrës së votimit: 3328 hapet me kodet e sigurisë: 27 89 46, 27 89 48, 27 89 45, 27 89 43 dhe 27 83 99

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** Atëherë rivlerësimi i 1 flete votimi të kontestuar në tavolinën nr.5 që i përket qendrës së votimit: 3294 Qarku Berat, nga KZAZ-ja. Kjo fletë është konstatuar e pavlefshme pas rivlerësimit. KAS me shumicën e votave e konsideron të vlefshme, në favor të Partisë Socialiste.

***Z. L. Braho:*** Në tavolinën e numërimit nr.1, në qendrën e votimit nr.3319, ishte një votë e pavlefshme dhe KAS me shumicë votash vendosi ta konsiderojë të vlefshme për Partinë Socialiste.

***GNV.nr.*** Z....Kutia e votimit me nr. 3331, ZAZ 66 Berat, është e mbyllur me kodet: 27 89 00, 27 89 09, 27 89 03, 27 33 08, 27 83 67 **(nuk dëgjohet)**

***Z. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. L. Braho:*** Në kutinë e numërimit nr.8, qendra e votimit nr.3300, 2 vota ishin të pavlefshme dhe KAS vendos që të vijojnë të jenë të pavlefshme. 1 votë që ishte e vlefshme për Partinë Demokratike, vazhdon të jetë e vlefshme për Partinë Demokratike. Ndërkohë që 1 votë që ishte e vlefshme për Partinë Socialiste, duke qenë se ka kryq dhe tek Partia Social Demokrate, KAS e konsideron të pavlefshme.

***GNV.nr.*** Znj....27 ...., 26 29 68, 26 29 69, 26 29 65 dhe kodi i pestë: 27 83 29(**nuk dëgjohet)**

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. L. Braho:*** Në tavolinën e numërimit nr.6, qendra e votimit nr. 3322 është paraqitur 1 votë që nga grupi i numërimit është e konsideruar e pavlefshme dhe për KAS është e pavlefshme.

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë, kutia e qendrës së votimit 3356 është kutia që do të numërohen dhe kandidatët përveç subjekteve. E ka grupi 1 i numërimit.

***GNV.nr.*** Z...3430: 27 81 19, 27 81...27 81....27 83 44(**nuk dëgjohet)**

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** KAS rivlerëson 1 fletë votimi e kontestuar në tavolinën nr.4, që i përket qendrës së votimit: 3327, Qarku Berat. Fleta e votimit paraprakisht nga KZAZ-ja ka qenë e konsideruar e pavlefshme dhe gjithashtu edhe për KAS, kjo fletë votimi mbetet e pavlefshme.

***GNV.nr.*** Z....26 29 19, 26 29 36, 21 28 38, 36....dhe kodi i pestë: 27 80 45(**nuk dëgjohet)**

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** Ju lutem pak qetësi në sallë, sepse pengojmë edhe kolegët në numërim!

***GNV.nr.*** Z..............48...01(**nuk dëgjohet)**

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** KAS rivlerëson 1 fletë votimi në tavolinën nr.3, që i përket qendrës së votimit: 3330 Qarku Berat. Fleta e votimit paraprakisht është konsideruar e pavlefshme, KAS e rivlerëson dhe e konsideron të vlefshme për LSI-në. Gjithashtu KAS rivlerëson 5 fletë votimi të kontestuara në tavolinën nr.2, që i përket qendrës së votimit nr. 3328, fletë votimi të cilat kanë qenë të konsideruara paraprakisht të pavlefshme. KAS vlerëson që me shumicën e votave vetëm 1 fletë votimi nga këto do të rivlerësohet dhe do të konsiderohet e vlefshme në favor të Partisë Socialiste. Ndërsa 4 fletët e tjera të votimit mbesin të pavlefshme.

***GNV.nr.*** Z....Kutia e votimit me nr.....është e mbyllur me kodet e sigurisë: ...8228, 212822...5521 dhe 21... **(nuk dëgjohet)**

***Z. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV.nr.*** Z....Qendra e votimit: 3330 ZAZ-ja 66 mbyllet me kodet: 23 46 54, 23 46 58, 23 46 35, 23 46 30 dhe kodi i pestë i pandryshuar: 27 83 79

***GNV.nr.*** Z....Qendra e votimit 3440, ZAZ-ja 66 hapet me kodet: 27 89 71, 27 89 78, 27 89 79, 27 89 77, kodi i pestë: 20 11 08

***Z. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV.nr.*** Znj...Kutia 3328 mbyllet me kodet: 23 45 00, 23 45 08, 23 45 03, 23 45 01 dhe 27 83 99

***GNV.nr.*** Znj....Kutia e qendrës: 3441 hapet me kodet: 21 28 63, 21 28 21 ,21 28 68, 21 28 37 dhe 20 11 01

***Z. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV.nr.*** Znj...Kutia e qendrës së votimit: 3327 mbyllet me këto kode sigurie: 23 45 25, 23 45 20, 23 45 24, 23 45 22 dhe kodi i pestë i pandryshuar: 27 82 53

***GNV.nr.*** Znj...Kutia e qendrës së votimit: 3442 hapet me kodet e sigurisë: 21 28 36, 21 28 38, 21 28 25, 21 28 30 dhe 27 86 67

***Z. E. Çeço:*** Konfirmoj!

***Z. E. Çefa:*** KAS rivlerëson 1 fletë votimi që i përket qendrës së votimit 3430, e kontestuar në tavolinën nr.6. Fleta e votimit ishte e pavlefshme edhe nga KAS konsiderohet gjithashtu e pavlefshme. KAS rivlerëson 1 tjetër votë të kontestuar në tavolinën e numërimit nr.5 që i përket qendrës së votimit 3438. Fleta e votimit nga KAS vlerësohet e pavlefshme ndërkohë që ishte konsideruar e vlefshme, tashmë është e pavlefshme. Në rivlerësimin e 1 flete të votimit që është kontestuar në tavolinën e numërimit nr.7, që i përket qendrës së votimit 3439, fleta e votimit paraprakisht ishte e konstatuar e pavlefshme, ndërkohë që KAS në rivlerësim e konsideron fletën e votimit të vlefshme për Partinë Socialiste.

***GNV.nr.*** Z...27 82 06, 27......., 27820.....278504, 2786... **(nuk dëgjohet)**

***Z. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV.nr.*** Znj....27 85 90, 27 85 16, 27 85 10, 27 85 08, 27 86 82

***Z. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV.nr.*** Z...21...........21.47, **(nuk dëgjohet)**

***Z. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV.nr.*** Z...Qendra e votimit: 3440 mbyllet e kodet: 23 45 47, 23 45 41, 23 45 43, 23 45 45 dhe kodi i pestë i pandryshuar 20 11 08

***Z. E. Çefa:*** KAS rivlerëson 2 fletë votimi të kontestuara në tavolinën nr.2 që i përkasin qendrës së votimit: 3441, fletët e votimit kanë qenë paraprakisht të pavlefshme dhe ngelen të tilla edhe nga rivlerësimi i KAS. Faleminderit!

***GNV.nr.*** Znj...Kutia e qendrës së votimit 3441, mbyllet me këto kode: 20 11 01, 23 45 69, 23 45 66, 23 45 60 dhe 23 45 04

***GNV.nr.*** Qendra e votimit: 3458 e ZAZ-së 67 hapet me këto kode: 26 28 07, 26 28 09, 26 28 01, 26 28 06, 26 29 83

***Z. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** KAS rivlerëson 2 fletë votimi të kontestuara në tavolinën e numërimit nr.5 që i përkasin qendrës së votimit: 3450. Fleta e parë e votimit është konstatuar

e pavlefshme fillimisht nga KZAZ-ja dhe KAS e konstaton të vlefshme për Partinë Lëvizja Socialiste për Ndryshim. Ndërkohë fleta tjetër e votimit ishte konstatuar e vlefshme për subjektin Partia Socialiste, KAS e konstaton këtë fletë votimi të pavlefshme.

***GNV.nr.*** Z...Qendra e votimit nr. 4447 ka këto kode: **(nuk dëgjohet)**
***Z. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV.nr.***Znj...Kutia e votimit: 3371, hapet me këto kode: 26 25 43, 26 25 49, 26 25 46, 26 25 45 dhe 26 28 84
***Z. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV.nr.***Z...është mbyllur me kodet.........kodi i pestë: 26 26 65**(nuk dëgjohet)**
***Z. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV.nr.***Z......me kodet**(nuk dëgjohet)**

***Z. E. Çefa:*** KAS rivlerëson një fletë votimi të kontestuar në tavolinën nr.6. Fleta e votimit i përket qendrës së votimit 3451 dhe ishte konstatuar paraprakisht e pavlefshme edhe nga rivlerësimi në KAS fleta e votimit ngelet e pavlefshme.

***GNV.nr.***Z...... **(nuk dëgjohet)**
***Z. E. Çeço:*** Konfirmoj!

***GNV.nr.***Znj...Qendra e votimit 3442 mbyllet me kodet e sigurisë: 23 45 40

***GNV nr. 4, zonja L. Mavriqi:*** 234524, 234540, 234549 dhe kodi 5 i pa ndryshuar 278667.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!
Nuk dëgjohet.

***Z. E. Lako:*** Mirë, tek tavolina nr.2 QV 3371 janë 8 vota të kontestuara pasi kanë një shënim të ngjashëm por janë vota të cilat janë të vlerësuara nga KZAZ si të vlefshme për subjektin LSI. KAS e vlerëson të vlefshme. Atëherë tek tavolina nr.3 QV 3458 janë 2 fletë votimi të kontestuara, njëra nga të cilat është konsideruar nga KZAZ e vlefshme për PS. KAS gjithashtu e konsideron të vlefshme dhe një fletë tjetër votimi po për të njëjtin subjekt është konsideruar e pavlefshme nga KZAZ. KAS me shumicë e cilëson të vlefshme.

***GNV nr. 4, zonja L. Mavriqi:*** Kutia e QV 3371 mbyllet me këto kode: 234568, 234563, 234567, 234565, 262884.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

Nuk dëgjohet fare.

***Znj. L. Mavriqi:*** Kutia e QV 35791 hapet me këto kode: 262869, 262866, 262859, 262865, 262913.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 3, zoti J. Bytyçi:*** QV 3458 mbyllet me kodet: 234632, 234528 dhe kodi i 5 i pa ndyshuar 262983.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

Nuk dëgjohet.

***GNV nr. 4, zonja L. Mavriqi:*** Kutia e QV 35791 mbyllet me këto kode: 234564, 234561, 234562, 234503, 262913 kodi i pandryshuar.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** KAS rivlerësojë 3 fletë votimi të QV-së 3778 të kontestuara në tavolinën nr.5, fletë votimi që kan qenë të konsideruara të vlefshme nga KZAZ dhe KAS i konstaton të treja të pavlefshme.

***Z. E. Lako:*** Zoti Sekretar i Përgjithshëm ku janë këto grupet e numërimit? Askujt si dhamë pushim ne.

***Z. E. Çefa***: KAS rivlerëson një vletë votimi të kontestuar në tavolinën nr.6 QV35801 fleta e votimit është numëruar në KZAZ në favor të LSI edhe pas rivlerësimit KAS e konsideron këtë votë të vlefshme për subjektin LSI me shumicën e votave.

***GNV nr. 3, zoti J. Bytyçi:*** QV 3556 e ZAZ-së 68 hapet me kodet: 262450, 262491, 262498, 262129, 292026.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 4, zonja L. Mavriqi:*** Kutia e QV 3536 mbyllet me këto kode: 234306, 234300, 234305, 234309, 213060 kodi i pandryshuar.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 4, zonja L. Mavriqi:*** Kutia e QV 3571 hapet me kodet: 262459, 262955, 262454, 262458, 262118.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. E. Çefa:*** KAS mori në vlerësim dy fletë votimi të kontestuara në tavolinën nr.1 që i përkasin QV 3324 të Qarkut Berat. Të dyja votat ishin paraprakisht të konstatuara të pavlefshme nga numëruesit në KZAZ, pas rivlerësimit KAS i konsideron me shumicën e votave të dyja votat te vlefshme njëra për PBK dhe tjetra për LSI. KAS rivlerësojë një vletë votimi të vlerësuar nga tavolina nr.8 QV 3465 Qarku Berat, fleta e votimit në KZAZ është konsideruar e pa vlefshme ndërkohë nga rivlerësimi KAS-it kjo fletë votimi konsiderohet e vlefshme në favor të PS.

***GNV nr. 4, zonja L. Mavriqi:*** Kutia e QV 3571 mbyllet me kodet e sigurisë:234308, 234302, 234304, 234301, 262118.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***GNV nr. 3, zoti J. Bytyçi:*** QV 3556 KZAZ68 mbyllet me kodin: 234599, 234597, 234591, 214593, 262026.

***Znj. E. Çeço:*** Konfirmohet!

***Z. L. Braho:*** Për sa mund t'i marrim procesverbalet me kompjuter? Marrim këto njëherë që t'i konfirmojnë dhe subjektet, a përputhen këto me shkrim dore me të kompjuterit dhe pjesa tjetër është automatike.

*Zbardhi materialin audio*
*Silvi SINO*

***Z. E. Çefa:*** Procesi i numërimit të kutive të përcaktuara nga KAS me vendimin e djeshëm të ndërmjetëm ka pëfunduar, ka përfunduar gjithashtu edhe procesi i numërimit të dy kutive ku u vendos që do të rinumëroheshin votat për kandidatët sipas procedurës. Administrata e KQZ-së tani do të hartojë tabelat përmbledhëse të rezultatit të rinumërimit të votave. Kështu që zoti Sekretar i Përgjithshëm do t'ju lutem të na informoni sa kohë mund të duhet dhe eventualisht edhe përfaqësuesit e subjekteve nëse do duan paraprakisht të kenë ndonjë kopje të tabelave në mënyrë që kur të ricelim seancën të kemi mundësi të bëjmë dhe diskutimet përfundimtare.

***Z. Y. Merkaj:*** Besoj nga ora 5 e kemi gati.

***Z. E. Çefa:*** Pra nga ora 17:00 ju keni gati tabelat përmbledhëse. Përfaqësuesit e partive doni nga një kopje? Ora 17:00 është mirë për ju për të rifilluar seancën? Dakord, po zoti Logu?

***Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:*** Dakord. Sot dhe ditën e djeshme shtetasja Joana Melengu vëzhguese e PS-së kryetare e njësisë nr.2 në Bashkinë Berat ka kërcënuar një vëzhgues të PD-së me fjalët: "Do ta shohësh kur të dalim jashtë, do të ta pres gjuhën". Ju lutem të rregullohet audioja kjo fjalë duhet mbajtur këtu se ka të bëjë më këtë proces. Shtetasja Joana Melengu është e njëjta shetase e cila në datën 20 prill 2021 u kap në flagrancë duke shpërndarë ndihma ushqimore me votuesit në këmbim të votës. Kjo shtetase me paturpësi në shkelje flagrante të ligjit guxon të kërcënojë të intimidojë të shantazhojë një vëzhgues të PD-së. A e kuptoni zotërinj se çfarë po ndodh këtu? Ne flasim se çfarë ndodh në Skrapar, çfarë ndodh në Kuçovë, Berat po këtu në KQZ, në sytë e gjithë Shqipërisë ka njërëz që

kërcënojnë me jetë vëzhguesit e PD-së. Ky është një rast flagrant se si zgjedhjet e 21 prillit ishin një kërcënim i pastër siç edhe ka ndodhur ditën e sotme.

***Z. E. Çefa:*** Ju lutem zoti Logu na krijoni mundësinë të mbajmë qëndrim. Zoti Logu ju rikujtojë se jemi zyrtarisht ende në seancë dhe pavarësisht se ju morrët dhe tejkaluat të drejtën që ju dhashë për të folur jam ende unë drejtues i kësaj seance. Ju lutem shumë, ja u përsëris për herë të fundit. Nuk ju lejoj në mënyrë kategorike këtë sjellje. Ju dhashë fjalën dhe përsëritje tre herë apo katër herë të kësaj situate nuk është e nevojshme. Të gjithë kemi vesh, kemi sy dhe ju dëgjojmë. Problemi që ngritët ju është shumë serioz do t'ju ftoj jo vetëm ju por edhe Administratën e KQZ-së që t'ju vënë në dispozicion juve dhe prokurorisë të gjitha pamjet filmike që ka kjo sallë në çdo minutë dhe çdo sekond të këtij procesi që ju pretendoni që ka ndodhur këtu, në syrin tonë dhe nqs do të mund të vërtetohet do të jetë një ndër gjërat më të rënda dhe të pa tolerueshme, por kjo nuk justifikon në mënyrë kategorike që ju të jepni konferencë për shtyp në seancën që drejtoj unë. Seanca deklarohet e mbyllur në orën 17:30 rifillojmë, faleminderit.

**21.05.2021**
**Ora 17:38**

***RENDI I DITËS***

***Projektvendim "Shqyrtimi i kërkesave ankimore me nr.34 "Ndryshimi i vendimit 339, datë 04.05.2021 të KSHZ "Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit Qarku Berat", "Rinumërimi dhe rivlersimin e votave për ZAZ-të 63,64,65,66,67,68, subjekti ankues LSI dhe nr.35 "Kundërshtimi i vendimit 339, datë 04.05.2021, të KSHZ "Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit, Qarku Berat", "Shpalljen e pavlefshme të procesit të votimit në qendrat e votimit, Qarkut Berat si dhe përsëritjen e zgjedhjeve", subjekti ankues LSI".***

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** **Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI, Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**
- **Stafi KQZ: Y.Merkaj, O.Peto**
- **Parti Politike: PD, PS, LSI**
- **Vëzhgues OSBE/ODIHR**

***Z. E. Çefa:*** Mirëdita rimarrim edhe një herë seancën pas ndërprerjes së nevojshme për t'i dhënë mundësi administratës për hartimin e tabelave të rezultatit. Proces i cili ka mbaruar dhe mesa shoh kemi prodhuar dy tabela nga administrata është tabela e parë që është tabela e rezultateve pas rinumërimit të 114 kutive të Qarkut Berat me votat për secilin subjekt. Kemi një tabelë tjetër në të cilën është pasqyruar diferenca e rezultateve. Pas rinumërimit kemi dy të dhëna në këtë tabelë: Kemi rezultatin e votave për secilin subjekt, sipas rezultatit të nxjerrë nga KZAZ-ja dhe rezultatin e votave pas rinumërimit. Për efekt të njoftimit të publikut, rezulton që

Partia Lëvizja Socialiste për Integrim ka shtuar rezultatin me 15 vota, Partia Aleanca Demokracia e Re ka shtuar rezultatin me 11 vota, Partia Socialiste ka zvogëluar rezultatin me 20 vota dhe PD-AN ka zvogëluar rezultatin me 9 vota. Sigurisht këtu janë të gjitha të dhënat për secilin subjekt të mjaftueshme besoj unë për të konkluduar për këtë fazë të kërkesës ankimore. Zoti sekretar i përgjithshëm a janë administruar edhe të gjitha kontestimet e bëra nga vëzhguesit e subjekteve gjatë numërimit këtu?

***Z. Y. Merkaj:*** Po janë administruar pasi çdo tabelë përmbledhëse e rezultatit që ka nxjerrë grupi i numërimit sipas tavolinave përkatëse, ku janë pasqyruar edhe vërejtjet e vëzhguesve të partive përkatëse.

***Z. E. Çefa:*** Përfaqësuesit e subjekteve i keni tabelat besoj, unë mendoj nëse nuk ka tashmë ndonjë provë të re ne mund t'iu marrim edhe një mendim nëse keni lidhur me rezultatin e tabelave dhe më pas të kalojmë në përmbylljen e hetimit administrativ dhe në konkluzione. Po zoti Kaziaj.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Faleminderit i nderuar zoti relator i seancës. Të nderuar anëtarë të KAS-it, Lëvizja Socialiste për Integrim ka sjellë dy kërkesa për sa i përket pjesës së Qarkut Beratit para jush, të cilat janë shqyrtuar e fundit po shqyrtohet sot që ka lidhje me rinumërimin dhe rivlerësimit e 114 kutive. Në kërkesën e parë duke qenë se jeni shprehur në vendim të ndërmjetëm, keni pasur element të nevojshëm të shprehur në parregullsitë të natyrës së ligjit ku mund të shpreheshit lidhur me një objektitivet të qëndrueshëm nga ana juaj për sa i përket pjesës së pavlefshmërisë së të paktën disa kutive nga ato për të cilën ne kërkuam në

atë kërkesë ankimore. Pavlefshmëri e cila duhet të ishte më pas orientuar rreth faktit që këto kuti të shpallura të pavlefshme nuk duhet të ishin përllogaritur në tabelën përfundimtare të këtij qarku dhe kjo gjë nuk ndodhi nga ana juaj për shkak se ju keni shfaqur haptazi një anshmëri në gjykim, ju keni shfaqur haptazi paqëndrushmëri në gjykim.

***Z. E. Lako:*** Ju lutem përfaqësues, ruani etikën kur flisni për institucionet.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Nuk ju ofendova i nderuar.

***Z. E. Lako:*** Paligjshmërinë nuk e vendosni ju e vendos gjykata. Ju lutem ruaje etikën.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Po pra etika po ruhet të lutem të më lësh të flas dhe unë nuk etiketova dhe nuk ofendova askënd, nuk i marr përsipër t'i bëj këto gjëra në një seancë publike dhe në një seancë private. Të lutem më lër të shprehem se pavarësisht se merrni vendime të kësaj natyre po na hiqni dhe të drejtën e fjalës. Të lutem të më lesh të shprehem dhe të mos ndërhysh.

***Z. E. Lako:*** Mund të flasësh sa të duash se nuk e drejtoj unë këtë seancë, vetëm ruaj rregullin dhe etikën.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** E kam ruajtur gjithmonë, qëndrimet e mbajtura nga ana juaj nuk janë në pritshmëritë e këtij organi të posaçëm me karakter kolegjal dhe ankimore të cilët secili prej jush përfaqëson. Për sa i përket pjesës

vazhdoj gjithmonë me pavlefshmërinë, ajo pjesë ishte haptazi në kamera dhe në seanca publike është shfaqur haptazi papërthueshmëria ligjore e çdo flete votimi qofshin këto në mangësi të theksuara të numrit të marrë dhe të depozituar më vonë nga qendrat e votimit, qofshin këto në mospërpuethshmëri të statisitikave ose treguesve kryesorë që janë pajisja PEI, mbyllja e procesit nëpërmjet saj dhe regjistri i posaçëm i nënshkrimeve të shtetasve të qytetarëve të Beratit në këtë rast të votuesve të atij qarku. Për sa i përket pjesës së kërkesës ankimore për "Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.339, datë 04.05.2021", në të cilën kemi kërkuar rinumërim dhe rivlerësim të asaj tabele që ju kishit bashkëlidhur të themi kërkesës ankimore që përbënte një total prej 114 qendrash votimi. Nuk jemi të surprizuar të themi nga ky rezultat për shkak se ky është një rezultat i nxjerrë nga ana juaj. Ky rezultat pasqyron që Partia Socialiste e Shqipërisë ka marrë vullnetin e zgjedhësve duke e çuar atë në atë koshin e madh të votave të veta. Pra -20 shohim të paktën nga tabela e cila na është servirur nga pjesa e administratës së KQZ-së, -20 vota në 114 kuti nuk janë pak të nderuar anëtarë të KAS-it, +15 vota për LSI-në nuk janë pak të nderuar anëtarë të KAS-it. Arsyetimi i brendësisë së kërkesës ankimore të bërë nga ana jonë e cila mbështetej në pamjet filmike të çdo vote për ato 114 qendra votimi është bërë në pamjet filmike ku numëruesit e tavolinave të numërimit në 6 ZAZ-të e Qarkut të Beratit, kanë bërë në momentin e parë kur shqyrtohet dhe vlerësohet vota për subjektet politike. Pra, kërkoj një hetim të thellë administrativ nga ana juaj që votat, dyshojmë se nga pamjet filmike tonat rezultonin vetëm pamjet e pjesës së numërimit për subjektet dhe jo për kandidatët parapëlqyes të atij qarku, gjë e cila mund të ketë tjetërsuar vullnetin gjatë numërimit të votës për kandidatin. Ju pa etiketuar askënd prej jush, duhet të mbani një qëndrim objektiv lidhur me këtë

situatë paligjshmërie e cila na është servirur në këtë tabelë ku treguesit e qartë janë që një subjekt ka marrë vota më shumë seç i takonin dhe një subjekt tjetër ankues në këtë rast ka përfituar më pak vota seç i takonin. Shtuar këtu dhe pjesën e interpretimit të një anshëm të 3 anëtarëve të këtij komisioni, të cilët nëpërmjet mesazheve të ardhura dje apo ditën e sotme kanë mbajtur një qëndrim jo të karakterit procedural, jo të karakterit ligjor po një qëndrim politik duke adresuar këto vota jo sipas parashikimeve të kodit. Unë për më vonë do të kisha diçka tjetër për të thënë kështu që ju falenderoj për këtë rast duke ju sjellë në vëmendje atë që ishte sapo thashë në pjesën hapëse timen që të silleni me integritet dhe mos të shikoni mesazhet që vijnë në telefonat tuaja.

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit përfaqësues i Partisë Demokratike nëse keni sigurisht.

***Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:*** Faleminderit i nderuar, ne parimisht e kemi shprehur qëndrimin tonë lidhur me procesin zgjedhor të 25 prillit, për ne nuk ka pasur proces zgjedhor të lirë dhe të drejtë. Procesi zgjedhor ka qenë i ndikuar thellësisht nga përdorimi i makinerisë së shtetit, çdo qelizë të organizimit të procesit zgjedhor dhe të zhvillimit të procesit zgjedhor. Shqyrtimi këtu i sotëm përpara jush është kërkesë për rezultat, kështu që në këtë këndëvështrim nuk përputhet me qëndrimin që ne kemi mbajtur procesin zgjedhor. Megjithatë në mënyrë parimore kemi qenë dhe kemi mbështetur çdo kërkesë e cila synon të evidentojë parregullsitë që kanë qenë në procesin zgjedhor veçanërisht në procesin e numërimit dhe tabulimit të rezultatit. Kështu që jemi për hetimin dhe shkuarjen deri në fund çdo kërkese që i paraqitet kësaj trupe për hedhjen në dritë të aspekteve të parregullsive të procesit zgjedhor. Kutitë u hapën, parregullsitë ishin të shumta

dhe kemi pasur raste t'i denoncojmë rast pas rasti ashtu siç kanë qenë çdo gjë dhe në vëmendjen dhe transparencën e publikut. Kaq për sa na takon, faleminderit.

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit, përfaqësues i Partisë Socialiste.

***Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:*** Faleminderit, siç dhe ka qenë dhe qëndrimi ynë që në fillimin e kërkesës që paraqiti Lëvizja Socialiste për Integrim, ne mbështetëm këtë kërkesë për hapjen e këtyre kutive duke qenë të bindur se hapja e kutive në radhë të parë do i vlente procesit zgjedhor dhe të paktën një rast të vetëm ju, ne dhe gjithë shqiptarët të shikonim sesi ishin numëruar ato fletë votimi dhe mandati i fituar i pestë i Partisë Socialiste ishte ose jo ligjor. Do të hiqnim çdo lloj dyshimi mbi këtë rezultat pavarësisht se unë e shpreha qartë dhe në seancën e parë që mandati nuk do të ndryshonte për arsye se votimi dhe numërimi në Qarkun Berat ka qenë konform rregullave ligjore. Ndryshime të vetme që ndodhën në seancë në praninë e mediave dhe të gjithë vëzhguesve kanë të bëjnë me mënyrën dhe standartin e rivlerësimit të votës. Në Berat në KZAZ-të e Beratit ka pasur një standart për vlefshmërinë e votës për ta përcaktuar një votë të vlefshme ose të pavlefshme standarti ka qenë i ndryshëm dhe ju këtu me vendim, ishit ju anëtarët e KAS-it që vlerësuat 15 vota të vlefshme për Lëvizjen Socialiste për Integrim. Pra nuk janë ato vota të cilat u kërkua në kamera, asnjë votë nuk ishte e futur në zarfin e një partie, por rivlerësimi që iu bëtë atyre votave me objektivitet arritët që pas kontrollit të 110 kutive të nxirrnit 15 vota. Për sa u përket 20 votave të shpallura të pavlefshme nga ana juaj për Partinë Socialiste dhe 9 për Partinë Demokratike vetë ky raport 20 me 9 ka të bëjë dhe me raportin e votave që janë në atë qark. Pra vetë ai standart në qark bie që mandatet janë 5 me 2, pra vetë raporti është 2 me 1 për

mandatin dhe votat 20 me 9, dalin prapë 2 me 1, është i njëjti raport dhe këtu nuk ka pasur vjedhje vote. 9 vota për Partinë Demokratike që janë shpallur të pavlefshme nuk kanë qenë vota të cilat Partia Demokratike i ka marrë në grup numërimi, por nga ai vlerësim i juaj ato nga të vlefshme janë quajtur të pavlefshme dhe e njëjta gjë dhe për 20 votat e Partisë Socialiste. Këto janë pak siç e kemi thënë në fillim janë gabime materiale njerëzore të ndodhur në proces, nuk mund ta bëjmë procesin pis, por këto tashmë vulosen që procesi i 25 prillit në Qarkun e Beratit është një proces ligjor dhe transparent. Besoj se kërkesa ligjore e LSI-së, vullneti i tyre u miratua nga KAS-i, me miratim ju keni marrë një vendim 4 me 1 për të vendosur hapjen e kutive. Ky rezultat tashmë dihet nuk mund të ndryshojë dhe unë besoj që le të mbyllim shqyrtimin administrativ, të miratojmë tabelën me ndryshimet e ardhura nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për Qarkun Berat.

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit ndonjë pyetje diskutim nuk ka. Atëherë besoj mund të kalojmë në fazën përmbyllëse, t'i japim fund fazës së hetimit administrativ dhe të kalojë në fazën e konkluzioneve përfundimtare të cilat do të kërkoja mirësinë tuaj t'i bënit sa më në mënyrë të përmbledhur. Fjala për ju zoti Kaziaj.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Mundësisht do të na duhet pak kohë i nderuar zoti kryesues i seancës të paktën çerek ore për t'u shprehur mbi to.

***Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:*** Për procedurë votuam mbylljen e shqyrtimit administrativ vetëm për konkluzion e di unë sa të dimë që dhe ne të bëhemi gati, pra ka vendim.

***Z. E. Çefa:*** Nuk u votua por kaluam në fazën e konkluzioneve.

***Z. L. Braho:*** Idea është do të kërkoni miratim të tabelës së re apo jo se nuk është se ke çfarë konkluzionesh bën, kërkesa ishte për rinumërim rivlerësim. A jeni dakord me tabelën edhe pranohet tabela e re?

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Unë e pranoj mirësinë tuaj që më orientoni që atë që duhet të bëj zoti Braho, faleminderit po kërkesa jonë rri në fuqi që thashë në seancë pak më parë, faleminderit.

***Z. E. Çefa:*** Dakord atëherë do t'iu akordojmë 15 minuta avokat dhe rifillojmë për 15 minuta, faleminderit.

**<u>Rifillon Mbledhja</u>**
**<u>Ora: 18:11</u>**

***Z. E. Çefa:*** Riçelim seancën me parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare lidhur me këtë kërkesë ankimore duke filluar nga përfaqësuesi i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Faleminderit zoti relator, ashtu siç e thamë dhe në fillim duke parë që nga hetimi administrativ i cunguar për këto dy kërkesa ankimore nëpërmjet të cilave Lëvizja Socialiste për Integrim ka vënë në lëvizje Komisionin e Ankimimeve dhe Sankisoneve, po ashtu dhe Partia Demokratike me një kërkesë me objekt të njëjtë, për sa i përket pjesës së pavlefshmërisë. Përfundimisht kërkojmë nga ana juaj mosmiratimin e tabelës përmbledhëse të

rezultateve të dalë nga numërimi i 114 qendrave në Qarkun e Beratit. Mospërfshirjen në tabelën përmbledhëse të paktën 3 QV të Qarkut të Beratit respektivisht QV nr.3431, QV nr.3445, QV nr.3318, faleminderit.

***Z. E. Çefa:*** Po zoti Braho.

***Z. L. Braho:*** Pra 3 qendra votimi tabela mos të miratohet për 3 qendra votimi në lidhje me pavlefshmërinë.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Tabela mos të miratohet sipas asaj tabele që ju na sollët për rinumërimin dhe shpallja duke qenë se ju si komision u shprehët me një vendim të ndërmjetëm, shpallja e pavlefshmërisë për këto 3 qendrat që unë citova. Të paktën zoti Braho për këto 3 qendra që unë citova, se paligjshmëritë në 24 qendra ishin të mëdha dhe ju këto i verifikuat.

***Z. E. Çefa:*** Po përfaqësuesi i PD-AN.

***Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:*** Ne jemi dakord me kërkesën e përfaqësuesit të LSI-së.

***Z. E. Çefa:*** Faleminderit përfaqësuesi i Partisë Socialiste.

***Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:*** Ndryshimin e vendimit të Kryekomisionerit dhe miratimin e tabelës së re të rezultateve sipas rezultatit të dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave në KAS.

***Z. K. Bele:*** Më fal një pyetje pra përfaqësuesi i palës së interesuar kërkon pranimin e ankimit fillestar të LSI-së apo jo?

***Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:*** Po.

***Z. K. Bele:*** Faleminderit.

***Z. E. Çefa:*** Atëherë KAS do të tërhiqet për të marrë vendim, ju rikujtoj që ky do të jetë vendimi përfundimtar për të treja kërkesat ankimore. Kështu që ne do të marrim një vendim duke përshirë dhe kjo shpjegon dhe ndryshimin e kërkimit final të përfaqësuesit të LSI-së duke e konsideruar vendim të ndërmjetëm vendimin e djeshëm. Faleminderit ne do t'ju njoftojmë rreth 30 minuta ndoshta apo më pak...

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Kaq pak do i'u duhet KAS-it për të vlerësuar dy kërkesa të rëndësishme vetëm 15 minuta?

***Z. L. Braho:*** Zoti Kaziaj e vlerësojmë vetë kohën.

***Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:*** Ne na vihet e drejta e oponencës zoti Braho.

***Z. E. Çefa:*** 30 minuta dhe shpallim vendimin.

**Rifillon Mbledhja**
**Ora 18:44**

***Z. E. Çefa:*** KAS-i pasi diskutoi çështjen në tërësi bazuar në pikën 1, shkronja "d", dhe në pikën 2 të nenit 143, të Kodit Zgjedhor vendosi: "Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.339, datë 04.05.2021, për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Berat për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë së datës 25 Prill 2021".

Miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve të zonës zgjedhore Qarku Berat sipas rezultateve të dala nga rinumërimi i 114 qendrave të votimit për sa i përket subjekteve politike dhe të dy qendrave të votimit për sa i përket kandidatëve.

Rrëzimin e kërkesës për shpalljen e pavlefshme të qendrave të votimit 3445, 3431, 3318 të zonës zgjedhore Qarku Berat për shkak se konsiderohet gjë e gjykuar në Kërkesën Ankimore nr.35, të paraqitur nga subjekti Lëvizja Socialiste për Intgegrim për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në Qarkun Berat.

Ky vendim shpallet sot dhe hyn në fuqi menjëherë, pjesë e këtij vendimi është edhe vendimi i ndërmjetëm i marrë dje nga KAS-i për rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr.35, të subjektit zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Kërkesës Ankimore nr.42, të subjektit zgjedhor PD-AN.

Kundër këtij vendimi bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit brenda 5 ditëve, u shpall sot në Tiranë në datën 21 Maj 2021. Seanca deklarohet e mbyllur, ditën e hënë në orën 10:00 ju njoftoj paraprakisht që do të fillojmë me shqyrtimin e kërkesave ankimore për zonën zgjedhore Qarku Durrës, relator është kolegu Bele, faleminderit. **Vendimi nr.88**



*Zbardhi materialin audio*
*Valbona DUSHI*